



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BRENDSHME  
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE**

**Nr. 23/33 Prot**

**Tiranë, më 25/07/2024**

**V E N D I M**

**PËR SUBJEKTIN E VLERËSIMIT SAIMIR BOSHNJAKU**

**Nr. 38, datë 25.07.2024**

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

<b>Enton Radovani</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Kleada Mersinllari</b>	<b>Relatore</b>
<b>Edona Dushaj</b>	<b>Anëtare</b>

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga anëtare e Sekretariatit Teknik, znj. Ledjana Azemaj, në datën 25.07.2024 ora 10:15, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I VLERËSIMIT:**

**Z. Saimir Foto Boshnjaku**, me funksion Drejtor, për Departamentin e Kufirit dhe Migracionit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

**OBJEKTI:**

**Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:**

**Ligji nr. 12/2018**, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

**Ligji nr. 49/2012**, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

## TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoji relatimin e relatores së çështjes Kleada Mersinllari; dëgjoji subjektin e vlerësimit, Saimir Foto Boshnjaku, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 17.07.2024, kërkoi konfirmimin e tij në detyrën e Drejtorit për Departamentin e Kufirit dhe Migracionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi, duke u bazuar në tre kriteret e vlerësimit të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, të ligjit 12/2018, i ndryshuar,





### V Ë R E N:

#### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, shtetasi z. Saimir Boshnjaku është subjekt i vlerësimit kalimtar nga trupat e vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit datë 05.04.2023, me pozicionin “Drejtor pranë Departamentit të Kufirit dhe Migracionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.”
3. Subjekti i vlerësimit z. **Saimir Boshnjaku**, iu nënshtrua procedurave të vlerësimit duke u shortuar në shortin e zhvilluar në datën 05.04.2023, nga trupat e vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7 datë 17.01.2023 “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit sipas ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar”.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin nr. 1 datë 18.04.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: znj. Kleada Mersinllari **Relatore**, z. Enton Radovani **Kryesues** dhe znj. Edona Dushaj **Anëtare**.
5. Trupa e vlerësimit në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar, si edhe në bazë të Rregullores nr. 197 datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”, me Vendimin nr. 1 datë 18.04.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Saimir Foto Boshnjaku.
6. Relatorja e çështjes, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 18.04.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e njohur përbërja e trupës së vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.



7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore me shkresën nr \*\*\* prot. datë 20.04.2023, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
8. Relatorja e çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
9. Në vijim të procesit të mbështetur në nenet 33/1, 42 dhe 46 të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, relatorja e çështjes ka dërguar pranë institucioneve ndihmëse deklaratimet e subjektit të vlerësimit, si më poshtë vijon:
  - a. me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 19.04.2023, ka dërgua pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin shoqërues;
  - b. me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 19.04.2023, ka dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit deklaratën e vlerësimit të aftësive profesionale;
  - c. me shkresën nr \*\*\* prot, datë 19.04.2023, ka dërguar pranë Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit, në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, deklaratën e kontrollit të figurës.
10. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
11. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka për objekt:
  - ✚ Vlerësimin e pasurisë;
  - ✚ Kontrollin e figurës;
  - ✚ Vlerësimin e aftësive profesionale.
12. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
  - a. Ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar;
  - b. Ligjin nr. 128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”;
  - c. Ligjin nr. 40/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”;
  - d. Ligjin nr. 49/2012 “Për gjykatën Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”;
  - e. Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”;
  - f. Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7, datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”;
  - g. Rregulloren nr. 197, datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”;

h. Duke verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme, dhe konkretisht deklaratat e dorëzuara nga vetë subjekti i vlerësimit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore që janë:

-  *Deklarata e Pasurisë;*
-  *Deklarata për Kontrollin e Figurës;*
-  *Formulari i Vlerësimit Profesional;*
-  *Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet.*

- i. Raportet përmblendhëse të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
- j. Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar;
- k. Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit;
- l. Ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gadishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.

**13.** Trupa e vlerësimit, në datën 31.05.2024, pas dëgjoi relatoren e çështjes, dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Saimir Boshnjaku, me Vendimin nr. 4 datë 31.05.2024, vendosi:

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Saimir Boshnjaku;
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
  -  *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*
  -  *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*
- c. Të ftojë subjektin për t'u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga trupa e vlerësimit, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, nenet 35 - 40 dhe 45 -47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme prej 5 ditësh për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

**14.** Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 3, pika 12 dhe 14, e ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

**15.** Në datën 15.07.2024, trupa e vlerësimit njoftoi subjektin e vlerësimit për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 17.07.2024, në orën 10:00, Salla e Mbledhjeve, kati I, në ambientet e Ministrisë së Brendshme në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

## **II. SEANCA DËGJIMORE.**

Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit z. Saimir Boshnjaku, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar si dhe Kodin e Procedurave Administrative. Subjekti i vlerësimit kishte zgjedhur të mos përfaqësohej me mbrojtës ligjor në këtë seancë. Në fund të seancës dëgjimore të dates 17.07.2024, subjekti i vlerësimit z. Saimir Boshnjaku, kërkoi konfirmimin në detyrë. Në datën 25.07.2024, trupa e vlerësimit shpalli vendimin.





## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT**

Me subjektin e vlerësimit është komunikuar me anë të postës elektronike, duke i bërë pyetje dhe kërkuar sqarime, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave. Subjekti i vlerësimit z. Saimir Boshnjaku, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të vlerësimit, në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar. Subjekti i vlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë hetimit.

### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

- 16.** Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
- 17.** Në zbatim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit z. Saimir Boshnjaku ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 09.03.2023, brenda afateve ligjore. Formulari i Pasurisë ka nr. 15 index, viti 2023.
- 18.** Procedurat e deklarimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33 ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34 të ligjit 12/2018, i ndryshuar.
- 19.** Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.
- 20.** Gjithashtu Trupa e Vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklarimet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së në zbatim të neneve 33/1 dhe 34 , shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare. Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

## **Trupa e vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:**

-  deklaraten e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
-  raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI;
-  provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
-  dokumentacionin e paraqitur në deklaratimet e subjektit, si përgjigje të pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike

## **Hetimi administrativ konsistoi në:**

- ✓ verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në njafueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- ✓ evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

## **A/IVLERËSIMI I PASURISË NGA ILDKPKI**

21. ILDKPKI-ja<sup>1</sup>, në përputhje me Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publik”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në Ligjin Nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetur, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit z. Saimir Boshnjaku, ku është konstatuar se:

- a) **deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**
- b) **nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- c) **nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- d) **nuk është kryer deklarim i rremë;**
- e) **subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.**

## **A/2. PROCEDURA E VLERËSIMIT/HETIMIT E KRYER NGA TRUPA E VLERËSIMIT**

22. Bazuar në nenin 34 të ligjit 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, Trupa e Vlerësimit hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e vlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, (b) raportin/vlerësimin e kryer nga ILDKPKI; (c) provat shkresore/dokumentet e administruara

<sup>1</sup> Raporti nr. \*\*\*\*\*, datë 22.09.2023, i ILDKPKI-së.

nga organet publike dhe private sipas nentit 34 të ligjit 12/2018; (ç) deklaratimet e subjektit të vlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit; (dh) deklaratimet në seancë degjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

23. Trupa Vlerësuese hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur, (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllimin evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo ndonjë konflikti të interesit.

*Subjekti i vlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë në zbatim të Ligjit nr 12/2018, i ndryshuar, si vijon:*

### **Pasuria nr.1**

- ❖ Apartament banimi me sip. 145.4 m<sup>2</sup>, me adresë rruga. “Ilo Mitkë Qafëzezi”, Njësia Administrative 5, Tiranë. Me kontratë sipërmarrje rep. \*\*\*, kol. \*\*\*, datë 29.08.2000. Proces hipotekimi, nuk është regjistruar, në bashkëpronësi me bashkëshorten time Miranda Janaq Boshnjaku. Vlera 58.160 USD.

**Burimi i krijimit:** a) Shitje apartment banimi me sip. 72 m<sup>2</sup> me adresë “Ish-Fusha e Aviacionit Civil” me vlerë 1.900.000 lekë, me kontratë rep. \*\*\*\*, kol. \*\*\*, datë. 27.08.2001.

b) Shitje garazh makine me sip. 16 m<sup>2</sup>, me adrese “Ish Fusha e Aviacionit Civil” Kontrate rep. \*\*\*\*, kol. \*\*\*, datë 08.07.2002, në shumën 100.000 lekë.

c) Të ardhura nga bashkëshortja 5.000 USD.

d) Të ardhura nga puna ime, familjarët dhe qiraja e ambjentit me adresë rruga “Myslym Shyri” shuma 38.160 USD, nga 24.11.1999 deri ne 31.12.2006. Zotëron 100% me bashkëshorten.

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontrate sipërmarrje nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol, datë 29.08.2000. Palë sipërmarrëse shoqëria “Alb RNK” dhe porositës Saimir Boshnjaku. Apartament me sip. të përgjithshme 145.4 m<sup>2</sup>, kati i 5 i banimit. Vlera 58.160 usd, shumë e cila do të likuidohet: Kësti i parë 30.000 usd do te paguhet në momentin e nënshkrimit të kontratës prej palëve. Kësti i dytë 10.000 usd do te paguhet në përfundim të banesës dhe diferenca do të paguhet me vonë. Bashkëlidhur Vendim nr. \*\*\* datë 24.07.2000, i KRRT, për Leje Ndërtimi për objektin 4, 6, 8 dhe 10 kate, në rrugën “Komuna e Parisit”.
- Kontratë shitje nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\* kol, datë 27.08.2001. Apartament me sip. 72 m<sup>2</sup> Zk. \*\*\*, me adresë: apartamenti \*\*, godina \*\*, ish Fusha e Aviacionit Civil Tiranë në shumën 1.900.000 lekë. Pale shitëse Miranda Veshi dhe Saimir Boshnjaku.



- Kontrate Shitblerje pasuri e paluajtshme (Garazhd), nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 08.07.2002. Palë shitëse Saimir Boshnjaku dhe Miranda Veshi. Garazhd nr. 10, me sip. 16 m<sup>2</sup>, zk \*\*\*, me adresë: ish Fusha e Aviacionit Civil, në shumën 100.000 lekë. Bashkëlidhur: Vërtetim pronësie nga dokumentet hipotekore, nr. \*\*\*, datë 01.08.2002, në emër të palës blerëse U. F.
- Kontrate qiraje datë 12.04.1994. Apartament në rrugën “Myslym Shyri për një afat 3-mujor (15.04.1994 - 15.07.1994), në shumën 10.000 lekë në muaj me të drejtë përsëritje. Qiradhënës Saimir Boshnjaku.
- Kontrate qiraje, datë. 22.07.1994. Apartament në rrugën “Myslym Shyri”, për një afat 4 mujor, në shumën 10.000 lekë në muaj, me të drejtë përsëritje. Qiradhënës Saimir Boshnjaku.
- Kontrate qiraje (pa datë), midis Saimir Boshnjaku dhe V. L, S. P dhe T. M, për apartamentin e ndodhur në rrugën “Myslym Shyri”, duke filluar nga data 01.01.1997 (nuk ka datë mbarimi), në shumën 400 \$ në muaj.
- Kontratë qiraje datë 25.09.1997, për apartment me sip.50 m<sup>2</sup>, me afat 3 vjeçar (01.10.1997-31.9.2000) në shumën 700 usd/në muaj. Qiradhënes V. F.
- Memorandum datë 27.04.2018, nga NDI (National Democratic Institute), drejtuar Saimir Boshnjakut, ku konfirmohet se është marrë me qira ambjent në Rrugën “Myslym Shyri”, Tiranë, për periudhën 10.08.1998 - 23.11.1999 në shumën 800 usd në muaj dhe për periudhën 24.11.1999 - 30.04.2002, në shumën 1.100 usd në muaj.

**✚ Trupa e vlerësimit në përputhje me ligjin nr. 12/2018 i ndryshuar, kreu verifikimet e nevojshme mbi përputhshmërinë e deklaramit të subjektit të vlerësimit:**

**24. ASHK, Zyrat Vendore, Tirana Rurale I, Tirana Rurale 2, Tirane Jug. Kamëz Vorë, Zonat e Stimuluara, Tirana Veri, me shkresat nr. \*\*\*\*\*, datë 16.06.2023 nuk konfirmon pasurinë e deklaruar nga subjekti.**

**25. Me inventarin nr. extra prot., datë 03.07.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se:**

- *“Për apartamentin e banimit 145.4 m<sup>2</sup> i porositur me anë të Kontratës së Sipërmarrjes nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol, datë 29.08.2000, nga vërtetimi i noteres E. T. H, e cila ka në ngarkim arkivën e ish-noterit E. G (noteri përpara të cilit është mbatjur kjo kontratë) konstatohet se ky veprim është shënuar në Librin e Veprimeve Noteriale në fletën nr. \*\*, për vitin 2001, në datën 29.08.2001, ndërsa në kontratën e sipërmarrjes data është shënuar gabim, pra ka një lapsus nga noteri, fakt që nuk është konstatuar nga ana e tyre më parë. Pagesat ndaj shoqërisë ALB RNK shpk, janë kryer sipas tabelës”.*



Nr rendor	Nr Mandati	Data	Përshkrimi	Vlera (USD)
1	43	30.08.2001	Prenotim Apartamenti 2+1 (kati VI edhe garzoniere kati VI)	30,000
2	58	22.12.2001	Saimir Boshnjaku	5,000
3	82	10.07.2002	Apartament Banimi	4,500
4	95	05.07.2003	Blerje Apartamenti	2,500
5	99	01.10.2003	Blerje Shtëpie	3,500
6	100	20.09.2004	Apartament	6,000
7	102	19.03.2005	Apartament	4,500
8	12	05.12.2006	Apartament	2,160
<b>Totali</b>				<b>58,160</b>

➤ “Pra, sa më sipër, në lidhje me aktin noterial të kontratës së sipërmarrjes për apartamentin me sipërfaqe 145,4 m<sup>2</sup> data e saktë e kontratës është 29.08.2001 dhe mandat pagesa për shumën 30,000 usd, rezulton me datën 30.08.2001. Si burim për justifikimin e kësaj shume kanë shërbyer;

- të ardhura nga shitja e apartmentit me sip. 72 m<sup>2</sup> sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 27.08.2001, me vlerë 1.900.000 lekë,
- të ardhura nga kursimet e familjes së tij dhe qiraja e ambientit, me adresë; rruga “Myslym Shyri”, Tiranë, nga viti 1992 deri në datën e kësaj pagese.”

➤ “Siç del edhe nga deklarimi, si burim për blerjen e apartamentit janë përdorur rreth 20.000 USD (të ardhura nga shitja e apartamentit, shitja e garazhit dhe 5.000 usd nga bashkeshortja), si edhe 38.160 usd të ardhura nga kursimet dhe qirate ndër vite. Pagesa e kestit të parë prej 30.000 usd, u sqarua më sipër dhe pjesa tjetër prej 28.160 usd, është paguar për periudhën 2001 - 2006.

Burimi i këtyre të ardhurave kanë qenë të ardhura të kursyera nga familja e tij (sipas certifikatës familjare të kohës), si dhe të ardhura nga qiratë e apartamentit në rrugën “Myslym Shyri” nga viti 1992 deri në datën e pagesës së fundit për këtë qëllim. Prindërit dhe vellezërit e tij kanë jetuar e punuar në Greqi, që prej vitit 1993 e në vijim dhe si dokumentacion justifikues për burimin financiar të tyre ka dorëzuar deklaratat e të ardhurave të tre në shtetin grek dhe konkretisht:

Nr	Emër	Periudha	Vlera (euro)	Emri	Periudha	Vlera (euro)	Emri	Periudha	Vlera (euro)
1	T.Boshnjaku	2003	6,295	V/M Filaj	2003	1,759	R. F	2003	
2	T.Boshnjaku	2004	7,043	V/M Filaj	2004	3,541	R. F	2004	6,489
3	T.Boshnjaku	2005	7,532	V/M Filaj	2005	3,334	R. F	2005	7,536

4	T.Boshnjaku	2006	7,991	V/M Filaj	2006	3,546	R. F	2006	8,085
5	T.Boshnjaku	2007	8,812	V/M Filaj	2007	5,930	R. F	2007	9,147
6	T.Boshnjaku	2008	9327	V/M Filaj	2008		R. F	2008	9,821
7	T.Boshnjaku	2009	10,098	V/M Filaj	2009	3,573	R. F	2009	16,156
8	T.Boshnjaku	2010	6,004	V/M Filaj	2010	10,523	R. F	2010	18,549
9	T.Boshnjaku	2011	11,000	V/M Filaj	2011	10,854	R. F	2011	18,549
10	T.Boshnjaku	2012	18,041	V/M Filaj	2012	4,850	R. F	2012	17,681
11	T.Boshnjaku	2013	17,977	V/M Filaj	2013	4,333	R. F	2013	5,380
12	T.Boshnjaku	2014	12,893	V/M Filaj	2014	5,840	R. F	2014	8,630
13	T.Boshnjaku	2015	8,625	V/M Filaj	2015	4,314	R. F	2015	5,158
14	T.Boshnjaku	2016	8,592	V/M Filaj	2016	4,956	R. F	2016	
15	T.Boshnjaku	2017	8,813	V/M Filaj	2017	2,500	R. F	2017	
16	T.Boshnjaku	2018	1,758	V/M Filaj	2018	1,757	R. F	2018	
17	T.Boshnjaku	2019	8,452	V/M Filaj	2019	3,839	R. F	2019	
18	T.Boshnjaku	2020	7,680	V/M Filaj	2020	4,516	R. F	2020	
19	T.Boshnjaku	2021	7,680	V/M Filaj	2021		R. F	2021	
20	T.Boshnjaku	2022		V/M Filaj	2022		R. F	2022	
<b>Total</b>			<b>174,613</b>	<b>Total</b>		<b>79,965</b>	<b>Total</b>		<b>131,181</b>

✚ Gjithashtu ka sqaruar se, nëna e tij M. F është trajtuar me pension pelqërie prej datës 21.05.2006, ndërsa thjeshtri (bashkëshorti i nënës) V. F është trajtuar me pension pleqërie, prej datës 01.01.1992 e në vazhdim. Ka theksuar gjithashtu se familjarët e tij kanë jetuar bashkarisht dhe me dakortësinë e të gjithë familjarëve ai ka përdorur të gjitha të ardhurat nga qiratë e apartamentit në rrugën “Myslym Shyri” në masën 100%, që nga periudha e parë e krijimit të të ardhurave nga ky aset, për blerje dhe investime të të gjitha llojeve të aseteve materiale apo financiare nën emrin e tij dhe të gjithë familjarëve të tjerë së bashku apo veç e veç (ai, bashkëshortja, femijët, nëna e tij, thjeshtri dhe vëllezërit e tij). Kjo sepse kanë qenë në të njejtën certifikatë familjare dhe pasuri familjare të përbashkëta të krijuara janë përdorur dhe mirëmbajtur nga ana e tij.

Vlera e këtyre të ardhurave sipas viteve është si me poshtë:

Periudha	Përshkrimi i të ardhurave	Vlera
15.04.1994-21.11.1994	B. M	70,000 Lekë
01.01.1997-30.09.1997	V. L	3,600 USD
01.10.1997-10.08.1998	S. M (Greek)	7,000 USD
10.08.1998-23.11.1999	NDI	11,200 USD
24.11.1999-30.04.2002	NDI	31,900USD
13.07.2002-13.01.2003	Euro Best	4,200USD
01.04.2003-31.03.2004	FMPA	8,400USD

01.04.2004-31.03.2005	FMPA	6,000 USD
01.02.2006-31.01.2008	B.V	14,400 USD
01.02.2008-30.04.2009	F. K	560,000 Lekë
01.05.2009-31.05.2010	DNH SHPK	390,000 Lekë
01.01.2012-31.12.2012	DNH SHPK	360,000 Lekë
10.01.2013-31.10.2014	V. K	660,000 Lekë
01.11.2014-01.11.2017	F. C	18,000 Euro
15.06.2019-15.02.2023	R. M	48,400 Euro
<b>Totale sipas monedhave</b>		<b>2,040,000 Lekë</b>
		<b>86,700 USD</b>
		<b>66,400 Euro</b>

Shpenzimet për mobilimin e shtëpisë ku jetojnë janë kryer në vitin 2003, përafërsisht në vlerën 400.000 lekë. Për këto shpenzime nuk disponojnë fatura nga furnitorët.

✚ Ka dorëzuar verifikim nga noterja E. T. H, e cila ka deklaruar se ka në ngarkim arkivën e noter E. G dhe me anë të këtij verifikimi, vërteton se kopja e fletës nr. 70, të regjistrit “Libri i Veprimeve Noteriale”, për periudhën 03.01.2001 - 30.10.2002 është nxjerr dhe fotokopjuar nga ajo. Bashkëlidhur Regjistri nr. \*\*, për periudhën 03.01.2001 - 30.10.2002, “Libri i veprimeve noteriale”, në të cilin vërtetohet se dokumenti me nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.08.2001, dhe lloji i aktit është “Kontratë Sipërmarrje shoq. ALB-RNK dhe Saimir Boshnjaku”. Mandat arketimi të shoqëria ALB RNK, nga Saimir Boshnjaku:

- nr. 43 datë 30.08.2001, në shumën 30.000 \$;
- nr. 58 datë 22.12.2001, në shumën 5.000 \$;
- nr. 82 datë 10.07.2002, ne shumën 4.500 \$;
- nr. 95 datë 05.07.2003, ne shumën 2.500 \$;
- nr. 99 datë 01.10.2003, në shumën 3.500 \$;
- nr. 100 datë 20.9.2004, ne shumën 6.000\$;
- nr. 102 datë 19.3.2005, ne shumën 4.500 \$;
- nr. 12 datë 05.12.2006, në shumën 2.160 \$ (total 58.160 \$).

✚ Kontrate shitje nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\* kol, datë. 27.08.2001. Apartament me sip. 72 m<sup>2</sup> Zk. \*\*\*, me adresë, apartamenti \*\*, godina \*\*, ish-Fusha e Aviacionit Civil Tiranë në shumën 1.900.000 leke. Pale shitëse Miranda Veshi dhe Samir Boshnjaku.

### **Bashkëlidhur**

- Kontrate blerje nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë. 11.03.2000, apartment me sip. 72 m<sup>2</sup>, në shumën 2.400.000 lekë, shumë e cila do paguhet cash deri në datë 06.09.2000. Palë blerëse Saimir Boshnjaku dhe Miranda Veshi.
- Kontrate shitblerje pasuri e paluajtshme Garazhd, nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 08.07.2002. Palë shitëse Saimir Boshnjaku dhe Miranda Veshi. Garazhd, me sip. 16 m<sup>2</sup>, me adrese ish Fusha e Aviacionit Civil, në shumën 100.000 lekë.
- Bashkëlidhur: Kontrate blerje (nuk lexohet numri i kontrates), datë 11.09.2000. Garazh me sip. 16 m<sup>2</sup>, në shumën 600.000 lekë. Pale blerëse Saimir Boshnjaku dhe Miranda Veshi. Vërtetim pronësie nga dokumentet hipotekore, nr. \*\*\* prot., datë 01.08.2002, në emër të palës blerëse U. F.

- Vërtetim nga ISSH Tiranë, datë 29.06.2023, ku konfirmohet se V. F, trajtohet me pension pleqërie, me datë fillimi 01.01.1992 e në vazhdim. Të ardhurat e përfituara nga sigurimet shoqërore nga data 01.01.1992 - 30.06.2023 janë në shumën 3.717.151 lekë.
- Libreze pune në emer të V. F, ku konfirmohen marrëdhëniet e punës se tij për periudhën 10.01.1950 - 01.01.1992. Bashkëlidhur: Vërtetim page datë 16.12.1991, ku konfirmohen të ardhurat nga paga për V. F, për periudhën 01.01.1989 - 01.01.1992, në shumën 26.028 lekë.
- Vërtetim nga ISSH Tiranë datë 29.06.2023, ku konfirmohet se Marina Filaj, trajtohet me pension pleqërie me datë fillimi 21.05.2006 e në vazhdim. Të ardhurat e përfituara nga sigurimet shoqërore nga data 21.05.2006 - 30.06.2023 janë në shumën 2.224.746 lekë.
- Libreze pune në emër të M. F, ku konfirmohen marrëdhëniet e punës për periudhën 16.06.1970 - 30.06.1993.
- Dokumentacion në lidhje me të ardhurat e T. Boshnjaku (në gjuhën greke), për periudhën 2003 - 2021. Të ardhurat totale rreth 174.613 euro.
- Dokumentacion në lidhje me të ardhurat e V. F (në gjuhën greke), për periudhën 2003- 2020. Të ardhurat totale rreth 80.000 euro.
- Dokumentacion (në gjuhën greke) për derdhjen e sigurimeve nga M. F për periudhën 1998 - 2016.
- Dokumentacion (në gjuhën greke) për derdhjen e sigurimeve nga T. Boshnjaku, për periudhën 1994 -2023.
- Dokumentacion (në gjuhën greke) për derdhjen e sigurimeve nga R. F, për periudhën 2002 – 2023
- Dokumentacion në lidhje me të ardhurat e R. F (në gjuhën greke), për periudhën 2004- 2015. Të ardhurat totale rreth 131.181 euro.
- Deklaratë përgjegjësie nr. \*\*\*, datë 30.06.2023, nga V. F, M. F, T. Boshnjaku. Njësuar me origjinalin nr. \*\*\* rep., datë 01.07.2023, të cilët kanë deklaruar se fitimet e të ardhurave nga qiradhënia e pronave të paluajtshme që gjenden në rrugën “Myslym Shyri”, ndërtesa 23, hyrja 1, ap nr. \*\*\* Tiranë, që nga viti 1993 dhe në vazhdim, janë përfitur nga i afërmi i tyre Saimir Boshnjaku dhe të gjithë së bashku kanë renë dakort që përdorimi i pronës se paluajtshme dhe të ardhurat nga qiradhënia e saj do të menaxhohen dhe do të përdoren nga Saimir Boshnjaku, për arsye investimi dhe nevojat e tij.
- Certifikatë familjare e datës 30.07.2015, nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Bashkiake nr. 10, Tiranë, me kryefamiljar V. F dhe familjarët e tij, M. F, Samir Boshnjaku, T. Boshnjaku, R. F, Miranda Boshnjaku, D. Boshnjaku dhe D. Boshnjaku.

Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezulton se: Apartamenti me sip. 145.4 m<sup>2</sup>, me adresë: rruga. “Ilo Mitke Qafëzezi”, Tiranë, në zotërim të subjektit është përfitur me kontratë porosie të vitit 2001, me vlerë **58.160 Usd**, (shlyer këstet deri në vitin 2006) me burim pjesërisht nga shitje e apartamentit në muajin gusht 2001 (konfirmohet shitja) dhe garazhit në muajin korrik 2002 (konfirmohet shitja), të ardhura të tij dhe bashkëshortes, si dhe të ardhura nga qiradhënia, për periudhën nga viti 1994 e në vazhdim.

**26. Trupa e vlerësimit në zbatim të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar**, në përfundim të analizimit dhe vlerësimit të deklarinimit të subjektit, dokumentacionit justifikues, të dhënave të mbledhura nga institucionet ligjzbatuese **konstaton se konfirmohet pasuritë e deklaruar nga subjekti i vlerësimit.**

Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 145.4 m<sup>2</sup>, me adresë: rruga “Ilo Mitkë Qafëzezi” Nd. \*\*, Hyrja \*\*, Njesia Administrative 5, Tiranë, është i aplikueshëm neni 32 pika 1.1 “*Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive në rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, nga viti 2008 dhe në vijim...*” **sepse asetet e sipërpërmendura janë krijuar para vitit 2008.**

## **Pasuria nr.2**

- ❖ Apartament banimi me sip. 65.7 m<sup>2</sup> me adresë Rr. “Myslym Shyri” (në certifikate pronësie figuron rruga “Reshit Collaku” privatizuar në vitin 1993, Zk \*\*\* nr. pasurie \*\*\*\*\* privatizuar në vitin 1993, në bashkëpronësi me vëllain tim T. Boshnjaku, nënën time M. Fila dhe thjeshtin V. Filaj. Vlera 4.690lekë. **Burimi i krijimit:** Kursime nga të ardhurat e prindërve. Pjesë takuese 25%.

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Certifikatë për vërtetim pronësie, për pasurinë apartament me sip. 65.7 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*\*\*, vol. \*\*, fq. \*\*, Zk. \*\*\* në emër të V. Filaj, M. Filaj. Saimir Boshnjaku, T. Boshnjaku, lëshuar më datë 02.08.2007.

**27. ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 03.07.2023, konfirmon apartament me sip. 65.70 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie nr. \*\*\*\*\* vol. \*\*\*, fq. \*\*, Zk. \*\* në emër të Saimir Boshnjaku, Viktor Filaj, Marina Filaj, Saimir Boshnjaku dhe Tasi Boshnjaku.

**Bashkëlidhur:** kartela e pasurisë së paluajtshme. Kontratë për privatizim banese datë 30.09.1993, nga V. Filaj.

**28. Instituti i Sigurimeve Shoqërore**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.05.2023, konfirmon se Marina Filaj përfiton pension pleqërie me masë aktuale 13.734 lekë, nga muaji maj 2006.

- Me inventarin nr. extra prot., datë 03.07.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:
  - Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se: Ky apartament është banesa ku kanë banuar, të cilën e kanë privatizuar nga Ndërmarrja Komonale e Banesave.
  - Kontratë për privatizim banesë datë 30.09.1993, nga V. Filaj. Apartament i ndërtuar në vitin 1963. Vlera e paguar 1.760 lekë. Bashkëlidhur, vërtetim nga Hipoteka Tiranë, datë 12.07.1995.

Bazuar në deklarinimin paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezulton se: Apartamenti në Tiranë, në zotërim të subjektit deklarues, me pjesë takuese ¼ është përfituar në vitin 1993 nga prindërit e tij me procedurë privatizimi.

Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ASHK.

## **Pasuria nr. 3.**

- ❖ Shtesë anësore 40 m<sup>2</sup>, në apartamentin e banimit me sip. 65.7 m<sup>2</sup>, me adresë: Rruga: “Myslym Shyri” Tiranë. Vendimi K.R.R.T, nr. 12715, datë. 20.09.1996 ndërtuar në vitin 1998, Zk. \*\*\* nr. pasurie \*\*\*\*\* ND2, si dhe ballkon tek kjo shtese anësore 7 m<sup>2</sup> dhe shkallë e jashtme e ndërtuar në vitin 1998, në proces legalizimi. Kjo shtesë është ndërtuar tek shtëpia e prindërve të mi, por në dokumentet e pronësisë është emri im për arsye se familjarët e mi jetojnë jashtë shtetit dhe nuk ka patur persona për të kryer procedurat dhe une i kam përfaqësuar e kryer të gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Vlera 120.000 leke. **Burimi i krijimit:** kursime nga puna jashtë shtetit e prindërve/vëllezërve të mi, si dhe të ardhurat nga puna ime, të ardhurat familjare nga qiraja e ambjentit rrugëm. “Myslym Shyri”. Zotëron 100%.

## **Pasuria nr. 4**

- ❖ Shtese anësore 18.3 m<sup>2</sup>, në apartamentin e banimit me sip. 65.7 m<sup>2</sup>, me adresë: rruga. “Myslym Shyri” ndërtuar në vitin 1999, Zona \*\*\*, nr. pasurie \*\*\*. Kjo shtesë është ndërtuar tek shtëpia e prindërve të mi, por dokumenti i pronësisë është në emrin tim, për arsye se familjarët e mi jetojnë jashtë shtetit dhe nuk ka patur persona për të kryer të gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Vlera 60.000 lekë. **Burimi i krijimit:** kursime nga puna jashtë shtetit e prindërve/vëllezërve të mi, të ardhurat nga puna ime, si dhe të ardhurat familjare nga qiraja e ambientit rruga “Myslym Shyri”, Zotëron 100%.

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Certifikatë për vërtetim pronësie, për pasurinë apartament me sip. 40 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*\*\* ND/2, vol. \*\*, fq. \*\*, ZK. \*\*\*, në emër të Saimir Boshnjaku, lëshuar në datë 28.07.2017.
  - Vendim i K.R.R.T Tiranë, nr. \*\*\*\* prot, datë 20.09.1996, për miratimin e lejes së ndërtimit për shtesë anësore pallati 23, në Rruga “Myslym Shyri.
  - Leje ndërtimi nr. \*\*\* prot, datë 20.09.1996, për shtesë anësore pallati nr. \*\*, në rruga “Myslym Shyri” e cila u jepet banorëve të pallatit \*\*, shkalla \*\*. Plani i Vendosjes së objektit në emër të qytetarit V. Filaj.
  - Vërtetim Pronësie nga dokumenti hipotekor, ku vërtetohet se në numrin hipotekor \*\*\*, Zk. \*\*\*, datë 04.06.2001, figuron e regjistruar pasuria \*\*\*, apartament me sip. 40 m<sup>2</sup>, shtesë anësore në emër të Saimir Boshnjaku. Harta Treguese e regjistrimit.
  - Certifikatë për vërtetim pronësie, për pasurinë apartament me sip. 18.34 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\* vol. \*\*, fq. \*\*, Zk. \*\*\*, në emër të Saimir Boshnjaku, lëshuar në datë 09.04.2012.
- ✚ **ASHK Drejtoria e Përgjithshme**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.06.2023, konfirmon se Saimir Foto Boshnjaku, rezulton vetëdeklarues:
- Nr. prot. \*\*\*\*\*, datë 17.3.2010, formular A1 me urdhër. Njësia nr. \*\*, Tiranë.
  - Nr. prot. \*\*\*, datë 24.11.2014, shtesë anësore Myslym Shyri, Tiranë.
  - Nr. prot. \*\*\*\*\*, datë 04.6.2021, objekt para 1991, Tirana Jug.

- 29. ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Veri**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 03.07.2023, konfirmon pasurinë nr. \*\*\*\*\*, vol. \*\*, fq. \*\*, Zk. \*\*\*, në emër të Saimir Boshnjaku. Bashkëlidhur kartela e pasurisë së paluajtshme, apartament me sip. 40 m<sup>2</sup>, në emër të Saimir Boshnjaku, regjistruar në datën 02.06.2010, me Leje Ndertimi nr. \*\*, datë 02.08.1996. konfirmohet se me datë 22.05.2013, pasuria u rivlerësua në shumën 5.800.000 lekë. Në seksionin “E” ka shënimin “Kufizohet pasuria për zgjidhjen e marrëdhënieve me truallin në bazë të urdhërit nr. \*\*\*, datë 09.02.2009, *Leje ndertimi nr. \*\*\*\* prot., datë 20.09.1996, nga Bashkia Tiranë, për shtesë anësore pallati nr. \*\*, rruga “Myslym Shyri”*. Objekti financohet nga vetë pronari. Vërtetim pronësie për pasurinë apartament me sip. 40 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\* ZK. \*\*\*, në emër të Saimir Boshnjaku, lëshuar në datë 03.06.2001, shtesë anësore me dy dhoma kati i parë. Akt kolaudimi për objektin shtesë anësore në rrugën “Myslym Shyri”, pallati \*\*, shk. \*\*, i vitit 2001. Investitorë: banorët e pallatit F. C, V. C, Sajmir Boshnjaku. Vlera faktike e punimeve 12.000 USD, fillimi i punimeve në tetor 1996 dhe mbarimi i punimeve 1997. Nuk ka pronësi mbi truallin. Trualli është shtetëror. Apartamenti ekzistues në katin e dytë i përket V. Filaj, M. Filaj, Sajmir Boshnjaku dhe D. Boshnjaku, Shtesa anësore në emër të Sajmir Boshnjakut është me sip. 40 m<sup>2</sup>, e përbërë nga dy dhoma.

- Vetëdeklarim për legalizimin e shtesës, nr. \*\*\*\*, shtëpi banimi në njësinë vendore nr. \*\*, rruga “Myslym Shyri”, shtesë anësore e ndërtuar në pronë private, me sip. sheshi \*\*\* m<sup>2</sup>, numri i kateve 5, Investitor Sh. P, datë 08.11.2006.
- Vetëdeklarim për legalizimin e shtesës, shtëpi banimi në njësinë vendore nr. \*\*, rruga “Myslym Shyri” shtesë anësore e ndërtuar në pronë private, me sip. sheshi 21 m<sup>2</sup>, numri i kateve 2. Investitor F. Ç, datë 07.03.2006. Bashkëlidhur certifikatat e përbërjes familjare të banorëve të pallatit, ndër ta dhe familjes së V. Filaj (V. Filaj, M. Filaj, Saimir Boshnjaku, T. Boshnjaku, R. F, Miranda Boshnjaku, Desara Boshnjaku dhe Denis Boshnjaku).
- Foto të shtesës anësore të pallatit, 4 fletë. Deklaratë për përfshirje në Procedurat e Legalizimit të ndërtimit pa leje dhe shtesës në ndërtim me leje, në emër të Saimir Boshnjaku nr. \*\*\* prot, datë 24.11.2014.
- Informacion nga sistemi i Aluzinit Tiranë, ku konfirmohet vetdeklarim për legalizim në emër të Saimir Boshnjaku, nr. \*\*\* prot., datë 17.03.2010. Bashkëlidhur: Formular i pagesës nr. \*\*\* prot., datë 05.07.2010, drejtuar z. Sh. P, në adresën rruga “Myslym Shyri”, pallati nr. \*\* Tiranë. Sipas vetdeklarimit nr. \*\*\*\*, datë 08.11.2006, sip e parcelës ndërtimore 85.3 m<sup>2</sup>, vera totale e parcelës në ndërtim 3.054.891 lekë. Shuma që do paguhet nga Saimir Boshnjaku është 1.489.200 lekë.
- Vetëdeklarim për Legalizimin e shtesës anësore në rrugën “Myslym Shyri”, pallati \*\*, shk. \*\*, ap. 3 me sip. sheshi ndërtimi 21 m<sup>2</sup>, numri i kateve \*\*, në emër të Saimir Boshnjaku (nuk ka datë), bashkëlidhur Genplan i shtesës anësore, në emër të Saimir Boshnjaku, nr. pasurie \*\*\*\*, me sip shtesë 18.3m<sup>2</sup>. Genplani i pasurisë \*\*\*\*, shtesë me sip. 58.3 m<sup>2</sup>, sipas dosjes së vetdeklarimit \*\*\*, në emër të Saimir Boshnjaku. Ortofoto dixhitale, planimetria e shtesës anësore 58.3 m<sup>2</sup>, sipas dosjes së vetdeklarimit nr. \*\*\*.
- Certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë apartament, me sip. 40 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*\*\* vol. \*\*, fq. \*\*, Zk. \*\*\*, në emër të Saimir Boshnjaku, lëshuar në datë 28.07.2017. Kërkesë nga Saimir Boshnjaku, datë 06.04.2011, nr. \*\* prot., datë 06.04.2011, drejtuar Drejtorisë Qendrore të Aluiznit, ku deklarohet se është vetëdeklarues për legalizimin e një shtesë në Njësinë nr. 10, me nr. prot. \*\*\*\*\*, të një shtese në të dyja anët e pallatit dhe ka marrë dy fatura, por nuk është dakort me llogaritjen dhe pagesën. Gjithashtu nuk është dakort dhe me shumën, pasi një pjesë e shtesës është për banim dhe një pjesë për dyqane. Duhet të shikohet edhe një here dosja e tij dhe të trajtohet si një shtesë dhe jo dy shtesa, pasi realisht është një shtesë. Kjo gjë ka sjellë pengesë edhe për banorët e tjerë, pasi ata janë të mendimit që të trajtohet si një shtesë.

### **30. Me inventarin nr. extra prot., datë 03.07.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:**

- Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se: Shtesat e ndërtuara në vitin 1998, prej 40 m<sup>2</sup> dhe në vitin 1999, prej 18.3 m<sup>2</sup> janë pjesë e pandarë e apartamentit me sipërfaq 65.7 m<sup>2</sup>, me adresë Rruga. “Myslym Shyri”, P. \*\*, Sh. \*\* Ap. \*\* dhe si të tilla ato shfrytëzohen si një ambient biznesi. Këtë fakt e provon edhe me foto bashkëlidhur përgjigjes. Ka deklaruar gjithashtu, se kërkesa për legalizim është bërë për sipërfaqen e jashtme prej rreth 10 m<sup>2</sup>, një vetrate xhami dhe shkallë, sic ilustrohen në foto.

Mungesa e familjarëve të tij në Shqipëri dhe dakortësia e të gjithë pjesëtarëve të familjes ka sjelle që ai të nënshkruante dhe përballonte çdo shpenzim administrativ dhe financiar për realizimin e këtyre shtesave, si edhe faktin që pronësia e shtesave të dilte në emrin e tij. Fakt të cilin e provon edhe me Deklaratën e Përgjegjësisë (pasqyruar me sipër), nga e cila vërtetohet se ai ka pasur dakortësinë e të gjithë familjarëve të tij, për përfitimin e të ardhurave që vijnë nga kjo pronë dhe detyrimin për të përballuar çdo shpenzim të lidhur me këte pronë. Lidhur me pagesat e kryera për ndërtimin e shtesave 40 m<sup>2</sup> + 18.3 m<sup>2</sup>, ka deklaruar se aktualisht nuk disponon asnjë dokumentacion të asaj kohe.



Rregjistrimi i shtesës prej 18,3 m<sup>2</sup>, në rregjistrin e pasurive të paluajtshme është kryer nga ai nëpërmjet procesit të legalizimit që provohet nëpërmjet Lejes së Legalizimit nr. \*\*\*, datë 28.02.2012, për shtesën prej 18.3 m<sup>2</sup>, nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, Tiranë.

Në lidhje me familjaret e tij, ka sqaruar se prindërit dhe vëllai i tij kanë jetuar e punuar në Greqi, që prej vitit 1993 e në vijim, dhe këto e vërteton me kopje të lejeve të qëndrimit dhe dokumentave identifikuese të lëshuara nga shteti i Greqisë.

- Foto të ambientit të jashtëm dhe të brendshme të shtesës 40 m<sup>2</sup> + 18.3 m<sup>2</sup>, si dhe vetratës dhe shkallëve (5 cop).
- Leje Legalizimi nr. \*\*\*, datë 28.02.2012, shtes anësore 2 kate, për banim dhe shërbim, në objekt ekzistues 5 kate në emer të F. C dhe Saimir Boshnjaku, me adresë Njësia Bashkiake nr. \*\*, Zk.\*\*\*, nr. pasurie \*\*\*\*, sip. parcele ndërtimore 22.4 m<sup>2</sup>, sip. totale për banim 18.3 m<sup>2</sup>, për aktivitet 22.4 m<sup>2</sup>, numri i kateve 2.
- Deklaratë nr. \*\*\* prot, datë 24. 11.2014, për përfshirjen në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose shteses në ndërtim me leje.
- Kopje pasaporte shqiptare, në emër të M. Filaj për periudhën 2003-2013 dhe 2021-2031. Leje qëndrimi (në gjuhën greke) për periudhën 07.09.1998 - 31.12.1998. Leje punësimi, M. Filaj, për periudhën 23.01.2004 - 04.02.2004, 26.01.2007 - 09.02.2008, 18.06.2008 - 09.02.2010, 08.09.2010 - 09.02.2012 dhe 22.05.2012 - 09.02.2022.
- Vizë punësimi në emër të T. Boshnjaku (në gjuhën greke), për periudhën 23.01.2004 - 19.06.2004; 05.01.2005 - 19.06.2006. Leje qëndrimi datë 29.09.2006, datë 30.01.2009; datë 25.11.2010; për periudhën 28.03.2019 - 27.03.2024. Faqe pasaporte e vulosur, në emer të M. Filaj dhe T. Boshnjaku, ku vërtetohen hyrje daljet e tyre në vitet 1997, 1998.
- Dokumentacion në lidhje me të ardhurat e T. Boshnjaku 2003 - 2021; V. Filaj 2003 - 2020 dhe R. Filaj 2004 - 2015, trajtuar me sipër.

### **31. Me inventarin nr. extra prot., datë 02.08.2023, subjekti ka dorezuar në ILDKPKI:**

- Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se: në lidhje me ndërtimin e shtesës 40 m<sup>2</sup>, në dijeninë e tij, janë paguar 120.000 lekë. Gjithësesi, kjo shtesë është bërë për dy kate nga dy familje, familja e tij dhe familja me mbiemër Ç dhe është paguar përkatësisht pjesa takuese e detyrimit prej tyre. Siç ka deklaruar edhe me parë, nuk disponon fatura për këto detyrime, por secila familje ka paguar pjesën takuese. Burimi i të ardhurave për këtë pagese kanë qenë kursimet nga puna jashtë shtetit e prindërve dhe vellezërve të tij, si dhe të ardhurat nga puna e tij, të ardhurat familjare nga qiraja e ambientit rrugën “Myslym Shyri”.

Për sa me sipër, ai është interesuar për të kontaktuar përfaqësuesin e firmës së ndërtimit, që ka kryer punimet, me M. K, por nuk ka arritur të kontaktoje, pasi është informuar që ndodhet jashtë shtetit familjarisht, prej shumë vitesh. Në lidhje me shumën e paguar për truallin e shtesës 40 m<sup>2</sup>, (1.489.200 lekë) ka sqaruar se nuk ka paguar ende pjesën e tij të truallit (pjesa e tij takuese 1/5 e truallit), për shkak të mosdakordësisë që kanë patur me një nga banoret në atë kohë.

- Bashkëlidhur ka depozituar kopje të kartelës së pasurisë së paluajtshme, nr. i pasurisë \*\*\*\* në Zk.\*\*\*\*, ku në seksionin “E” është shkruar shënimi “kufizohet pasuria për zgjidhjen e marrëdhënieve me truallin, në bazë të urdhërit nr. \*\*\*, datë 09.02.2009”

### **32. Në lidhje me shtesën 18.3 m<sup>2</sup>, ka sqaruar se rregjistrimi i shtesës prej 18,3 m<sup>2</sup> në rregjistrin e pasurive të paluajtshme është kryer nga ana e tij nëpërmjet procesit të legalizimit dhe provohet nëpërmjet Lejes së Legalizimit nr. \*\*\*\* prot., datë 28.02.2012.**

Pas vetëdeklarimit për ndërtimin me sipërfaqe 18.3 m<sup>2</sup>, ekspertet e ALUIZNI-t Tiranë, kanë bërë matjet e sakta në terren dhe kanë konstatuar sipërfaqen e saktë të objektit sipas lejes së legalizimit.

Sa i përket pagesës së truallit të shtesës prej 18.3 m<sup>2</sup>, nuk disponon fatura dhe i ka dërguar kërkesë ASHK-se për të marrë informacion lidhur me këtë pagesë

- Në lidhje me vetdeklarimet e bëra në ASHK, ka sqaruar se, këto vetdeklarime janë bërë për pjesën e shtesës së fasadës së xhamit tek pasuria që jepet me qira në rrugën “Myslym Shyri”.

#### **Ka dorëzuar:**

- Kartelë e pasurisë së paluajtshme për pasurinë nr. \*\*\*\*, vol\*\*, fq. \*\*\*, Zk. \*\*\*, apartament me sip. 40 m<sup>2</sup>, në emër të Saimir Boshnjaku.
- Leje Legalizimi nr. \*\*\*, datë 28.02.2012 “Shtesë anësore 2 kate, për banim dhe shërbim, në objektin ekzistues 5 kate” në emër të F. C dhe Samir Boshnjaku, në pasurine nr. \*\*\*\*, Zk. \*\*\*, me sip. të parcelës ndërtimore 22.4 m<sup>2</sup>, nga e cila për banim 18.3 m<sup>2</sup> dhe për aktivitet 22.4 m<sup>2</sup>, numri i kateve 2.
- Kërkesë drejtuar ASHK, datë 30.06.2023, nga Sajmir Boshnjaku, për informacion dhe vënie në dispozicion të mandat pageses së kryer nga ana e tij, për sipërfaqen takuese të truallit për shtesën 18.3 m<sup>2</sup>, sipas Lejes së Legalizimit, nr. \*\*\*, datë 28.02.2012.
- Foto të fasadës së xhamit në Rruga. “Myslym Shyri”.

**33.** Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezulton se: Shtesa prej 40 m<sup>2</sup>, në apartamentin ekzistues me adresë në rrugën “Myslym Shyri”, Tiranë, është ndërtuar në vitin 1996 - 1998 dhe regjistruar në vitin 2010, nëpërmjet Lejes së Ndërtimit nr. \*\*, të vitit 1996. Shtesa prej 18.3 m<sup>2</sup>, është ndërtuar në vitin 1999 dhe është regjistruar me Leje në vitin 2012. Gjithashtu është bërë kërkesë për legalizim të fasadës së xhamit dhe shkallëve, pjesë e shtesës 40m<sup>2</sup>.

- Subjekti ka dhënë sqarime lidhur me shtesat 40 m<sup>2</sup> dhe 18.3 m<sup>2</sup>, në apartamentin e përfutur nga privatizimi, me sip. 65.7 m<sup>2</sup>, në rrugën “Myslym Shyri” në Tiranë dhe burimin financiar të përdorur për ndërtimin e tyre, në periudhën 1996 - 1999.
- Konfirmohet nga ASHK pronësia e subjektit në këto dy shtesa.
- Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues në lidhje me koston e ndërtimit, për shtesat me sip. 40 m<sup>2</sup> dhe 18.3 m<sup>2</sup>, ndërtuar në vitet 1996 - 1999, në Rruga “Myslym Shyri”, Tiranë, **rrjedhimisht është i aplikueshëm neni 32, pika 1.1 e ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.**

**34.** Kontratë blerje apartament banimi me sip.72 m<sup>2</sup>, me adresë: “Ish-Fusha e Aviacionit Civil” Kati \*\*, Ap. \*\*, nr. Rep. \*\*\*, nr. Kol. \*\*\*, datë 10.3.2000, i cili ka qenë në bashkëpronë si me bashkëshorten time Miranda Boshnjaku. Vlera 2.400.000 lekë. Burimi i krimit: Të ardhura nga kursimet e prindërve të bashkëshortes sime në shumën 2.000.000 lekë dhe 400.000 lekë, nga kursimet e mia dhe të ardhurat nga dhënia me qira e ambientit në pronësinë time dhe të familjarëve të mi, sipas çertifikates familjare të kohës. Kjo pasuri është shitur 1.900.000 lekë sipas aktit noterial nr. \*\*\*. Kol., nr. \*\*\*, Rep., datë 27.02.2001.

#### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontrate shitje nr. \*\*\*, Rep., nr. \*\*\*, Kol., datë 27.08.2001. Apartament me sip. 72 m<sup>2</sup>, Zk. \*\*\*\*, me adresë apartamenti \*\*\*, godina 6, ish Fusha e Aviacionit Civil Tiranë, në shumën 1.900.000 lekë. Palë shitëse Miranda Veshi dhe Saimir Boshnjaku.
- Kontrate blerje nr. \*\*\*, Rep., nr. \*\*\*, Kol., datë 11.03.2000, apartament me sip. 72 m<sup>2</sup>. Palë blerëse Saimir Boshnjaku dhe Miranda Veshi.

## Hetimi i trupës së vlerësimit.

35. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyrat Vendore, Tirana Rurale I, Tirana Rurale 2, Tirane Jug. Kamëz Vorë, Zonat e Stimuluara, me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 16.06.2023 nuk konfirmon pasuri në emër të subjektit dhe personave të lidhur.
36. Qendra Kombëtare e Biznesit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 04.05.2023, konfirmon se Saimir Boshnjaku dhe personat e lidhur, nuk figurojnë të jenë pajisur me NUIS (NIP-T), si persona fizikë apo të zotërojnë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë regjistrimit tregtar.
37. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.05.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur, nuk figurojnë të regjistruar në organet tatimore për ushtrim të ndonjë aktiviteti privat.

### **Me inventarin nr.extra prot., datë 03.07.2023,** subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

- Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se; ky apartment është blerë në vitin 2000 dhe është shitur në vitin 2001, sepse vendosën të investonin në blerjen e apartamentit pranë Kompleksit Dinamo, ku banon e aktualisht. Çmimi i blerjes, prej 2.400.000 lekë, u përballua kryesisht nga kursimet e prindërve të bashkëshortes dhe bashkëshortes së tij.
  - Prindërit e bashkëshortes kanë qenë fermerë në fshatin Çorraj të Qarkut Vlorë dhe të gjitha të ardhurat e tyre nga shitja e produkteve bujqësore janë depozituar në vite pranë ish-Bankës së Kursimeve, si dhe në depozita pranë ish-shoqërisë Xhafërri.  
Ferma e prindërve të bashkëshortes si tokë bujqësore provohet nga Vendimi nr. 7, i Këshillit të Komunës Lukovë, datë 08.04.2015, për pronësinë e tokës bujqësore të babait të bashkëshortes në Çorraj, Sarandë.  
Bashkëshortia është fëmijë i vetëm dhe të gjitha kursimet e tyre, në periudhën që ishin gjallë dhe ato që ata lanë pas vdekjes janë përfituar nga bashkëshortja e tij.
38. **Raiffeisen Bank**, konfirmon llogarinë bankare me nr. \*\*\*\*\* në pronësi të Miranda Boshnjaku dhe Varvara Veshi me veprime që prej datës 16.04.2004, ku rezulton dhe depozita në datë 16.04.2004, në vlerën **521,800 lekë**.
39. **Raiffeisen Bank**, konfirmon llogarinë bankare me nr. \*\*\*\*\* në pronësi të Janaq Veshi, me veprime që nga data 31.07.2003, ku rezulton depozita në datë 31.07.2003, në vlerën **228, 127 lekë**. Në lëvizjet e llogarisë për të dyja llogaritë, evidentohet se vlera për çeljen e tyre dhe specifikisht për llogarinë me nr. \*\*\*\*\* në pronësi të Janaq Veshi është 228. 127 lekë me përshkrimin “Llogari thesi për depozitë, kalim i tepricës në depozitë data 31.07.2003, për vlerën 228,127 ALL”.
- Nga ky përshkrim provohet se kjo shumë vjen e transferuar nga ish-Banka e Kursimeve. Po ashtu edhe për llogarinë me nr. \*\*\*\*\* në pronësi të Miranda Boshnjaku dhe Varvara Veshi, vlera e çeljes se saj është 521,800 lekë, me përshkrimin “Rimarrje e tepricës Ordin”.
  - Dega Banka Kombëtare Tregëtare Tirana 3, kalim teprice në depozitë, data 03.05.2004, për vlerën 521,800 lekë”. Nga ky përshkrim provohet se kjo shumë vjen e transferuar nga ish-Banka e Kursimeve. Për të provuar kohën e çeljes së llogarive të kursimit në ish-Bankën e Kursimeve nga Janaq Veshi dhe Varvara Veshi kanë depozituar një kërkesë me shkrim, datë 29.06.2023, pasi nuk kishin rekorde elektronike në sistemet aktuale, si Raiffeisen Bank.

### **Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar:**

- Kontrate Shitje nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 27.08.2001, apartment me sip. 72 m<sup>2</sup>, Zk. \*\*\*\*, me adresë: apartamenti 30, godina 6, ish-Fusha e Aviacionit Civil Tiranë, në shumën 1.900.000 lekë. Palë shitëse Miranda Veshi dhe Saimir Boshnjaku.
- Bashkëlidhur, kontratë blerje nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 11.03.2000, apartment me sip. 72 m<sup>2</sup>, në shumën 2.400.000 lekë, shumë e cila do paguhet cash deri në datë 06.09.2000. Palë

blerëse Saimir Boshnjaku dhe Miranda Veshi. Kërkesë drejtuar Raiffeisen Bank, datë 29.06.2023, në lidhje me llogaritë bankare në emër të Miranda Veshi Boshnjaku, Varvara Veshi dhe Janaq Veshi, që nga 01.01.1990 e në vijim.

- Vendimin nr. \*\*, datë 08.04.2015, nga Këshilli i Komunës Lukovë, për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve, ku është vendosur kalimi nga përdorimi në pronësi e tokë sipas listës, ndër ta edhe Janaq Veshi.

✚ *Bashkëlidhur* Plan Rilevimi, i pasurisë me nr. \*\*\*\*\*, me sip. 900 m<sup>2</sup>, në pronësi të Janaq Veshi. Plan Vendosije e tokës bujqësore.

- Foto të shtëpise se prinderve dhe tokës përreth saj, te ndodhur në fshatin Çorraj, Bashkia Himarë. (2 copë)

#### **40. Me e-mailin e datës 07.07.2023, subjekti ka dorëzuar:**

- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, në emër të Janaq Veshi, për periudhën 31.07.2003 - 30.07.2004.
- ✚ Konfirmohet gjendje në llogari në datë 31.07.2003, në shumën 228.127 lekë, me përshkrimin “*Rimarrje tepricës*”, llogari thesi për depozitë.

Kalim i tepricës në depozitë. Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, në emër të Janaq Veshi, për periudhën 01.10.2004 - 23.04.2007. Konfirmohet depozitë në shumën 242.911 lekë, në datën 01.10.2004. Mbyllur depozita në datën 23.04.2007, në shumën 257.455 lekë. (konfirmohet nga RFZ se kjo shumë është kredituar në llogarinë e bashkëshortes se subjektit, në datë 23.04.2007.

✚ Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, nr. \*\*\*\*\*, ku konfirmohet depozitë e hapur në datën 03.05.2004 deri në 16.04.2004, në shumën 521.800 lekë, me përshkrimin e veprimit “*Rimarrje e tepricës, dega BKT Tirana 3, kalim teprice në depozitë*”.

✚ Konfirmohet llogari në monedhën lekë në datë 27.09.2004, në shumën 194.816 lekë, me përshkrimin “*Urdhër pagese brenda bankës*”.

✚ Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, në emër të Miranda Boshnjaku, për periudhën 03.05.2005 - 04.05.2010, ku konfirmohet kreditimi i pages për periudhën 03.05.2005 - 04.05.2010, si dhe depozitë e hapur në datë 02.10.2008, në shumën 1.554.000 lekë, nga të cilat kredituar shuma 1.354.001 lekë, në datë 02.10.2008, me shënimin “*Mb dublikimi*” + transferuar nga llogaria e pagës shuma 200.000 lekë. Furnizuar depozita nga llogaria e pagës e bashkëshortes, në shumën 200.000 lekë + 373.000 lekë, deri në datën 15.11.2010, ku është bërë dhe maturimi i saj në shumën 2.313.180 lekë dhe tërhequr shuma 2.300.000 lekë, në datë 17.11.2010.

✚ **Me inventarin nr. extra prot., datë 02.08.2023, subjekti ka dorëzuar ne ILDKPKI:**

Vërtetim datë 28.07.2023, nga Raiffeisen Bank, ku vërtetohet se nga kërkimi i bërë në indekset dhe inventaret e depozitave të Agjencisë 8, Tiranë, nuk gjejnë depozitë për klientet Janaq Veshi - Varvara Veshi - Miranda Veshi (Boshnjaku).

#### **Me e-mailin e datës 10.10.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:**

Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se në dijenin e e tij ferma e prindërve të bashkëshortes ka ekzistuar dhe gjithashtu nga Shërbimet Rajonale të Drejtorise se Bujqësisë Sarandë dhe Vlorë është trajtuar me këshillime, regjistrime të nevojshme, vaksinime dhe dizinfektime për mbrojtjen ndaj sëmundjeve, si të bimëve edhe të kafshëve.

I është drejtuar Ministrisë së Bujqësisë për t'i kërkuar informacion për periudhën 1992 - 2000 dhe në përgjigje i kanë konfirmuar se sistemi elektronik i informacionit veterinar dhe blegtoral është krijuar në vitin 2011 dhe për këtë periudhë nuk kanë informacion. Të vetmin dokumentacion që ka arritur të sigurojë brenda kësaj kohe është vertetimi nga kryeplaku i Njesisë Administrative Çorraj, i cili me përgjegjësi ligjore deklaroi me shkrim dijeninë e tij se prindërit e bashkëshortes së subjektit, të cilët aktualisht kanë ndërruar jetë, kanë qenë anëtarë të familjes bujqësore dhe kanë pasur në pronësi tokë bujqësore.

#### **Ka dorëzuar:**

- Vërtetim nga Kryeplaku i fshatit Çorraj, Bashkia Himarë (ish- Komuna Lukovë), Mihal Duka. Është konfirmuar se Janaq Veshi dhe bashkëshortja e tij Varvara Veshi, kanë qenë, deri ditën që kanë ndërruar jetë, banorë të fshatit Corraj, Bashkia Himarë. Kanë qenë anëtare të familjes bujqësore, kanë jetuar në shtëpinë e ndërtuar nga paraardhësit e tyre dhe kanë përfituar tokë bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, "Për tokën", por si gjithë banoret e fshatit, këto toka bujqësore nuk i janë nënshtruar procesit të regjistrimit përfundimtar. Aktualisht shtëpia e tyre mirëmbahet nga vajza e tyre Miranda Boshnjaku (Veshi), së cilës i ka kaluar pronësia ligjore.

**Korrespondencë e-mailit datë 09.10.2023**, me Ministrinë e Bujqësisë ku kërkohet informacion në lidhje me shtetasit Janaq dhe Varvara Veshi, banues në fshatin Çorraj, Bashkia Himarë, sa bagëti kanë pasur nga viti 1992 - 2000 dhe a kanë qenë të regjistruar sipas procedurave të kohës, dhe përgjigja e tyre se:

- ✚ "Sistemi elektronik i Informacionit Veterinar dhe Blegtoral "RUDA": Është krijuar në vitin 2011. Për periudhën 1992 - 2000, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nuk disponon informacion të detajuar në nivel ferme.

Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezultoi se: Apartamenti me sip. 72m<sup>2</sup>, të ish-Fusha e Aviacionit, Tiranë, është përfituar me kontratë blerje në vitin 2000, me burim: kursime të prindërve të bashkëshortes, të vetë bashkëshortes së tij dhe të subjektit. Ky apartamenti është shitur në vitin 2001.

#### **Pasuria nr. 5**

- ❖ Apartament me sip. 67.90 m<sup>2</sup>, adresa rruga, "Poseidon", Nd. \*\*, H. \*\*, Ap. \*\*, Shkallnur, Rrashbull, 2021 Durrës, në bashkëpronësi me bashkëshorten time, me kontratë sipërmarrje me shoqërinë e ndërtimit "Kërcuku" sh.p.k, lidhur në datë 12.11.2010. nr. pronë \*\*\*\*\*, Zk. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\* e regjistruar në ZVRPP Durrës. **Vlera 32.500 Euro. Vera takuese 16.250 Euro**, sip. takuese 33.95 m<sup>2</sup>, Certificate Pronësie nr. \*\*\*\*\*, datë 20.07.2020. **Burimi i krijimit: Të ardhura** -shuma 24.000 Euro, nga pagat dhe kursimet e gruas M. Boshnjaku dhe nënës së saj V. Veshi, në ish-Arka e Kursimit, transferuar në llogaritë Raiffeisen Bank dhe cash. **Të ardhura** - 6.000 Euro, nga të ardhurat e familjes sime gjatë viteve 2011 - 2018. Shuma 2.500 Euro, shume e shlyer deri në marrjen e certifikates, Hipotekë nr. \*\*\*\*\*, datë 20.07.2020. **Zotëron 100%** me bashkëshorten.

#### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Certificate për vërtetim pronësie, për pasurine apartament me sip. 67.90 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*, Zk. \*\*\*\*\*, në emër të Miranda dhe Saimir Boshnjaku, lëshuar në datë 20.07.2020.

- Kontratë sipërmarrje datë 12.11.2010, për apartament me sip. 76 m<sup>2</sup>, kati gjashtë, në objektin që po ndërtohet pranë Shkëmbit të Kavajës, Durrës, **çmimi i apartamentit** 32.500 Euro, shumë e cila është likuajduar cash, në datë 12.11.2010, palë porositëse V. V dhe M. Boshnjaku.
- Kontratë prenotim apartamenti nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 08.07.2019, palë porositëse Miranda Boshnjaku dhe V.V, ku pala porositëse sipas kontratës së sipërmarrjes se datës 12.11.2010, ka porositur apartament me sip. 76 m<sup>2</sup>, në katin e 6 të banimit, në vlerën 32.500 euro, shumë e paguar plotësisht në datë 12.11.2010.

✚ **ASHK Drejtoria Vendore Durrës**, me shkresën nr. \*\*\*\* prot., datë 03.07.2023, konfirmon pasurinë \*\*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*, Zk. \*\*, apartament në bashkëpronësi të Saimir dhe Miranda Boshnjaku.

### **Bashkëlidhur:**

- Kartela e pasurisë së paluajtshme, apartament me sip. 67.9 m<sup>2</sup>, me adresë Plazh \*\*, Durrës, shk. I, ap. \*\*.
- Kontratë blerje pasuri e paluajtshme nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 18.07.2020. Palë blerëse Miranda Boshnjaku. Apartament me nr. pasurie \*\*\*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*, zk. \*\*\*, me sip. 67.90 m<sup>2</sup> + 8.1 m<sup>2</sup>, sipërfaqe të përbashkëta, shk.\*\*\*, kati \*\*, ap. \*\*, ndodhur në lagjen 13, Plazh, Durrës, në vlerën 32.500 euro. Vlerë e cila është likuiduar totalisht sipas kontratës së prenotimit nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 08.07.2019. **Bashkëlidhur:** Certifikatë për vërtetim pronësie, i apartamentit në emër të ndërtuesit.
- Kontratë prenotim apartamenti nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 08.07.2019, me palë porositëse Miranda Boshnjaku dhe Varvara Veshi. **Vlera e apartamentit** 32. 500 euro.
- Kontratë sipërmarrje datë 12.11.2010, me palë porositëse Varvara Veshi dhe Miranda Boshnjaku. Apartament me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup>, në vlerën 32.500 euro, shumë e likuajduar cash në datën 12.11.2010.
- Mandat arkëtimi datë 12.11.2010, për shumën 32.500 euro, nga Varvara Veshi, Miranda Boshnjaku.
- Vendim për Lëshimin e Dëshmisë se Trashëgimisë Ligjore, nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 17.07.2020, për trashëgimlënësin V.V, e cila ka ndërruar jetë në datë 01.05.2020, trashëgimtare e vetme e radhës së parë është Miranda Boshnjaku.

**Me inventarin nr. extra prot., datë 03.07.2023**, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se:

Pagesa e blerjes së këtij aseti prej 30,000 Euro është bërë në datën 17.11.2010, pra 5 ditë pas datës së cilësuar në kontratë-porosi. Në kontrate referohet shuma prej 32,500 Euro dhe pjesa e mbetur prej 2,500 Euro u dakordësua të paguhej në momentin e rregjistrimit në hipoteke të titullit të pronësisë (*ky dakordësim u bë në mirëbesim dhe nuk është shprehur në kontratë*). Siç u përmend me lart, prindërit e bashkëshortes kanë patur të ardhura nga ferma bujqësore, që më së shumti janë depozituar në një llogari të përbashkët të bashkëshortes se tij me nënën e saj, në Raiffeisen Bank, me nr. \*\*\*\*\*.

✚ Në vitin 2008 ka patur depozitë në shumën 1.554.000 lekë, e krijuar nga kursime të familjes dhe tërheqja e shumës 257.466 lekë, nga teprica e llogarisë së babait të saj në Raiffeisen Bank, pas vdekjes se tij me anë të dëshmisë së trashëgimisë se çelur me Vendim Giykate, nr. \*\*\*\* Akti, nr. Vendimi \*\*\*\*\*, datë 06.11.2006. Nga kjo llogari, bashkëshortja e tij Miranda Boshnjaku, ka tërhequr shumën 2,300,000 lekë në datën 17.11.2010. Ky veprim paraprihet nga një prishje e depozitës me interes në emër të Miranda Boshnjaku, para afatit, po në këte llogari, për shumën 2,313,180 lekë. Kjo depozite është krijuar në vite nga kursime të familjes së tyre dhe të prindërve

të bashkëshortes, por që depozitoheshin në llogarinë e Miranda Boshnjaku dhe V. V (nëna e bashkëshortes). Nuk mund të shprehet për një vlerë të saktë të shumës se kontribuar nga nëna e bashkëshortes apo kursimet familjare të bashkëshortes, pasi në familje kursimet i kanë kontribuar bashkarisht dhe nuk kanë mbajtur shënime. Edhe llogaria bankare, siç u referua me lart, ka qenë llogari e përbashkët, e bashkëshortes dhe nënës së saj.

Burimi i të ardhurave për të gjitha asetet e investuara të familjes së tij kanë qenë kursimet familjare. Në vijimësi ka deklaruar që ka administruar kursimet familjare nga pagat dhe qeratë. Për përfshirjen e emrit të tij në certifikatën e pasurisë, ka sqaruar se është bërë sipas kritereve ligjore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe nga noterja me dy bashkëpronar, pasi është konsideruar si pasuri e vëne pas martese. Gjithashtu, certifikata është marrë në korrik 2020, kur mamaja e bashkëshortes kishte ndërruar jetë dhe bashkëshortja e tij është fëmijë i vetëm. Shpenzimet për mobilimin e shtëpise në Durrës, janë kryer gjatë vitit 2010 për afërsisht në vlerën 200,000 lekë. Për këto shpenzime nuk disponojnë fatura nga furnitorët.

#### **Ka dorëzuar:**

- Certifikatë vdekje datë 08.05.2020, për V.V. Konfirmohet se ka ndërruar jete në datë 01.05.2020.
- Vendim për Lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë Ligjore nr. \*\*\*\* Rep, nr. \*\*\* Kol. datë 17.7.2020, për trashëgimlënësin V. V, e cila ka ndërruar jetë në datë 01.05.2020. Trashëgimtare e vetme e radhës së parë është Miranda Boshnjaku.
- Vendim nr. \*\*\*, datë 06.11.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për lëshim dëshmi trashëgimie për trashëgimlënësin J. V, i cili ka ndërruar jetë në datë 16.05.2005. Trashëgimtar ligjor të shkallës së parë janë njohur: V. V, bashkëshortja dhe Miranda Boshniaku e bija,

#### **- Me e-mailin e datës 07.07.2023, subjekti ka dorëzuar:**

- Foto për arredimin e brendshëm të apartamentit në Durrës. (1 fletë).
- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank në emër të Miranda Boshnjaku, për periudhën 03.05.2005 - 04.05.2010, ku konfirmohet kreditimi i pagës për periudhën 03.05.2005 - 04.05.2010, si dhe depozitë e hapur në datë 02.10.2008, në shumën 1.554.000 lekë nga të cilat kredituar shuma 1.354.001 lekë, në datë 02.10.2008 me shënimin “Mbi dublikimi” + transferuar nga llogaria e pagës shuma 200.000 lekë dhe shuma totale 1.554.000 lekë ka kaluar në depozitë. Furnizuar depozita nga llogaria e pagës e bashkëshortes në shumat 200.000 lekë + 373.000 lekë, deri në datën 15.11.2010, ku është bërë dhe maturimi i saj në shumën 2.313.180 lekë dhe tërhequr shuma 2.300.000 lekë, në datë 17.11.2010.

#### **- Me e-mailin e datës 10.10.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:**

- Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se në dijeninë e tij ferma e prindërve të bashkëshortes ka ekzistuar dhe gjithashtu nga shërbimet rajonale të Drejtorisë së Bujqësisë Sarandë dhe Vlorë është trajtuar me këshillime, regjistrime të nevojshme, vaksinime dhe dizinfektime për mbrotjen ndaj sëmundjeve, si të bimëve edhe të kafshëve. I është drejtuar Ministrisë së Bujqësisë për ti kërkuar informacion për periudhat 1992-2000 dhe në përgjigjen e tyre i kanë konfirmuar se sistemi elektronik i informacionit veterinar dhe blegtoral është krijuar në vitin 2011 dhe për këtë periudhë nuk kanë informacion. Të vetmin dokumentacion që ka arritur të sigurojë brenda kësaj kohë është vërtetimi nga kryeplaku i Njësisë Administrative Çorraj, i cili me përgjegjësi ligjore deklaroi me shkrim dijeninë e tij, se prindërit e bashkëshortes së subjektit, të cilët aktualisht kanë ndërruar jetë kanë qenë anëtare të familjes bujqësore dhe kanë pasur në pronësi toke bujqësore.



## **Ka dorëzuar:**

- Vërtetim nga Kryeplaku i fshatit Çorraj, Bashkia Himarë (ish Komuna Lukovë), shtetasi M. D. Është konfirmuar se J.V dhe bashkëshortja e tij V.V, kanë qenë, deri ditën që kanë ndërruar jetë, banorë të fshatit Çorraj, Bashkia Himarë. Kanë qenë anëtarë të familjes bujqësore, kanë jetuar në shtëpinë e ndërtuar nga paraardhësit e tyre dhe kanë përfutur tokë bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, por si gjithë banorët e fshatit këto toka bujqësore nuk i janë nënshtruar procesit të regjistrimit përfundimtar. Aktualisht shtëpia e tyre mirëmbahet nga vajza e tyre Miranda Boshnjaku së cilës i ka kaluar pronësia ligjore.
- ✓ Apartamenti me sip. 67.90 m<sup>2</sup>, adresa rruga, “Poseidon në Rrashbull, Durrës, në zotërim të subjektit dhe bashkëshortes, është përfutur me kontrate sipërmarrje në vitin 2010, kontratë prenotimi të vitit 2019 dhe kontrate blerje të vitit 2020, në vlerën 32.500 Euro, me burim, kursime të prindërve të bashkëshortes dhe të bashkëshortes së tij.

## **Pasuri nr. 6**

- ✚ Garazh makine me sip. 16 m<sup>2</sup>, me adresë “Ish-Fusha e Aviacionit Civil”, garazhi nr. \*\*, kontratë nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 11.09.2000, e cila ka qenë në bashkëpronësi me bashkëshorten time Miranda Boshnjaku. **Vlera** 600.000 lekë. **Burimi i krijimit:** Të ardhura nga kursimet e mia dhe të ardhura nga kursimet e familjarëve të mi, si dhe nga dhënia me qera e ambjentit në pronësinë time dhe të familjarëve të mi, sipas certifikatës familjare të kohës. Kjo pasuri është shitur në vlerën 100.000 lekë, sipas aktit noterial nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 08.07.2002.

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontratë blerje datë 11.09.2000, garazh me sip. 16 m<sup>2</sup> në shumën 600.000 lekë. Palë blerëse Saimir Boshnjaku dhe Miranda Veshi.
- Kontratë shit-blerje pasuri e paluajtshme, garazhd nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol, datë 08.07.2002. Palë shitëse Samir Boshnjaku dhe Miranda Veshi në shumën 100.000 lekë.
- Vërtetim pronësie nga dokumentet hipotekore, nr. 162 prot., datë 01.08.2002, në emër të palës blerëse U. F.

- ✚ **ASHK-Zyrat Vendore**, Tirana Rurale I, Tirana Rurale 2, Tiranë Jug, Kamëz Vorë. Zonat e Stimuluara, me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 16.06.2023, nuk konfirmojnë pasuri në emër të subjektit dhe personave të lidhur. Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezulton se: Garazhi me sip. 16 m<sup>2</sup>, të ish-Fusha e Aviacionit, Tiranë, është përfutur me kontratë blerje në vitin 2000, me burim, kursime nga të ardhurat familjare dhe qiradhënia. Garazhi është shitur në vitin 2002.

- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar.

## **Pasuria nr. 7**

- ✚ Autoveture tip Mercedes-Benz viti 2003, në vlerën 600.000 lekë. **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga shitja e makinës tip Land Rover, kontratë nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\*\* Kol datë 18.03.2017. Makina është shitur 1.250.000 lekë. Ky automjet është shitur në vlerën 4.000 Euro, sipas aktit noterial nr. \*\* Rep., nr. \*\* Kol., datë 20.01.2022.

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontrate shitje automjeti nr. \*\* Rep., nr. \*\* Kol., datë 20.01.2022 automjet Daimler Chrysler nr. shasie \*\*\*\*\*, me targë AA2520A, në shumën 4.000 Euro. Palë shitëse Saimir Boshnjaku.

**Bashkëlidhur:** Certifikata e pronësisë së mjetit rrugor + leje qarkullimi në emër të Saimir Boshnjaku.

- Kontratë blerje automjeti nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 18.03.2017. Automjeti Daimler Chrysler, nr. shasje \*\*\*\*\*, në shumën 600.000 lekë. Palë blerëse Saimir Boshnjaku, **për burimin e krijimit:** Kontratë Shitje automjeti nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 18.03.2017. Automjet Land Rover, në shumën 1.250.000 lekë. Palë shitesë Saimir Boshnjaku.

✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor**, me shkresën nr. \*\* prot., datë 22.05.2023, konfirmon se Saimir Boshnjaku ka pasur të regjistruar automjetin.

**Bashkëlidhur:**

- Kontratë shitje automjeti, datë 20.01.2022 Automjet Daimler Chrysler nr. shasje \*\*\*\*\*, në shumën 4.000 Euro. Palë shitëse Saimir Boshnjaku.
- Certifikata e pronësisë së mjetit rrugor + leje qarkullimi.
- Kontratë blerje automjeti nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\*\* Kol., datë 18.03.2017. Automjeti Daimler Chrysler nr. shasje \*\*\*\*\*, në shumën 600.000 lekë. Palë blerëse Samir Boshnjaku.

✚ **Konstatohet:** Automjeti Mercedes Benz, është blerë në vitin 2017 (me burim nga të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit Land Rover) dhe shitur në vitin 2022.

- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.

**Pasuria nr. 8**

✚ Makine tip Land Rover në vlerën 950.000 lekë. **Burimi i krijimit:** të ardhurat nga shitja e makines tip Volksägen golf plus, kontrate nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\*\* Kol., datë 28.10.2014 dhe të ardhurat nga kursimet e mia. Makina është shitur 900.000 lekë. Ky automjet është shitur në vlerën 1.250.000 lekë, sipas aktit noterial nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\*\* Kol., datë 18.03.2017.

**Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontratë shitje automjeti nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\*\* Kol., datë 18.03.2017. Automjet Land Rover, në shumën 1.250.000 lekë. Palë shitëse Saimir Boshnjaku.
- Kontratë blerje automjeti nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\*\* Kol., datë 21.10.2014, automjet Land Rover, në shumën 950.000 lekë. Pale blerëse Saimir Boshnjaku. **Për burimin e krijimit:** Kontrate shitje automjeti nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\*\* Kol., datë 28.10.2014. Automjet Volksägen Golf, në shumën 900.000 lekë. Palë shitëse Saimir Boshnjaku.

✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.05.2023, konfirmon se Saimir Boshnjaku ka pasur të regjistruar automjetin.

**Bashkëlidhur:**

- Kontratë shitje automjeti nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 18.03.2017, automjet Land Rover, në shumën 1.250.000 lekë, palë shitëse Saimir Boshnjaku.
- Kontratë blerje automjeti nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\*\* Kol., datë 21.10.2014. Automjet Land Rover, në shumën 950.000 lekë, palë blerëse Saimir Boshnjaku.

Me inventarin nr. extra prot., datë 03.07.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

- Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se: Automjeti Land Rover është blerë me kontratë blerje të datës 21.10.2014, në shumën 950.000 lekë. Kjo makinë ka patur një gjendje teknike shumë të mirë, përveç disa dëmtimeve të vogla që subjekti i ka riparuar me kosto të vogla. Gjendja e

mirë teknike në ditën e shitjes erdhi si pasoje e mospërdorimit të tepërt nga ana e tij pasi, për këtë periudhë, e ka patur shume pak të nevojshme përdorimin e makinës personale për nevoja pune, sepse në punë përdorte mjetin që kishte në dispozicion vendi i punës. Ndërkohë, çmimi i tregut kishte pësuar rritje dhe kishte kërkesa për mjete të tilla, prandaj vendosi që ta shiste këtë mjet. Është kontaktuar nga përfaqësuesi i një shoqërie tregtare (ANI-AUTO shpk), i cili ishte shumë i kënaqur me gjendjen teknike të makinës, pasi qëllimi i tyre ishte për përdorim biznesi të mjetit Land Rover dhe pranuan çmimin e ofruar. Në këto kushte është nënshkruar kontrata e shitjes në datë 18.03.2017, në shumën 1.250.000 lekë.

- Në lidhje me automjetin tip Golf, ka sqaruar se është dakordësuar për shitje më datë 21.10.2014, datë në të cilën është arkëtuar shuma prej 900.000 lekë, ndërsa kontrata e shitjes tek noteri u vonua për rreth një javë, sepse patën vonesa në kompletimin e dokumentacionit (leje qarkullimi, etj.). Në këto kushte, kjo kontratë, u nënshkrua para noterit, më datë 28.10.2014. Shuma prej 900.000 lekë, e arkëtuar me datë 21.10.2014, u përdor direkt për blerjen e automjetit Land Rover, po në këtë datë, pra kësaj shumë i janë shtuar edhe 50.000 lekë (nga kursimet) dhe është blerë automjeti Land Rover.

#### ✚ **Me e-mailin e datës 10.10.2023**, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

Sqarime me shkrim, ku ka rideklaruar se automjeti Land Rover është blerë sipas kontratës blerjes, datë 21.10.2014, në shumën 950.000 lekë dhe i është shitur shoqërisë tregtare (ANI-AUTO sh.p.k). Duke qenë se blerësi ishte kompani, ka menduar që tatimi do të paguhej nga blerësi, në momentin e regjistrimit prej tij, siç ndodh me pasuritë e paluajtshme. Nuk ka patur asnjë informacion lidhur me ndonjë detyrim për të deklaruar dhe paguar tatim për këtë shitje. Me procedurat e regjistrimit të automjetit në DSHTRR është marrë blerësi. Megjithatë menjëherë ka bërë deklaratën tatimore me 09.10.2023 dhe ka paguar detyrimin tatimor për fitimin nga shitja. **Ka dorëzuar:**

- Deklarimin e tatimit mbi fitimin, si dhe mandat pagesën e datës 01.10.2023, në shumën 45.150 lekë.

#### ✚ **Me inventarin nr. extra prot., datë 02.08.2023**, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

Sqarime me shkrim, ku ka sqaruar se: shuma prej 900.000 lekë është arkëtuar cash (jo nëpërmjet llogarisë bankare). Konstatohet: Automjeti Land Rover është blerë në vitin 2014, në vlerën 950.000 lekë (me të ardhurat e perfituara nga shitja e automjetit të mëparshëm tip Golf ), si dhe një pjesë nga kursimet. Automjeti është shitur në vitin 2017 në vlerën 1.250.000 lekë. Subjekti ka paguar detyrimin tatimor në vlerën 45.000 lekë.

#### **Pasuria nr.9**

- ✚ Makinë tip **Volksëagen** Golf Plus, në vlerën 9.000 Euro. **Burimi i krijimit:** Të ardhura nga shitja e makinës tip Ford Focus, kontratë nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 22.03.2012 dhe nga të ardhurat nga kursimet e mia. Makina është shitur 5.000 euro. Ky automjet është shitur në vlerën 900.000 lekë, sipas aktit noterial nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\*\* Kol., datë 28.10.2014.

#### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontratë shitje automjeti nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\*\* Kol., datë 28.10.2014. Automjet Volkswagen Golf, në shumën 900.000 lekë. Pale shitëse Saimir Boshnjaku.
- Kontratë blerje automjeti nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol, datë 01.12.2011. Automjet Volkswagen Golf, në shumën 9.000 Euro. Palë blerëse Saimir Boshnjaku. **Për burimin e krijimit:**

- Kontrate shitje automjeti nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 22.03.2012 Automjet Ford Focus, me targë \*\*\*\*\*, në shumën 5.000 Euro. Palë shitëse Saimir Boshnjaku.

✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor**, me shkresën nr. \*\*\* prot datë 22.05.2023, konfirmon se Saimir Boshnjaku ka pasur të regjistruar automjetin.

- **Me inventarin nr.extra prot., datë 03.07.2023**, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se:

- Automjeti VW GOLF, sipas kontratës së blerjes datë 01.12.2011, është blerë për çmimin 9.000 euro, ku shitësit e tij, sipas kësaj kontrate, janë shtetasit A. B dhe A. B. Nga ana tjetër, personave të së njëjtës familje i është shitur automjeti tip Ford Focus, me çmim 5.000 euro, me një deklaratë dypalëshe, që nuk e disponojmë dhe kontrata formale tek noteri u bë me rreth 4 muaj vonesë, sipas kontratës nr. \*\*\*\* Rep, nr. \*\*\*\* Kol, datë 02.03.2012 (*ju lutem referojuni kësaj kontrate depozituar pranë jush me deklarinimin fillestar*). Pra siç shihet, me personat e të njëjtës familje, janë bërë dy transaksione:
- Është blerë makina tip VW GOLF për çmimin 9.000 euro. Është shitur makina Ford për çmimin 5.000 euro dhe nga ana ime është paguar cash vetëm diferenca prej 4.000 Euro. Siç shihet, blerësi është shtetasi A. B. Në çmimin e blerjes se makines tip Golf, kemi rënë dakort të përfshijmë edhe çmimin e shitjes së makinës Ford Focus, pasi blerësi i saj është familjari i shitësit të makinës dhe nga ana ime i është paguar cash vetëm diferenca prej 4.000 Euro.

- **Me inventarin nr. extra prot., datë 02.08.2023**, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

- ✚ Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se shuma prej 900.000 lekë është arkëtuar cash (jo nëpërmjet logarisë bankare).
- ✓ **Konstatohet:** Automjeti tip Volkswagen Golf, është blerë në vitin 2011, në vlerën 9.000 euro dhe shitur në vitin 2014, në vlerën 900.000 lekë.

### **Pasuria nr. 10**

- ✚ Makinë tip Ford Focus \*\*\*\*\*, kontratë nr. Rep \*\*\*\*., nr. Kol \*\*\*, datë 22.03.2012, në vlerën 5.000 Euro. **Burimi i krijimit:** Të ardhura nga kursimet e mia dhe nga të ardhurat e dhënies së ambientit me qira në bashkëpronësi. Ky automjet është shitur në vlerën 5.000 Euro, sipas aktit noterial nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\*\* Kol., datë 22.03.2012.

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontratë shitje automjeti nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\*\* Kol., datë 22.03.2012. Automjet Ford Focus, me nr. shasje \*\*\*\*\*, në shumën 5.000 Euro. Palë shitëse Saimir Boshnjaku.
- Kontrate blerje automjeti nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\*\* Kol., datë 10.05.2009. Automjet Ford Focus, me nr. shasje \*\*\*\*\*, në shumën 5.000 Euro. Palë blerëse Saimir Boshnjaku.

### **Për burimin e krijimit:**

- Kontrate qiraje nr. \*\*\*\* Rep., datë 13.1.2006, për apartament të ndodhur në Rruga “Myslym Shyri”, me sip. 40 m<sup>2</sup>, me afat 3 vjet (01.02.2006 - 01.02.2009) në shumën 600 USD në muaj. Qiradhënës Saimir Boshnjaku dhe qiramarrës B. V.

- Kontrate qiraje nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 14.05.2008, për apartament në Rrugën “Myslym Shyri” me sip. 130 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*\*\* dhe nr. \*\*, ZK. \*\*\* për periudhën 01.02.2008 - 01.02.2010, në shumën 40.000 lekë/muaj. Qiradhënes T. Boshnjaku dhe qiramarrës F. K.
- Kontratë qiraje datë 28.03.2009, për apartament në Rrugën “Myslym Shyri” me sip. 130 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*\*\* dhe nr. \*\*\* ZK. \*\*, për periudhën 01.05.2009 - 31.5.2010, në shumën 30.000 lekë/muaj. Qiradhënës Samir Boshnjaku dhe Tasi Boshnjaku dhe qiramarrës shoqëria “D.N.H” shpk.

✚ **Drejtoria e Përgjithshme Shërbimeve të Transportit Rrugor**, me shkresën nr. \*\*\*\* prot datë 22.05.2023, konfirmon se Saimir Boshnjaku ka pasur të regjistruar automjetin.

#### **Bashkëlidhur:**

- Kontratë shitje automjeti nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\*\* Kol., datë 22.03.2012. Automjet Ford Focus, nr. shasje \*\*\*\*\*, në shumën 5.000 Euro. Palë shitëse Saimir Boshnjaku.
  - Kontratë blerje automjeti nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\*\* Kol., datë 10.05.2009. Automjet Ford Focus, me nr. shasje \*\*\*\*\*, në shumën 5000 Euro. Palë blerëse Saimir Boshnjaku.
- ✓ **Konstatohet:** Automjeti tip Ford Focus, është blerë në vitin 2009, në shumën 5.000 euro (me të ardhurat nga paga e subjektit, si dhe nga qiradhënia) dhe është shitur në vitin 2012, në shumën 5.000 euro.
- ✓ **Konfirmohet** deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.

#### **Pasuria nr.11**

✚ Makinë Opel Omega, në vlerën 3.600 marka gjermane. **Burimi i krijimit:** Të ardhura nga kursimet e mia dhe familjarët e mi, si dhe nga të ardhurat e dhënies së ambientit me qira në bashkëpronësi, kontratë nr. \*\*\*\*\* Rep., nr. \*\*\*\* Kol., datë 24.10.1998. Ky automjet është shitur në vlerën 100.000 lekë, nuk disponohet akti i shitjes.

#### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontratë blerje automjeti nr. \*\*\*\*\* Rep., nr. \*\*\*\* Kol, datë 24.10.1998. Automjet Opel Omega, me nr. shasje \*\*\*\*\*, në shumën 3.600 marka gjermane. Palë blerëse Samir Boshnjaku. **Për burimin e krijimit:**
    - Kontrate qiraje datë 25.09.1997, për apartament me sip. 50 m<sup>2</sup>, me afat 3 vjeçar (01.10.1997-31.9.2000), në shumën 700 usd/në muaj.
- ✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 22.05.2023, konfirmon se Saimir Boshnjaku ka pasur të regjistruar automjetin.

#### **Bashkëlidhur:**

- Kontratë blerje automjeti \*\*\*\*\* Rep, nr. \*\*\*\* Kol, datë 24. 10. 1998. Automjet Opel Omega, me nr. shasje \*\*\*\*\*, në shumën 3.600 marka gjermane. Palë blerëse Samir Boshnjaku.
- ✓ **Konstatohet:** Automjeti tip Opel është blerë në vitin 1998, në shumën 3.6000 marka gjermane, me të ardhura nga kursimet e subjektit, familjarët e tij, si dhe nga të ardhurat e dhënies me qira të ambientit në bashkëpronësi.

- ✓ **Konfirmohet** deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.

### **Pasuria nr. 13**

- ✚ Motor tip Suzuki Burgman, në vlerën 150.000 lekë. Motorri është shitur me kontratë nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\*\* Kol., datë 03.10.2015, në shumën 30.000 lekë. **Burimi i krijimit:** Të ardhura nga kursimet e mia.

#### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontratë shitje nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 03.10.2015. Motor “Suzuki” Burgman, në shumën 30.000 lekë. Palë shitëse Saimir Boshnjaku.
- ✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 22.05.2023, konfirmon se Saimir Boshnjaku ka pasuri të regjistruar, mjetin.

#### *Bashkëlidhur:*

- Kontratë shitje nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\*\* Kol., datë 03.10.2015. Motor “Suzuki” Burgman në shumën 30.000 lekë. Palë shitëse Saimir Boshnjaku. Fature tatimore shitje nr. \*\*\*\*, datë 11.06.2013, me palë blerëse Saimir Boshnjaku. Motor “Suzuki” në vlerën 36.000 lekë.
- ✓ **Konstatohet:** Motori tip Suzuki Burgman, është blerë në vitin. 2013, me fature tatimore blerje me burim të ardhurat nga paga e subjektit. Mjeti është shitur në vitin 2015.
- ✓ **Konfirmohet** deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.

### **Pasuria nr. 14**

- ✚ Llogari rrjedhese Raiffeisen Bank, nr. llogarie \*\*\*\*\*. Gjendje në datën 07.03.2023 shuma 158.64 USD.

#### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Vërtetim mbi produktet bankare të klientit Samir Boshnjaku, nga Raiffeisen Bank datë 06.03.2023. Konfirmohet gjendja e llogarisë në janar 2023, në shumën 158 USD.
- Njerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, në monedhën USD, për periudhën 31.01.2023-09.02.2023.
- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\*\* prot, datë 08.05.2023, konfirmon llogari rrjedhese në monedhën USD, në emër të Samir Boshnjaku, me balancë në datë 06.03.2023, shumën 158 usd.
- ✓ **Konstatohet:** Llogaria është krijuar në vitin 2023.
- ✓ **Konfirmohet** deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank.

### **Pasuria nr.15**

- Detyrimi nga Master Card Raiffeisen Bank nr. llogarie \*\*\*\*\*. Gjendje në datë 07.03.2023 shuma 1.988 euro.

#### **Bashkelidhur deklarates:**

- Fatura e kartës së Kreditit nga Raiffeisen Bank, datë 09.02.2023. Konfirmohet limiti i kartës 2.000 euro. Balanca e llogarisë në datë 30.6.2020, në shumën -7.69 euro.
- Lëvizje llogarie për periudhën 01.01.2018 - 31.12.2022.



- ✓ Konfirmohet balanca e llogarisë në datë 30.12.2022, në shumën 12.5 euro. Raiffeisen Bank, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 08.05.2023, konfirmon llogari për tërheqje Master Card, në emër të Saimir Boshnjaku, me balancë në datë 06.03.2023 shumën -11 euro. Limiti i kartës 2.000 euro.
- ✓ **Konstatohet:** Llogaria është krijuar gjatë periudhës 2011-2023.
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank.

### **Pasuri nr. 16**

✚ Gjendje në llogari Raiffeisen Bank datë 07.03.2023, shuma 697.612 lekë. Të ardhura nga paga, dieta.

#### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, datë 09.02.2023, në monedhën lekë, për periudhën 01.01.2018 - 31.12.2022. Gjendja e llogarisë në datë 31.12.2022, në shumën 394.714 lekë.
- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, datë 09.01.2023, në monedhën lekë, për periudhën 13.12.2022 - 31.12.2022.
- Gjendja e llogarisë në datë 31.12.2022, në shumën 394.714 lekë. Limit overdrafti në shumën 245.000 lekë. Balance e disponueshme 697.346 lekë

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\*\* prot, datë 08.05.2023, konfirmon llogari pagë, në emër të Saimir Boshnjaku, me balancë në datë 06.03.2023, shumën 490.262 lekë.

- **Me inventarin nr. extra prot., datë 03.07.2023**, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

- Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se: Nga riverifikimi i lëvizjeve dhe gjendjes së llogarisë rrjedhëse në Bankën Raiffeisen ka konstatuar se gjendja e llogarisë në datën 06.03.2023 ka qenë në vlerën 490.262 lekë. Ka kërkuar korrigjim të vlerës se deklaruar nga ana e tij pasi është rezultat i një gabimi njerëzor në transferimin e shifrave.

#### **Ka dorëzuar:**

- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank në emër të Saimir Boshnjaku, për periudhën 01.03.2005-27.04.2023. Gjendja e llogarisë në datë 06.03.2023, në shumën 490.262 lekë.
- ✓ **Konstatohet:** Llogaria është krijuar gjatë periudhës 2005 - 2023. Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank.

### **Pasuri nr. 17**

✚ Të ardhura nga qiradhënie ambjent “Myslym Shyri” dhe shitje automjeti viti 2022.

#### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, datë 09.02.2023, në monedhën euro, për periudhën 07.10.2022 - 09.02.2023. Gjendja e llogarisë në datë 09.02.2023, në shumën 3.942,98 euro.
- Faturë depozitimi në llogari në Raiffeisen Bank, datë 06.03.2023, në emër të Saimir Boshnjaku, të shumës 13.000 euro, me përshkrimin “Derdhje sipas kontratës së shitjes së pasurisë së luajtshme nr. \*\* Rep., nr. \*\* Kol dhe Kontrate qiraje nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\*\* Kol.”



- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot datë 08.05.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në monedhën Euro, në emër të Saimir Boshnjaku, me balancë në datë 06.03.2023, shumën 16.942 Euro.

### **Konfirmohet:**

- kreditimi i shumës 3.300 euro, në datë 24.10.2022, nga B. M me përshkrimin “Kalim qiraje sipas kontratës nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., për periudhën 15 shtator -15 dhjetor 2022”,
- i shumës 642,8 euro nga Orgforecur and co-oper in Europë,
- si dhe derdhja e shumës 13.000 euro, në datë 06.03.2023, nga Saimir Boshnjaku, me përshkrimin “Derdhje sipas Kontratës së shitjes se pasurise se luajtshme nr. \*\*\* dhe Kontratës së qirasë”

- ✓ **Konstatohet:** Llogaria është krijuar gjatë periudhës 2022-2023.
- ✓ **Konfirmohet** deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank.

### **Pasuria nr.18**

- ✚ Gjendje cash jashtë sistemit bankar 8.000 euro. Kursime nga qiradhënia dhe pagat e mia.
- ✚ **Me inventarin nr.extra prot., datë 03.07.2023**, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI. Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se:

- Në deklarimin periodik të vitit 2021 ka raportuar gjendje cash në datë 31.12.2021, në shumën 9.000 Euro. Gjatë vitit 2022 ka kryer veprime në cash si më poshtë:

<b>Datë</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera (Euro)</b>
Janar-Shtator 2022	Të ardhura nga qeraja	9,900
20.01.2022	Shitje automjeti	4,000
<b>Total hyrjesh gjatë 2022</b>		<b>13,900</b>
Janar-Dhjetor 2022	Pagesë këste kredie (265euro/muaj)	-3,180
2022	Pagesë për Universitetin NY Tiranë (djali)	-1,458
2022	Shpenzime të tjera	-262
<b>Total daljesh cash</b>		<b>-4,900</b>
<b>Net lëvizje cash gjatë 2022</b>		<b>9,000</b>

- Pra në 31.12.2022, gjendja e cash-it, duke llogaritur edhe gjendjen e deklaruar në datë 31.12.2021, është 18,000 Euro (9,000 euro gjendja e datë 01.01.2022 dhe 9,000 euro të krijuara gjatë vitit 2022). Nga kjo gjendje, nga shuma 18,000 euro është derdhur në Raiffeisen Bank, në llogarine e tij personale, shuma prej 13,000 Euro në datë 06.03.2023 (që e ul gjendjen në 5,000 euro). Ndërkohë në periudhën janar - mars 2023 ka vazhduar arkëtimi i qirave në cash, në shumën 3,300 euro, duke e çuar gjendjen në 8,300 euro. Nga kjo shumë janë shpenzuar 300 euro dhe shuma e mbetur prej 8,000 euro është deklaruar në deklaratën e depozituar pranë jush. Siç shihet nga veprimet e mesipërme, deklarimi i gjendjes cash, për llogari të deklaratës periodike vjetore të vitit 2022, pranë ILDKPI është bërë duke konsideruar vetem cash-in sipas tabelës me sipër, pa konsideruar gjendjen në 31.12.2021, me mendimin që kjo shumë është deklaruar nga ana ime më parë në deklaratën e vitit 2021.

- **Konstatohet:** Gjendia cash është krijuar gjatë periudhës 2021 - 2023. Të ardhurat e realizuara justifikojnë gjendjen cash të deklaruar.

### A/3 DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Të ardhura nga puna ime në Gardën e Republikës, nga 09.1992 deri në 12.1993, sipas vërtetimit të lëshuar nga institucioni. **Shuma** 55.768 lekë.
- Të ardhura nga puna ime në Gardën e Republikës, nga viti 1994 deri në 01.09.2000, sipas vërtetimit të lëshuar nga institucioni, **Shuma** 996.657 lekë.
- Të ardhura nga taksa e solidaritetit 1997-2000, të llogaritura me përafërsi sipas dokumentave të disponohen, 440.000 lekë.
- Të ardhura nga puna ime në Policinë e Shtetit, nga data 01.09.2000 - 19.03.2002. Sipas Vërtetimit të lëshuar nga institucioni datë.16.04.2008, **shuma** 511.453 lekë.
- Të ardhura nga puna ime në Policinë e Shtetit SPQ Tirane, nga 20.03.2002 deri në 22.04.2004. Sipas vërtetimit të lëshuar nga institucioni datë16.04.2018, shuma 772.500 lekë.
- Të ardhura nga puna ime në Policinë e Shtetit DPQ Durrës, nga 23.4.2004 deri në 15.11.2004, **shuma** 535.964 lekë.
- Të ardhura nga puna ime në Policinë e Shtetit DPQ Fier, nga 16.11.2004, deri në 01.03.2005. Sipas vërtetimit të lëshuar nga institucioni, 198.306 lekë.
- Të ardhura nga puna ime në Policinë e Shtetit DPQ Fier, D.P. Policisë, DVKM Tiranë, QMH Karrec, DVKM Durrës, DVKM Tiranë, DP Policisë, DPQ Gjirokastër, DVKM Tiranë, D.P Policisë nga 01.03.2005 deri në 26.03.2018. Sipas printimit të Raiffeisen Bank për datë 03.06.2013, si dhe për datë 04.04.2018 dhe 25.04.2018. **Shuma** 18.158.142 lekë.
- Të ardhura nga qirate e ambjentit në bashkëpronësi me prindërit dhe vëllezërit me adresë, Rruga “Myslym Shyri”. Këto të ardhura janë të administruara dhe përdorur për arsye se familjarët e mi jetojnë jashtë shtetit, për atë janë përdorur si për qëllimet e mia dhe për interesa familjare, sipas certifikatës së kohës. **Shuma 82.600 \$ + 2.480.000 lekë + 64.805 Euro.**
- Të ardhura nga shitja e makinës tip Land Rover, kontratë Rep. \*\*\*\*., Kol. \*\*\*, datë 18.03.2017, shuma 1.250.000 lekë.
- Të ardhura nga shitja e makinës tip Volksäagen Golf Plus, me Kontratë Rep.\*\*\*\*, Kol. \*\*\*\*, datë 28.10.2014. **Shuma** 900.000 lekë.
- Të ardhura nga shitja e makinës tip Ford Focus, kontratë nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 22.03.2012, **shuma** 5.000 Euro.
- Të ardhura nga shitja e makinës tip Opel Omega, **shuma** 100.000 lekë. (shitur 100.000 lekë, nuk disponohet kontrata e shitjes).
- Të ardhura nga shitja e motorit tip Suzuki Burgman, **shuma** 30.000 lekë. (Shitur me kontrate nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\*\*\* Kol., datë 03.10.2015).
- Të ardhura nga rimbursimi i shpenzimeve dhe dietave për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme të organizuara nga Frontex, si brenda dhe jashtë vendit nga viti 2015 deri në 31.12.2022. Sipas vërtetimit të institucionit, datë 06.03.2023, **shuma** 30.959 Euro.
- Të ardhura dhuruar nga vëllai im Tasi Boshnjaku, në vitin 2008, **shuma** 15.000 euro.
- Të ardhura nga fitimi vjetor i aktivitetit bar kafe, për pjesën takuese ¼, nga bashkëpronësia në ambjentin Rruga “Myslym Shyri”, **shuma** 200.000 lekë.
- Të ardhura nga shitje apartament banimi, me sip. 72 m<sup>2</sup>, me adresë “Ish Fusha e Aviacionit Civil” nr. hipoteke \*\*\*, datë 27.08.2001, **shuma** 1.900.000 lekë.
- Të ardhura nga shitje garazh makinë, me sip.16 m<sup>2</sup>, me adresë “Ish Fusha e Aviacionit Civil” garazhi nr. \*\*, nr. \*\*\* kontrate Rep., nr. \*\*\*\* Kol., datë 08.07.2002, **shuma** 100.000 lekë.

#### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, lëshuar nga Garda e Republikës. **Konfirmohen** të ardhurat për Samir Boshnjaku, për periudhen shtator - dhjetor 1992, në shumën neto 11.848 lekë.

- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, nga ISSH. **Konfirmohen** të ardhurat për Samir Boshnjaku, për periudhën 01.01.1994 - 31.08.2000, në shumën neto 976.657 lekë.
- Vërtetim nr. extra prot, datë 16.04.2018, nga DPPSH. Konfirmohen të ardhurat nga paga për Samir Boshnjaku, për periudhën 01.09.2000 - 19.03.2002, në shumën totale 511.453 lekë.
- Vërtetim nr. \*\*\* prot, datë 16.04.2018, nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë. Konfirmohen të ardhurat nga paga për Samir Boshnjaku, për periudhën 20.03.2002 - 22.04.2004, në shumën neto 772.500 lekë.
- Vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës. Konfirmohen të ardhurat nga paga për Samir Boshnjaku për periudhën 23.04.2004 - 15.11.2004, në shumën neto 535.964 lekë.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier. Konfirmohen të ardhurat nga paga për Saimir Boshnjaku për periudhën 01.11.2004 - 31.3.2006, në shumën neto 757.278 lekë (për periudhën 01.11.2004 - 31.12.2005, në shumën 623.535 leke) Vërtetim nr. \*\*\* prot, datë 01.03.2023, nga Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë. Konfirmohen të ardhurat nga paga për Saimir Boshnjaku + orë suplementare për periudhën 2008-2014 dhe 2021-2022, në shumën totale 4.531.396 lekë.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, lëshuar nga Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin Durrës. Konfirmohen të ardhurat nga paga për Saimir Boshnjaku, për periudhën korrik 2010-dhjetor 2011, në shumën neto 1.335.362 lekë.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, nga ISSH. Konfirmohen të ardhurat nga paga për Saimir Boshnjaku, për periudhën qershor-korrik 2010, në shumën 12.738 lekë. Për periudhën nëntor-dhjetor 2014, në shumën 103.126 lekë. Për periudhën janar 2015-tetor 2021 dhe korrik 2022-janar 2023, në shumën totale neto 7.405.597 lekë.
- Vërtetim nr. \*\*\*\* prot, datë 06.03.2023, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin. Konfirmohen të ardhurat e përfituara nga rimbursim shpenzimesh dhe dieta, nga misioni Frontex, për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme të organizuara nga kjo agjenci, për periudhën 01.01.2015 - 29.02.2023, në shumën totale 30.959 euro. Bashkelidhur dokumentacioni shoqërues. (*Urdhërat për dërgimin jashtë shetit, tabela e përlllogaritjeve, si dhe mandat pagesat përkatëse*).
- Tabelë përmbledhëse për pagesat e përfituara nga trajnimet dhe pjesëmarrja në takime të ndryshme për periudhën 2007 - 2018. Shuma e përfituar rreth 126 euro + 528 usd +179.981 lekë.
- **Korrespondence e-mail, i datë 19.04.2018**, me UNHCR. Konfirmohen të ardhurat e përfituara nga Saimir Boshnjaku, për periudhën 2011 e në vazhdim, në shumën 29.760 lekë + 1.056 USD.
- Nxjerrje llogarie në monedhën lekë, nga Raiffeisen Bank datë 04.04.2018, për periudhën 01.03.2005 - 05.04.2018.
- Nxjerrje llogarie në monedhën lekë, nga Raiffeisen Bank datë 09.02.2023, për periudhën 01.01.2018 - 31.12.2022.
- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, në monedhën lekë për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.
- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, datë 09.02.2023, në monedhën euro, për periudhën 07.10.2022-09.02.2023. Konfirmohen të ardhurat nga qiraja, sipas kontratës nr. \*\*\*\* Rep, nr. \*\*\* Kol., për periudhën shtator - dhjetor 2022, në shumën 3.300 euro.
- Të ardhurat nga Org for Secur and Co-Oper in Europe, në datë 21.11.2022, në shumën 642 euro.
- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, datë 26.03.2018, në monedhën euro, për periudhën 26.05.2011 - 26.03.2018, në emër të Saimir Boshnjaku. Kontratë qiraje datë 12.04.1994. Apartament në Rrugë "Myslym Shyri", për një afat 3 mujor (15.04.1994 - 15.07.1994), në shumën 10.000 lekë, në muaj me të drejtë përsëritje. Qiradhënes Saimir Boshnjaku dhe qiramarrës B. Nuhaj. (Rezulton shuma 30.000 lekë)
- Kontratë qiraje datë 22.07.1994. Apartament në Rrugë "Myslym Shyri", për një afat 4 mujor, në shumën 10.000 lekë në muaj, me të drejtë përsëritje. Tatimi për këtë kontratë qiraje merret përsipër nga qiramarrësi. Qiradhënes Saimir Boshnjaku dhe qiramarrës B. Nuhaj. (Rezulton shuma 40.000 lekë)
- Kontratë qiraje (pa datë), midis Saimir Boshnjaku dhe V. L, S. P dhe T. M, për apartamentin e ndodhur në Rrugë "Myslym Shyri", duke filluar nga data 01.01.1997, në shumën 400 usd, në muaj.

*(Sipas deklaramit të subjektit seksioni i të dhënave konfidenciale, të ardhurat janë në shumën 3.600 usd, për periudhën 01.01.1997-01.10.1997)*

- Kontratë qiraje datë 25.09.1997, për apartament me sip. 50 m<sup>2</sup>, me afat 3 vjeçar (01.10.1997-31.09.2000) në shumën 700 usd në muaj. Qiradhëmës V. Filaj qiramarrës S. M. *(Sipas deklaramit të subjektit të seksioni i të dhënave konfidenciale, të ardhurat janë në shumën 6.300 usd. për periudhën 01.10.1997 - 01.08.1998)*
- Memorandum datë 27.04.2018, nga NDI (National Democratic Institute) drejtuar Saimir Boshnjaku, ku konfirmohet se është marrë me qira ambjent në Rrugën “Myslym Shyri”, Tiranë për periudhën 10.08.1998 - 23.11.1999, në shumën 800 USD në muaj dhe për periudhën 24.01.1999 - 30.04.2002, në shumën 1.100 USD, në muaj. *(Sipas deklaramit të subjektit të seksioni i të dhënave konfidenciale, të ardhurat janë në shumën 43.900 usd për periudhën 10.8.1998-23.11.1999, (800 usd në muaj) dhe për periudhën 24.11.1999-30.4.2002. (100 usd në muaj)*
- Kontratë qiraje nr. \*\*\* Rep., datë 13.07.2002, për apartament në Rruga “Myslym Shyri”, Tiranë. Afati 6 muaj (13.07.2002 - 13.01.2003), në shumën 700 USD në muaj. Qiradhënës Saimir Boshnjaku dhe qiramarrës shoqëria “Eurobest” sh.a. *(Sipas deklaramit të subjektit të seksioni i të dhënave konfidenciale, të ardhurat janë në shumën 4.200 usd për periudhën 13.07.2002-13.01.2003)*
- Vërtetim nr. \*\* prot, datë 24.04.2018, nga F.M.A.A, ku konfirmohet marrja me qira e apartamentit në pronësi të Saimir Boshnjaku në Rruga “Myslym Shyri”, për periudhën 15.04.2003 - 13.04.2004, me pagese mujore 700 USD dhe për periudhën 14.04.2004-13.04.2005, me pagesë mujore 500 USD. *(Sipas deklaramit të subjektit të seksioni i të dhënave konfidenciale, të ardhurat janë në shumën 14.400 usd për periudhën 15.04.2003-13.04.2005)*
- Kontratë qiraje nr. \*\*\* Rep, datë 13.01.2006, për apartament të ndodhur në Rruga “Myslym Shyri”, me sip. 40 m<sup>2</sup> me afat 3 vjet (01.02.2006 - 01.02.2009) në shumën 600 USD në muaj. Qiradhënës Saimir Boshnjaku dhe qiramarrës B. V. *(Sipas deklaramit të subjektit të seksioni i të dhënave konfidenciale, të ardhurat janë në shumën 10.200 USD, për periudhën 01.02.2006-12.07.2007)*
- Kontratë qiraje nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 14.05.2008, për apartament në Rrugën “Myslym Shyri” me sip. 130 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*\* dhe nr. \*\*\* ZK. \*\*\*\*, për periudhën 01.02.2008 - 01.02.2010, në shumën 40.000 lekë/muaj. Qiradhënës T. Boshnjaku dhe qiramarrës F. K
- Qiramarrësi merr përsipër të paguaje detyrimet e tatimit në burim që është në masën 10% të qirasë. *(Sipas deklaramit të subjektit të seksioni i të dhënave konfidenciale, të ardhurat janë në shumën 420.000 lekë, për periudhën 01.02.2008 - 01.05.2009)*
- Kontratë qiraje, datë 28.03.2009, për apartament në Rrugën “Myslym Shyri” me sip. 130 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*\*\* dhe nr. \*\*\*, ZK. \*\*\*\*, për periudhën 01.05.2009 - 31.05.2010, në shumën 30.000 lekë/muaj. Qiradhënës Saimir Boshnjaku dhe T. Boshnjaku dhe qiramarrës shoqëria “D.N.H” shpk. Qiradhënësi ka për detyrë të paguaje detyrimet e tatimit në burim, që është në masën 10% të vlerës së qirasë. *(Sipas deklaramit të subjektit të seksioni i të dhënave konfidenciale, të ardhurat janë në shumën 390.000 lekë, për periudhën 01.05.2009-31.05.2010)*
- Kontrate qiraje, datë 01.01.2012, për apartament në Rrugën “Myslym Shyri” me sip. 130 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*\*\* dhe nr. \*\*\*, ZK. \*\*\*\*, për periudhën 01.01.2012- 31.12.2012, në shumën 30.000 lekë/muaj. Qiradhënës Saimir Boshnjaku dhe T. Boshnjaku dhe qiramarrës shoqëria “D.N.H” shpk. Qiradhësi ka për detyrë të paguaje detyrimet e tatimit në burim, që është në masën 10% të vlerës së qirasë. *(Sipas deklaramit të subjektit të seksioni i të dhënave konfidenciale, të ardhurat janë në shumën 570.000 lekë për periudhën 01.06.2010 - 31.12.2011 (kontrate që nuk disponohet me DNH) + 360.000 lekë për periudhën 01.01.2012 - 31.12.2012)*
- Kontratë qiraje datë 10. 01.2013, për apartament në Rrugën “Myslym Shyri” me sip. 130 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*\*\* dhe nr. \*\*\*, ZK. \*\*\*, për një periudhe 2 vjeçare (10.01.2013-10.01.2015) në shumën 30.000 lekë/muaj. Qiradhënës Saimir Boshnjaku dhe qiramarrës personi fizik V. K. Qiradhënësi ka për detyrë të paguajë detyrimet e tatimit në burim, që është në masën 10% të vlerës

së qirasë. (Sipas deklaramit të subjektit të seksioni i të dhënave konfidenciale, të ardhurat janë në shumën 470.000 lekë, për periudhën 10.01.2013- 01.05.2014)

- Kontrate qiraje, datë 19.09.2014, për apartamentet me sip. 18.3m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*\*\*, me sip.65.7 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*\*\* dhe me sip. 40 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*\*\* sipërfaqe të cilat janë bashkuar në një të vetme, e tjetërsuar në ambiente biznesi, pasuri e ndodhur në rrugën “Myslym Shyri”, Tiranë, për një afat 3 vjeçar (01.11.2014 - 01.11.2017). Qiramarrësi do të paguajë 18 muaj parapagim në shumën prej 18.000 Euro, në datën e lidhjes së kësaj kontrate, për periudhën nëntor 2014 - 01.06.2016 dhe pagesa tjetër e mbetur prej 18 muajsh do paguhet në menyre të menjehershme çdo 6 muaj parapagim. Qiradhënës Saimir Boshnjaku dhe qiramarrës F. C. Qiramarrësi do të paguajë qiranë mujore në të cilën është e përfshirë edhe tatimi mbi qiranë. (Sipas deklaramit të subjektit të seksioni i të dhënave konfidenciale, të ardhurat janë në shumën 18.000 euro për periudhën 01.11.2014 - 31.12.2016, pasi u prish kontrata dhe pjesa tjetër nuk u pagua).
- Akt-Marrëveshje nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 22.10.2016, në zbatim të Kontratës së qirasë me nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 19.09.2014, midis Saimir Boshnjaku dhe F. C, për shumën e mbetur pa likuiduar prej 18.000 euro, shumë e cila do likujdohet në 3 këste dhe konkretisht:

- a. kësti i pare 7.000 euro, në datë 31.12.2016:
- b. kesti i dytë 6.000 euro, në datë. 31.07.2017 dhe
- c. kesti i tretë 5.000 euro, në datë. 30.11.2017

#### **Bashkëlidhur:**

- Deklaratë Noteriale nr. \*\*\*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 22.10.2016, nga F.C, ku konfirmohet dakortësia për shlyerjen e shumës 7.000 euro deri në datë 31.12.2016.
- Vëndim për Lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit nr. \*\*\* Regjistri, datë 19.01.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për Ekzekutimin e deklaratës noteriale nr. \*\*\*\*\* Rep, nr. \*\*\* Kol, datë 22.10.2016.
- Formular i deklaramit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për personin fizik T. Boshnjaku me NIPT \*\*\*\*\*, për vitin 2017. Fitimi i realizuar 941.640 lekë.
- Formular i deklaramit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për personin fizik T. Boshnjaku me NIPT \*\*\*\*\*, për vitin 2018. Fitimi i realizuar 795.049 lekë.
- Kontrate qiraje nr. \*\*\* Rep, nr. \*\*\*\*\* Kol, datë 09.05.2019, për apartamentet me sip. 18.3 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*\*\*, me sip. 65.7 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*\*\* dhe me sip. 40 m<sup>2</sup> me nr. pas \*\*\*\*\*, pasuri e ndodhur në rrugën “Myslym Shyri” për një afat 10 vjeçar (15.06.2019 - 14.06.2029) në shumën 1.100 euro/muaj. Qiradhënës Saimir Boshnjaku, T. Boshnjaku dhe qiramarrës personi fizik Th.M qiramarrësi do të paguajë detyrimet e tatimit në burim, në masën 15% jashtë vlerës së qirasë.

**Bashkëlidhur:** Certifikatë për vërtetim pronësie, për pasurinë apartament me sip. 18.3 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*\*\*, në emër të Saimir Boshnjaku, lëshuar në datë 09.04.2012. Për pasurinë apartament me sip. 65.7 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*\*\*, në emër të V. Filaj, M. Fila, Saimir Boshnjaku, T. Boshnjaku, lëshuar në datë 02.08.2007. Për pasurinë apartament me sip. 40 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*\*\*, në emër të Saimir Boshnjaku, lëshuar në datë 28.07.2017. (Sipas deklaramit të subjektit të seksioni i të dhënave konfidenciale, të ardhurat janë në shumën 48.400 euro, për periudhën 15.06.2019 - mars 2023)

- Revokim kontrate qiraje, nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 18.07.2019, për kontratën e qirasë nr. \*\*\*\*\* Rep, nr. \*\*\* Kol, datë 09.05.2019.
- Kontratë qiraje nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\*\*\* Kol., datë 18.07.2019, për apartamentet me sip. 18.3 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*\*\*, me sip. 65.7 m<sup>2</sup> me nr. pasurie \*\*\*\*\* dhe me sip. 40 m<sup>2</sup> me nr. \*\*\*\*\* pasuri e ndodhur në rrugën “Myslym Shyri”, për një afat 10 vjeçar (15.06.2019 - 14.06.2029), në shumën 1.100 euro/muaj, qiradhënës Saimir Boshnjaku, T. Boshnjaku dhe qiramarrës personi

fizik B. M, qiramarrësi do të paguajë detyrimet e tatimit në burim, në masën 15% jashtë vlerës së qirasë.

- Vërtetim datë 22.02.2023, nga B. M, person Fizik, me NIPT \*\*\*\*\*, ku konfirmohet se Saimir Boshnjaku dhe T. Boshnjaku, në bazë të kontratës së qirasë nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 18.07.2019, kanë përfituar të ardhura nga qiraja në masën 1.100 euro/muaj. Për këto pagesa qiraje është bërë deklarimi dhe pagesa e tatimit në burim nga subjekti B. M, person fizik, për periudhën 15.09.2022-15.03.2023.
- Vërtetim nr. \*\*\*\*\*, datë 19.9.2022, nga DRT Tiranë, ku vërtetohet se tatimpaguesi B. M, me NIPT \*\*\*\*\* me adresë; Rruga “Myslym Shyri”, Tiranë, rezulton se nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri në datë 19.09.2022.

+ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 08.05.2023, konfirmon të ardhurat nga paga, shpërblimet, dieta, për Saimir Boshnjaku, për periudhën prill 2005 - shkurt 2023, në shumën rreth 17.879.815 lekë (për periudhën 2006 - shkurt 2023, në shumën 17.442. 121 lekë). Të ardhura nga pjesëmarrja në seminare të ndryshme për vitet 2014 - 2022, rreth 2.121 euro + 159 USD. Dërguar nga I. S, në datë 21.05.2015 shuma 994 euro. Të ardhura nga qiradhënia, sipas kontratës nr. \*\*\*\*, në shumën 3.300 euro.

+ **Instituti i Sigurimeve Shoqërore**, me shkresën nr. \*\*\*\* prot., datë 10.05.2023, konfirmon se për subjektin Saimir Boshnjaku, janë derdhur kontributet për periudhën janar 2012 - mars 2023.

+ **ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror**, me shkresën nr. \*\*\*\*, datë 16.05.2023, konfirmon se nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave për periudhën 1994 - 2012, të punonjësve të siguruar në subjektet juridike apo fizike, nuk mund të konfirmojë periudhën e kontributeve apo paga mbi të cilën janë siguruar, në qoftë se se nuk jepen emërtimi i qendrës së punës, nipti i subjektit, fotokopje e librezës së punës për Saimir Boshnjaku.

+ **DRT Tiranë**, me shkresën nr. \*\*\*\* prot, datë 19.05.2023, konfirmon se për kontratat e qirasë së datave 12.04.1994 me qiradhënes Saimir Boshnjaku dhe qiramarrës B. N e vitit 1994 (pa datë) me qiradhënës Saimir Boshnjaku dhe qiramarrës B. N e datës 01.01.1997 me qiradhënes Saimir Boshnjaku dhe qiramarrës V. L, S. P, T. M.

- Kontratë qiraje me qiradhënes Saimir Boshnjaku dhe qiramarrës Instituti Demokratik Kombëtar për Punët e Jashtme (DI) deri në dhjetor 2000;
- Kontratë qiraje e datë 13.07.2002 me qiramarrës Xh. L; datë 13.01.2006, me qiramarrës B. V, për periudhën 01.02.2006 - 01.02.2009; datë 14.05.2008, me qiramarrës F. K, për periudhën 01.02.2008 - 01.02.2010 dhe për kontratën e datës 28.03.2009, me qiramarrës subjektin DNH, për periudhën 01.05.2009 - 31.05.2010, nuk u gjend ndonjë pagese e kryer nga qiradhënesi Saimir Boshnjaku dhe nga qiramarrësit e lartpërmendur.
- Për kontratën e datë 01.01.2012, me qiradhënës Saimir Boshnjaku dhe qiramarrës subjektin DNH, për periudhën 01.01.2012 - 31.12.2012 janë gjendur pagesat e kryera nga subjekti DNH për periudhën janar 2009 - shkurt 2014, por nuk mund të identifikohet se për cilën kontratë qiraje janë kryer pagesat.
- Për kontratën e datës 10.01.2013, me qiradhënës Saimir Boshnjaku dhe qiramarrës V. K, me NIPT \*\*\*\*\*, deri në datë 10.01.2015, janë gjendur pagesat e kryera nga V. K me NIPT \*\*\*\*\*, për periudhën 01.04.2013 - 15.01.2014, por nuk mund të identifikohet se për kë kontratë qiraje janë kryer pagesat.
- Për kontratën e datës 19.09.2014, me qiradhënes Saimir Boshnjaku dhe qiramarrës F. C, për periudhën 01.11.2014 - 01.11.2017, janë identifikuar pagesa nga F. C për periudhën mars 2015-korrik 2015.

- Për kontratën e datës 09.05.2019, me qiradhënës Saimir Boshnjaku dhe T. Boshnjaku dhe qiramarrës Th. M me NIPT \*\*\*\*\*, për periudhën 15.06.2019-14.06.2029 janë kryer pagesat për periudhën shtator 2015 – tetor 2017 dhe tetor 2022 – mars 2023.
- Për kontratën e datës 18.07.2019, me qiradhënës Saimir Boshnjaku dhe qiramarrës B. Mili me NIPT \*\*\*\*\*, për periudhën 15.06.2019 - 14.06.2029 janë kryer pagesat për periudhën korrik 2019 - mars 2023.

**Me inventarin nr. extra prot., datë 03.07.2023**, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI, sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se;

- në bashkëpronësi me prindërit dhe vëllezërit, e tij, ai ka vetëm apartamentin e vjetër, me sip. 67.5 m<sup>2</sup>. Pra, pjesa e tij takuese është rreth 17 m<sup>2</sup>. Nga ana tjetër, me dakordësinë e familjarëve, ka përballuar financiarisht dy shtesat anësore që ka bërë pallati, përkatësisht 40 m<sup>2</sup> dhe 18 m<sup>2</sup>, të cilat janë hipotekuar në emrin e tij. Pra, pjesa takuese është 17 + 40 + 18 = 75 m<sup>2</sup>, ose 60%. Me dakortësinë e të gjithë familjarëve të tij, ai ka përdorur të gjitha të ardhurat nga qiratë e kësaj pronë, për blerje dhe investime të të gjitha llojeve të aseteve materiale apo financiare, që lidhen kryesisht me këtë pronë. Ky fakt vërtetohet nga certifikata familjare e datës 06.07.2017, e cila përbëhet nga 8 anëtarë, si dhe deklarata noteriale (deklaratë përgjegjësie) nr. \*\*\*\*, datë 30.06.2023, e familjarëve të tij ku shprehin dakortësinë e përfitimit në favorin e subjektit dhe përdorimit të të ardhurave nga qiratë e kësaj prone (pasqyruar tek aseti apartament në rrugën “Myslym Shyri”.
- Në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat nga qiraja, ka sqaruar se në dijeninë e tij janë mbajtur nga qiramarrësit, sipas kontratave të kohës, në përputhje me ligjin nr. \*\*, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, i cili sanksionon në nenin 33 “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat” “Të gjithë personat rezidente në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jofitimprurese dhe çdo subjekt tjetër, i njohur nga legislacioni në fuqi, janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim nga shuma bruto e pagesave të mëposhtme, që lindin nga një burim në Republikën e Shqipërisë dhe pagesat për qiratë dhe në vijim udhëzimi nr. 5, datë 30 janar 2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, paragrafi 5.1. Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat.
- “Në zbatim të nenit 33 të ligjit, të gjithë personat, përfshirë personat juridike, ortakëritë, personat fizike tregtarë rezidente tatimore në Shqipëri, organet e qeverisjes qendrore apo vendore, organizatat jofitimprurëse, dhe çdo ent apo person juridik i krijuar si i tillë në Shqipëri, që bën

pagese të çdo njëres nga llojet e pagesave që listohen në nenin 33, është i detyruar të mbajë tatim në burim dhe ta derdhe atë në organin tatimor përkatës, jo më vonë se data 20 e muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa”

- Sa më sipër, është e qartë se detyrimi dhe përgjegjësia për të deklaruar dhe paguar tatimin në burim për të ardhurat nga qiratë është e qiramarrësve, duke qenë se prona në fjalë është përdorur vetëm për qëllime biznesi nga qiramarrësit, të cilët kanë qenë dhe janë entitete (persona juridik dhe fizike) të regjistruar në QKB dhe organet tatimore.
- Për të ardhurat e deklaruara nga qiradhënësia e “ambjentit në bashkëpronësi me prindërit dhe vëllezërit me adresë: rruga “Myslym Shyri”, kontratë datë 19.09.2014 (01.11.2014 - 31.12.2016), shuma 18.000 Euro, kontratë datë 19.09.2014, nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\*\* Kol”, ka sqaruar se nga kjo kontratë qiraje ka përfituar vetëm 18,000 Euro në datën e lidhjes së kontratës. Për pjesën tjetër qiramarrësi la të gjitha pajisjet në ambient sipas Akt Marrëveshjes së depozituar nga ai me dosjen fillestare. Pajisjet e dorëzuara nga qiramarrësi për mospagimin e qirasë, sipas kontratës së qirasë janë përdorur nga biznesi i vëllait të tij, gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit bar - kafe.
- Në lidhje me të ardhurat e deklaruara si “rimbursim i shpenzimeve dhe dietave për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme të organizuara nga Frontex, si brenda dhe jashtë vendit, nga viti 2015 deri në 31.12.2022, në shumën 30.959 Euro”, ka sqaruar se të gjitha këto të ardhura i ka arkëtuar me mandate pagesa nga arka e Departamentit të Kufirit dhe Migracionit në DPPSH. Këtë fakt e



vërteton me kopje të një pjesë të tyre, por sqaron se në të njëjtën metode e ka arkëtuar të gjithë vlerën e deklaruar.

- Për të ardhurat “*dhuruar nga vëllai T. Boshnjaku, në vitin 2008, në shumën 15.000 euro*” ka paraqitur dokumentacion për të ardhurat e tij (vëllait), për periudhën 2003 - 2008, të cilat në total rezultojnë rreth 47.000 euro (Pasqyruar me sipër), Vërtetim i datës 27.06.2023, lëshuar nga Garda e Republikës, ku konfirmohen të ardhurat e përfituara nga shpërblimi i solidaritetit, për periudhën 01.01.1999-31.07.2000, në shumën totale 259.500 lekë. Shpërblim i cili nuk është përfshirë në pagën mujore. Për periudhën 16.03.1997 - 31.12.1997, në shumën 74.704 lekë, Për periudhën 01.09.1992-31.12.1993, të ardhurat e përfituara janë në shumën neto 55.768 lekë.
- Listë sqaruese në lidhje me shumat e tërhequra nga Departamenti i Kufirit dhe Migraconit, si dieta të rimbursuara nga Frontex, për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2022, në shumën totale rreth 13.578 Euro.

### **Bashkëlidhur:**

- Urdhër nr. \*\*\*, datë 25.07.2019, për shërbim jashtë shtetit, për periudhën 08.10.2019-11.10.2019 + Mandat pagesë e datë 30.12.2019, në shumën e përfitur 942 Euro.
- Urdhër nr. \*\*\*, datë 15.05.2019, për shërbim jashtë shtetit, për periudhën 20.05.2019 - 30.06.2019 + Mandat pagesë e nr. \*\*\*, në shumën 81 euro + mandat pagese nr. \*\*, datë 20.06.2019, në shumën 6.085 Euro.
- Urdhër nr. \*\*\*, datë 22.02.2019, për shërbim jashtë shtetit, për periudhën 25.02.2019-28.02.2019 + Mandat pagesë, nr. \*\*\*, datë 13.05.2019, në shumën 850 Euro.
- Urdhër nr. \*\*\*, datë 11.08.2020, për caktimin e oficerit të Informacionit të Operacionit FO Ëestern Balkan 2020, Agjencisë Europiane të Rojes Kufitare dhe Bregdetare, Frontex, për periudhën 12.08.2020 - 09.09.2020 + Mandat pagese nr. \*\*\*, datë 11.06.2020, në shumën 2.100 Euro + nr. \*\*\*, datë 23.12.2020, në shumën 902 euro.
- Urdhër nr. \*\*\*, datë 16.06.2021, për caktimin e oficerit të Informacionit të Operacionit FO Ëestern Ballkan 2021 Agjencisë Europiane të Rojes Kufitare dhe Bregdetare, Frontex, për periudhën 16.06.2021 - 14.07.2021 + Mandat pagese nr. \*\*\*, datë 24.06.2021 në shumën 2.100 Euro + nr. \*\*\*, datë 27.09.2022, në shumën 517 euro.
- Vërtetim nr. \*\*\* prot, datë 16.04.2018, nga DPPSH, Departamenti për Kufirin dhe Migraconin, ku konfirmohet se për periudhën janar 2017 - 06.04.2018, Saimir Boshnjaku është paguar në shumën 15.444 euro, rimbursim shpenzimesh dhe dieta jashtë shtetit nga misioni Frontex.
- Fature pagese nga IOM, ku konfirmohet pagesa në shumën 188 USD, për takimin në Shkup, në datë 02.02.2023.

### **Me e-mailin e datës 07.07.2023, subjekti ka dorëzuar:**

- Njoftim pagese nga Raiffeisen Bank, datë 05.07.2023, nga llogaria e Samir Boshnjaku, e shumës 392.476 lekë. “Tatim mbi të ardhurat individuale 2011 – 2014” Bashkëlidhur urdhër pagesat.
  - Vërtetim nr. \*\*\* prot, datë 06.03.2023, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Departamenti për Kufirin dhe Emigracionin.
- ✓ Konfirmohen të ardhurat e përfituara nga rimbursim shpenzimesh dhe dieta nga misioni Frontex, për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme të organizuara nga kjo Agjenci, për periudhën 01.01.2015 - 29.02.2023, në shumën totale 30.959 euro.

### **- Me inventarin nr. extra prot., datë 02.08.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:**

Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se:

- ❖ Deklaratat Individuale Vjetore të të Ardhurave janë kryer nga ana e tij nëpërmjet llogarisë në sistemin tatimor, për të deklaruar të ardhurat nga qiraja dhe për të paguar tatimin në burim lidhur me këto të ardhura. Deklarimi i të ardhurave dhe bëre përkatësisht në rubrikën nr. 6 “Të ardhura bruto nga qiraja” dhe janë paguar nëpërmjet llogarisë bankare pranë Raiffeisen Bank.
- ❖ Të ardhurat e subjektit nga paga, shpërblimet, për periudhën 1992- mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 21.252.000 lekë. Të ardhura nga pjesëmarrja në aktivitete/trajtime të ndryshme për periudhën 2007- 2023, në shumën rreth 209.741 lekë + 2.247 euro + 1.743 usd, konvertuar rreth 656.000 lekë.
- ❖ Të ardhura nga rimbursim i shpenzimeve dhe dieta nga misioni Frontex, për periudhën 01.01.2015 - 29.02.2023, në shumën 30.959 euro, konvertuar rreth 3.542.000 lekë.
- ❖ Të ardhurat nga qiradhënia, për periudhën 1994 - shkurt 2023, në shumën rreth 2.480.000 lekë + 82.600 USD + 66.400 Euro, konvertuar rreth 19.148.000 lekë.
- ❖ Dhuruar nga vëllai i subjektit Tasi Boshnjaku, në vitin 2008, shuma 15.000 euro.
- ❖ Të ardhura nga shit-blerja e automjetit tip Land Rover në vitin 2017, në shumën 300.000 lekë.

#### A/4 DETYRIMET FINANCIARE

- ✚ Kredi bankare me bashkëshorten M. Boshnjaku në NBG e disbursuar në 02.10.2007 me afat 20 vjeçar me 240 këste mujore, në shumën 35.000 Euro, sipas kontratës aktualisht me këst mujor 265 euro. Të dhënat marrë në datë 31.12.2022. Është përdorur për blerje apartamenti për vëllain tim Tasi Boshnjaku, me adresën Yzberisht ZK. \*\*\*\*, nr. pasurie \*\*\*\*, Kontratë e Kredisë nr. Rep. \*\*\*, nr. Kol. \*\*\*, datë 11.07.2017, kontratë e shit-blerjes apartamentit nr. Rep. \*\*\*, nr. Kol. \*\*\*, me vlerë 38.000 euro. Hipotekë nr. \*\*\*, datë 14.07.2017. Detyrimi i mbetur pa shlyer 12.954 euro.

#### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontratë Kredie, nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 02.10.2007, me Bankën Kombëtare Greke. Kredimarrës Samir Boshnjaku, Miranda Boshnjaku. **Dorëzanës** V. Filaj, M. Filaj dhe T. Boshnjaku. **Shuma** 35.000 Euro, me qëllim blerje apartamenti me adresë Farkë, Tiranë. Afati i shlyerjes do jetë 20 vjet, në 240 këste dhe si kolateral është vendosur pasuria nr. \*\*\*\* vol. \*\*, apartament me sip. 65.7 m<sup>2</sup>, në emër të V. Filaj, M. Filaj, Samir Boshnjaku dhe T. Boshnjaku.
- Certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë apartament me sip. 87.40 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*\*, vol. \*\*, fq. \*\*, ZK. \*\*\*, në emër të Tasi Boshnjaku, lëshuar në datë 14.07.2017.
- Kontratë Porosie datë 24.05.2008. Apartament 2 + 1 dhe ambjente të tjera ndihmëse, ndodhur në katin e 8 të banimit me sip. 97m<sup>2</sup>, në vlerën 38.800 Euro, nga të cilat shuma 24.000 euro dhe paguar me nënshkrimin e kontratës, kësti i dytë 12.000 euro do të paguhet brenda datës 31.08.2008 dhe kësti i fundit për pjesën e mbetur do të paguhet brenda datës 30.10.2008. Porositës Sajmir Boshnjaku dhe Tasi Boshnjaku, sipërmarrës dhe investitor, shoqëria “Palushi” shpk.
- Deklaratë Noteriale nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 29.05.2013, nga Saimir Boshnjaku, i cili ka deklaruar se heq dorë nga pjesa e tij takuese në apartamentin e prenotuar pranë firmës “Palushi” dhe kontrata përfundimtare e shitjes të bëhet në emër të vëllait të tij Tasi Boshnjaku, i cili ka kontribuar për likuidimin e vlerës së prenotimit.
- Kontratë Shitblerje pasuri e paluajtshme nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 20.11.2013. Shitës shoqëria “Palushi” sh.p.k I. H, M., H dhe A. M dhe blerës T. Boshnjaku. Apartament me sip. 87.4 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, ZK. \*\*\*, vol. \*\*, fq. \*\*\*, Yzberisht, Tiranë, në vlerën 38.800 Euro. Apartamenti ka sipërfaqe të përbashkëta 10.49 m<sup>2</sup>. Vlera e shitjes së apartamentit objekt kontrate është shlyer totalisht me këste që nga prenotimi, para redaktimit të kontratës dhe jashtë zyrës së noterisë.
- Nxjerrje llogarie nga Abi Bank datë 13.02.2023, në emër të Saimir Boshnjaku.

- ✓ Konfirmohen pagesat e kësteve të kredisë për periudhën 2019 - 2023. **Bashkëlidhur:** amortizim kredie, ku konfirmohet kësti mujor 264 euro dhe detyrimi i mbetur në datë 05.12.2022 në vlerën 12.954 euro dhe datë 05.02.2023 në shumën 12.580 euro. nuk ka veprime të tjera në këtë llogari përveçse pagesave për këst kredie).
- ✚ **ABI Bank**, me shkresën nr. \*\*\* a prot, datë 08.05.2023, konfirmon llogari kredie në Euro në emër të Saimir Boshnjaku, marrë më datë 02.10.2007, në shumën 35.000 euro dhe afat maturimi 05.10.2027. Gjendja e pashlyer e kredisë, me datë 09.03.2023 është 12.384 euro. Gjendja e llogarisë rrjedhëse të kredisë në datë 09.03.2023, në shumën 37 euro.
- ✓ Konfirmohet se shuma e kredisë, e disbursuar në datë 02.10.2007 është transferuar në të njejtën datë për blerje apartamenti, sipas Kontratës së Porosisë, \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol, datë 30.07.2007.
- ✚ **Me inventarin nr. extra prot., datë 03.07.2023**, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI: Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se:
  - “Në verën e vitit 2007, për llogari të vëllait të tij ka prenotuar një apartament, sipas kontratës së porosisë nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol, datë 30.07.2007, me vlerë 53,100 euro, në zonën e Farkës, në qytetin e Tiranës. Pagesën fillestare prej 20,000 euro e ka kryer me paratë që i ka dërguar vëllai i tij për këtë qëllim, në periudha të ndryshme kohore. Në tetor 2007, është disbursuar kredia në vlerën 35,000 euro, e cila gjithashtu u pagua në zbatim të kontratës së sipërmarrjes për këtë apartament, në zonën e Farkës. Në dhjetor 2007, kjo kontratë sipërmarrje u anulua me mirëkuptim për arsye se apartamenti nuk ishte sipas kushteve dhe standardeve të parashikuara në kontratë. Në këtë moment shoqëria i'u ktheu vetëm shumën prej 15,000 euro dhe në prill 2008 i'u ktheu pjesën e mbetur. Në maj të vitit 2008, u prenotua apartamenti me çmimin 38,800 euro, në zonën e Astirit. Pra, kredia e marrë në vitin 2007, në NBG Bank (sot ABI Bank) është përdorur për blerjen e apartamentit në zonën e Astirit, me adresë në Yzberisht me ZK. \*\*\* nr. pasurie \*\*\*\*\*. Ka sqaruar se nuk ka asnjë kredi apo detyrim tjetër të ngjashëm të marrë në datën 11.07.2017.

*Ky deklaram është lapsus gjatë plotësimit të seksionit të të dhënave konfidenciale në deklarin për vlerësimin kalimtar.*

- ✚ E vetmja kredi që subjekti dhe familjarët e tij kanë marrë, është kredia në NBG Bank (e trajtuar me lart), sipas kontratës së kredisë nr. \*\*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 02.10.2007 për shumën 35,000 Euro.
- ✚ Dokumenti me nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., i datës 11.07.2017, është kontrata e shitjes ndërmjet “Palushi” shpk dhe T. Boshnjaku, për apartamentin e porositur sipas kontratës së porosisë në datë 24.05.2008, në Yzberisht/Astir dhe ky është i vetmi dokument me referenca të ngjashme me deklarin e seksionit të të dhënave konfidenciale është lapsus qe është bërë në deklarin kalimtar, ku kontrata e shitblerjes së apartamentit në Yzberisht/Astir është deklaruar gabimisht si kontratë kredie. Apartamenti në Astir ka kushtuar 38,800 euro dhe është përballuar 34,152 euro nga kredia (statement i NBG Bank) dhe 4,648 euro është përballuar nga kthimi i këstit të parë, nga anulimi i kontratës së sipërmarrjes në zonën e Farkës. Në këto kushte, nga shuma totale që u kthye nga anulimi i kontratës së apartamentit në Farkë, janë mbuluar çmimi i blerjes prej 38,800 euro, si dhe shpenzimet përkatëse noteriale dhe shuma e mbetur prej rreth 15,000 euro i është dhuruar nga vëllai. Paga e kredisë kryhet nga ana e tij (subjektit) pasi edhe të ardhurat e qirasë së pasurisë në rrugën “Myslym Shyri” arkëtohen po nga ai, me dakortësinë e të gjithë anëtarëve të familjes së tij. Pra, siç e ka sqaruar edhe me lart, familjarët e tij jetojnë jashtë shtetit dhe kanë rënë dakord që të ardhurat e qirasë nga pasuria në rrugën “Myslym Shyri” do të administrohen nga ai dhe do të përdoren për mirëmbajtjen e kësaj pronë, si edhe për pagesën e këstit të kredisë së përmendur me sipër. Vera e apartamentit në Yzberisht/Astir është 38,800 Euro, sipas kontratës së porosisë, ndërsa deklarimi i tij në seksionin e të dhënave konfidenciale prej 38,000 Euro është një lapsus gjatë

plotësimi. Për apartamentin në Yzberisht/Astir, në emër të vëllait të tij T. Boshnjaku, disponon kontratën e porosisë me kompaninë “Palushi” të muajit maj 2008, sipas së cilës është paguar vera e apartamentit prej 38,800 euro, si dhe kontratën e shitblerjes dhe certifikatën e pronësisë. Siç u sqarua dhe me lart, burimi financiar ka qenë kredia nga NBBG Bank, e cila fillimisht, nga Banka, j'u transferua ndërtuesit për prenotimin e apartamentit në zonën e Farkës dhe me anulimin e kësaj kontrate, këto fonde u përdorën për blerjen e apartamentit Yzberisht/Astir.

### **Ka dorëzuar:**

- Kontratë porosie, nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 30.07.2007, me shoqërinë 2T, sh.p.k dhe pale porositese Saimir Boshnjaku. Apartament me sip. 118.4 m<sup>2</sup> dhe sip. verandë 37.6 m<sup>2</sup>, në vlerën totale 58.740 euro. Bashkëlidhur mandat arkëtimi nr. \*\*\* datë 30.07.2007, nga Saimir Boshnjaku, në shumën 20.000 euro.
- Mandat pagese nga 2T sh.p.k, nr. 467, datë 24.12.2007, shumës 15.000 Euro dhe nr. 294, datë 21.04.2008, në shumën 39.150 euro, me përshkrimin “*kthim pagese për revokim kontrate sipërmarrje*”.

- **Me inventarin nr. extra prot., datë 02.08.2023**, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

- Kontratë blerje (pasuri e paluajtshme) me nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 11.07.2017. Palë shitëse shoqëria Palushi sh.p.k, I. H, M. H dhe A. M dhe palë blerëse T. Boshnjaku, apartament me sip. 87.4 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*\* Zk. \*\*\*, vol. \*\*, fq. \*\*\*, Yzberisht, Tiranë, në vlerën 38.800 euro. Bashkëlidhur certifikatë për vërtetim pronësie, për pasurine nr. \*\*\*\*\*, vol. \*\*, Fq. \*\*\* Zk. \*\*\*, apartament me sip. 87.40 m<sup>2</sup> në emër të “Palushi shpk”, A. M, I. H dhe M. H, lëshuar në datë 29.6.2017.

**Konstatohet:** Kredia është marrë në vitin 2007, në ABI Bank, për blerje apartamenti sipas Kontratës së Porosisë, nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 30.07.2007, me vlerë 58.740 euro. Pas anulimit të kësaj kontrate dhe kthimit të shumës së paguar nga firma ndërtuese, shuma është përdorur për blerje apartamenti në vitin 2008, sipas Kontratës së Porosisë së datë 24.05.2008. në vlerën 38.800 euro, në emër të vëllait të subjektit T. Boshnjaku. Konfirmohet kredia e marrë nga subjekti në ABI Bank, në vitin 2007, përdorur për blerjen e apartamentit në emër të vëllait të tij, T. Boshnjaku, shlyerja e kësteve të së cilës kryhet nga subjekti. Gjendja e mbetur e kredisë ishte 12.384 Euro, si rrjedhim, nga subjekti janë shlyer këste kredie në shumën rreth 22.000 Euro (principal) gjatë periudhës 2007 - 2023.

### **Detyrimi nr. 2**

- ✚ Pagesë 1/5 truallit për shtesën anësore 40 m<sup>2</sup>, në apartamentin e banimit me sip. 65.7 m<sup>2</sup> me adresë: rruga “Myslym Shyri”. Vendimi KRRT, nr. \*\*\* datë 20.09.1996, ndërtuar në vitin 1998, ZK. \*\*\*, nr. pasurie \*\*\*\*, si dhe për vlerën e shkallës anësore dhe ballkonit të cilët janë në proces legalizimi. (çmimi do të përcaktohet nga Ministria e Finacave).

**Me inventarin nr. extra prot., datë 03.07.2023**, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI: Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se:

- Shtesa anësore prej 40 m<sup>2</sup> është regjistruar në regjistrin e pronësive dhe ai është pajisur me certifikatë pronësie vetëm për godinën, pasi kartela e pronësive ka të cilësuar kufizimin e kësaj pronë deri në zgjidhjen e marrëdhënies me truallin. Trualli i përdorur për këtë shtesë ka qenë truall shtetëror dhe do të paguhej nga banoret e të 5 kateve, që respektivisht shtuan sipërfaqet me nga 40 m<sup>2</sup>. Ai ka deklaruar se pjesa e tij takuese (1/5 e truallit) mbetet për tu paguar. Gjithashtu, sqaroi se është në proces legalizimi nje sipërfaqe e jashtme, prej rreth 10 m<sup>2</sup> (në vetratë xhami dhe shkallë, ilustruar me fotot e pasqyruara).

- Kartela e pasurisë së paluajtshme nr. pasurie \*\*\*\*\*, apartament me sip. 40 m<sup>2</sup> në emër të Saimir Boshnjaku, regjistruar në datë 02.06.2010, me Leje Ndërtimi nr. \*\*. Në seksionin “E” me shënimin “Kufizohet pasuria për zgjidhjen e marrëdhënieve me truallin në bazë të Urdhërit nr. \*\*\*, datë 09.02.2009 “Deklaratë për përfshirje në procedurat e legalizimit me nr. \*\*\* prot., datë 24.11.2014”
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar. **Pasuria trajtuar më sipër.**

#### A/5 Shpenzimet e deklarueshme

**Të viti të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit të vlerësimit ose personave të lidhur me të. Periudha 01.01.2022-31.12.2022**

✚ Shpenzime për vitin e fundit, periudha janar - dhjetor 2022, në shumën totale 167.029 lekë dhe konkretisht:

- **Uji:** Kontrata uji nr. \*\*\*\*\*, Tiranë S. Boshnjaku, paguar 27.592 lekë. Kontrata uji nr. \*\*\*\*\* Durrës M. Boshnjaku, paguar 4.750 lekë. **Totali** 32.342 lekë.
- **Celular:** S. Boshnjaku 069\*\*\*\*\*, vod. 49.290 lekë (2.000 lekë/muaj, rimbursohen nga DPPSH) + 069\*\*\*\*\* vod 6.000 lekë + 067\*\*\*\*\* eagle 18.270 lekë. **Totali** 41.079 lekë.
- **Drita:** Shpenzime për kontratën S. Boshnjaku, nr. \*\*\*\*\* në shumën 52.967 leke + kontratën M. Boshnjaku, nr. \*\*\*\*\*, Durrës 7.187 lekë + kontratën V. Veshi, Sarandë, 39.762 lekë. **Totali** 63.728 lekë.
- Shpenzime për kontratën S. Boshnjaku, nr. \*\*\*\*\*, në shumën 27.932 lekë.
- **Internet Shpenzime internet** Digicom nr. \*\*\*\*\*, shuma 29.880 lekë.
- Shpenzimet e librezës së dritave në emër të S. Boshnjaku, me kontrat \*\*\*\*\*adresë rruga “Myslym Shyri”, me vlerë 116.123 lekë, nuk paguhen nga ana ime, por gjithmone janë paguar për llogari të aktivitetit ekonomik në këto ambjente nga qiramarrësit, aktualisht është lëshuar me qira person fizik, me NIPT \*\*\*\*\* dhe detyrimet shlyen nga të ardhurat e përfituara nga veprimtaria ekonomike e këtij biznesi. Nuk janë të llogaritura në shumën përfundimtare të shpenzimeve të mia tek shuma e deklarueshme.

#### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Librezë UKT në emër të Saimir Boshnjaku, nr. Kontrate \*\*\*\*\*, Zona \*\*, me adresë rruga “Komuna e Parisit” kati 5. Konfirmohet pagesa e detyrimeve për vitin 2022 Janar - Dhjetor 2022). **Në shumën totale** 32.643 lekë.
- Librezë UKT nr. kontrate \*\*\*\*\*, në emër të Miranda Boshnjaku. Konfirmohet pagesa e detyrimeve për vitin 2022 janar - dhjetor 2022 **në shumën** 3.760 lekë.
- Përshkrimi i veprimeve nga Vodafone, për Saimir Boshnjaku, për vitin 2022. Shuma totale e paguar për periudhën 18.01.2022 - 12.02.2023, **në total** 55.388 lekë. (Nga kjo shumë paguar nga Drejtoria Rajonale për Kufirin dhe Migracionin shuma 3.799 lekë). Në emër të Miranda Boshnjaku është paguar shuma 12.000 lekë.
- Kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 27.02.2023, nga Operatori One Albania. Konfirmohet se numri 067\*\*\*\*\*, në emër të Saimir Boshnjaku, rezulton pa detyrime dhe shuma e paguar për vitin 2022 (janar - dhjetor 2022) është në shumën 18.271 lekë. Numrin fiks 04\*\*\*\*\*, lidhur në datë 16.10.2016 është mbyllur në datë 31.10.2021.
- Vërtetim debie nr. \*\*\*\*\* prot., datë 28.02.2023, nga FSHU. Konfirmohet se Saimir Boshnjaku, për kontratën nr. \*\*\*\*\*, nuk rezulton debitor për faturën e energjisë elektrike. Shuma e paguar për vitin 2022 është 55.243 lekë.

- Libreze FSHU në emër të Miranda Boshnjaku, nr. kontrate \*\*\*\*\* Durrës. Konfirmohet shuma e paguar për vitin 2022, prej 12.406 lekë.
- Libreze FSHU, në emër të V. Veshi, nr. kontrate \*\*\*\*\* Sarandë. Konfirmohet shuma e paguar për vitin 2022, prej 3.710 lekë.
- Vërtetim Debie nr. \*\*\*\*\* prot, datë 07.03.2023, nga FSHU. Konfirmohet se Samir Boshnjaku për kontratën nr. \*\*\*\*\*, nuk rezulton debitor për faturën e energjisë elektrike. Shuma e paguar për vitin 2022 është 27.932 lekë.
- Ditari i klientit nga Digicom Sh.p.k. Konfirmohet shuma e paguar nga Samir Boshnjaku, për shërbim interneti për vitin 2022, shumën 29.880 lekë.
- Vërtetim Debie nr. \*\*\*\*\* prot, datë 28.02.2023, nga FSHU. Konfirmohet se Saimir Boshnjaku, për kontratën nr. \*\*\*\*\*, nuk rezulton debitor për faturën e energjisë elektrike. Shuma e paguar për vitin 2022 është 128.767 lekë. Bashkëlidhur kopja e librezës përkatëse.

✚ **Shoqëria Rajonale Ujësjiellës - Kanalizime Tiranë**, me shkresën nr. \*\*\*\* prot, datë 17.05.2023, konfirmon se në emër të subjektit Samir Boshnjaku dhe personave të lidhur, nuk rezulton asnjë e dhënë për kontrata për shërbime Ujësjiellës - Kanalizime Tiranë sh.a, të regjistruara në sistem.

✚ **Shoqëria Rajonale Ujësjiellës - Kanalizime Durrës**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.05.2023, konfirmon se në emër të Miranda Boshnjaku, figuron një kontratë me nr. \*\*\*\*\*, me adresë L.\*\*, Plazh, Durrës, për të cilën nuk disponojnë një kopje të kontratës. (Nuk është bashkëlidhur dokumentacion për pagesat e kryera për vitin 2022).

✚ **13 Shoqëritë Rajonale të Ujësjielles - Kanalizime**, me shkresat nr. \*\*\* prot - \*\*\* prot dhe \*\*\* prot - \*\*\* prot, nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

✚ **FSHU**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.5.2023, konfirmon se në emër të Samir Foto Boshnjaku, rezultojnë dy kontrata për shërbimin e furnizimit me energji elektrike në instancën Tiranë dhe konkretisht:

- Nr. \*\*\*\*\* në adresën “Ilo Mike Qafzezi, 10”, ku shuma e paguar për vitin 2022 (dhjetor 2021 - nëntor 2022) është rreth 28.239 lekë.
- Nr. \*\*\*\*\* në adresën “Komuna e Parisit” në stacionin Selitë, ku shuma e paguar për vitin 2022 (dhjetor 2021 - nëntor 2022) në shumën rreth 55.737 lekë. Konfirmon se në emër të Samir Boshnjaku, rezultojnë një kontratë për shërbimin e furnizimit me energji elektrike, në instancën Tiranë dhe konkretisht:
- Nr. \*\*\*\*\*. Përdoruesi i pronës B. M, me NIPT \*\*\*\*\* me datë fillimi kontrate 15.06.2019 deri në 14.06.2029. Nuk është bashkëlidhur dokumentacioni i pagesave të kryera).

✚ Në emër të Miranda Boshnjaku figuron një kontratë për furnizimin e me energji elektrike me nr. \*\*\*\*\* në instancën Durrës. (Nuk është bashkëlidhur dokumentacioni i pagesave të kryera)

✚ **Vodafone Albania, sh.a**, me shkresën nr. \*\*\*\* prot, datë 14.07.2023, konfirmon se në emër të Saimir Boshnjaku, figurojnë të regjistruar: numri 35569\*\*\*\*\* me status aktiv dhe numri 35569\*\*\*\*\* me status inaktiv.

Në emër të Miranda Boshnjaku figurojnë të regjistruar numrat 35569\*\*\*\*\* dhe 35569\*\*\*\*\* me status aktiv dhe numri 35569\*\*\*\*\* me status inaktiv. Shuma e paguar për vitin 2022, në total 18.000 lekë. (nuk konfirmohet numri në emër të subjektit 0694102301 vod. 49.290 lekë.



- ✚ **One Albania sh.a**, me shkresën nr. \*\*\*\* prot., datë 21.07.2023, konfirmon se Saimir Boshnjaku ka të regjistruar numrin mobile 35567\*\*\*\*. Totali i faturave nga data 01.01.2022 deri në datë 31.12.2022, është 18.270 lekë.
- ✚ **Albania Satellite Communications shpk**, me shkresën nr. \*\*\*\* prot., datë 15.05.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- ✚ **Abissnet sh.a**, me shkresën nr. \*\*, datë 11.05.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- ✚ **Digicom shpk**, me shkresën nr. \*\* prot., datë 12.05.2023, konfirmon se klient Saimir Boshnjaku me numër kontrate \*\*\*\*\*, ka marrë shërbim interneti dhe është faturuar me faturim mujor me vlerë 2.490 lekë, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022 (total, janar - dhjetor 2022, në shumën 29.880 lekë).
- ✚ **Me inventarin nr. extra prot., datë 03.07.2023**, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI: Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se:

- Dy kontratat e OSHEE të konfirmuara nga FSHU, i takojnë apartmentit me sip. 145.4 m<sup>2</sup>, në adresën “Ilo Mitke Qafzezi, 10” (ku aktualisht banon). Kjo sipërfaqe përbëhet nga dy apartamente ngjitur me njëri-tjetrin, ku sipas planimetrisë, bashkëlidhur, njëra është apartament 2+1 me sip 100m<sup>2</sup> dhe tjetra është garsoniere me sip. 45.4 m<sup>2</sup> (së bashku përbën sipërfaqen prej 145.4 m<sup>2</sup>). Firma e ndërtimit ka paraqitur dokumentet për dy apartamente pranë OSHE për pajisje me kontrata të energjisë elektrike. Edhe aktualisht në këtë sipërfaqe ka dy kontrata OSHE, njëra me \*\*\*\*\* dhe tjetra \*\*\*\*\*, të cilat janë paguar rregullisht nga ana e tij. **Ka dorëzuar:** Planimetrinë e katit, ku ka vijëzuar sipërfaqen që ai disponon.
- Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor, lidhur me shpenzimet për ujë, energji elektrike, shpenzime telefonie dhe interneti, me kontrata në emër të tij dhe/apo personave të lidhur me të, të cilat në total, për periudhën 01.01.2022- 31.12.2022, janë rreth 252.000 lekë.

#### A/6 Udhëtimet e tre viteve të fundit

- ❖ **Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike) duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara – Periudha 01.01.2020-31.12.2022.**
  - Shpenzime për vizitë 1 ditore në Kosovë, familjarisht datë 26.12.2020, në shumën 100 euro.
  - Shpenzime për udhëtim në Francë, bashkëshortja Miranda Boshnjaku 25.08.2021-02.09.2021, në shumën 800 euro.
  - Shpenzime për udhëtim në Francë, vajza Desara Boshnjaku, ndjekja e studimeve 4-mujore në Universitetin e Pouter, Francë, në shumën 500 euro. Bursë nëpërmjet programit ERASMUS, për studentët e Fakultetit Juridik. Nga projekti janë mbuluar shpenzimet për biletat, si dhe për akomodimin dhe detyrimet e Universitetit në total 3.675 euro, shuma 850 euro në muaj, bileta 275 euro për periudhën 25.08.2021 - 28.12.2021.
  - Shpenzime për udhëtim turistik në Greqi, me agjensi turistike bashkëshortja Miranda Boshnjaku, vajza Desara Boshnjaku, nga data 12.11.202 - 13.11.2022, në shumën 200 euro.



- Udhëtimet e subjektit për arsye pune, janë mbuluar shpenzimet nga puna ose organizatorët e aktivitetetve ndërkombëtare. Shuma 30.959 euro.

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kthim përgjigje nr. \*\*\* prot, datë 27.2.2023, nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin. Konfirmohet se në sistemin TIMS, për Saimir Boshnjakun, rezultojne për 3 vitet e fundit 2020 - 2023, 7 dalje dhe 8 hyrje.
- Urdhër për Dërgimin jashtë shtetit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit:
  - nr. \*\*\*\*, datë 12.08.2022, për periudhën 25.10.2022-29.10.2022,
  - nr. \*\*\*\*, datë 16.09.2022, për periudhën 9.10.2022 - 13.10.2022,
  - nr. \*\*\*\*, datë 04.10.2022, për periudhën 02.11.2022 - 05.11.2022,
  - nr. \*\*\*\*, datë 20.10.2022, për periudhën 06.11.2022 - 10.11.2022,
  - nr. \*\*\*\*, datë 16.11.2022, për periudhën 17.11.2022 - 18.11.2022,
  - nr. \*\*\*\*, datë 22.11.2022, për periudhën 24.11.2022 - 25.11.2022,
  - nr. \*\*\*\*, datë 11.01.2023, për periudhën 15.1.2023 - 17.01.2023,
  - nr. \*\*\*\*, datë 31.01.2023, për periudhën 01.02.2023 - 03.02.2023.
- Kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 27.02.2023 nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin. Konfirmohet se në sistemin TIMS për Miranda Boshnjakun rezultojnë për 3 vitet e fundit 2020-2023, **3 dalje dhe 3 hyrje.**
- Kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot, datë 27.02.2023, nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin. Konfirmohet se në sistemin TIMS për Desara Boshnjakun, rezultojnë për 3 vitet e fundit 2 dalje dhe 3 hyrje.
- Kthim përgjigje nr. \*\*\* prot, datë 27.02.2023, nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin. Konfirmohet se në sistemin TIMS për Denis Boshnjakun rezultojnë për 3 vitet e fundit 0 dalje dhe 1 hyrje. Altestation de Bourses (Certifikate e Bursës) për programin Erasmus + (në gjuhën franceze), për Desara Boshnjaku, për vitin akademik 2021-2022. Bursa mujore 850 Euro + kontribut për kosto transporti 275 Euro. Periudha e studimeve në Universite de Poitiers, do jetë 01.09.2021 - 22.12.2021, për 112 ditë dhe mbështetja financiare do jetë në shumën 3.173 Euro + 275 euro, kontribut për transport.
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar, sa i perket hyrie - daljeve nga RSH, gjatë periudhës 2020 - 2022, të subjektit dhe personave të lidhur me të.
- ✓ Shpenzimet e deklaruara për udhëtime private, personale dhe të personave të lidhur, gjatë periudhës në total rreth 1.100 euro. (Shpenzimet për udhëimin e vajzës janë mbuluar nga programi Erasmus)

### A/7 Arsimi.


**Për arsimin e fëmijëve, madhor apo të mitur, apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimi, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore si dhe kohëzgjatjen e studimeve sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32 të ligjit të vlerësimit.**

- Pagesë për 4 nivele të gjuhës franceze të Aleanca Franceze për fëmijet Desara Boshnjaku, Denis Boshnjaku nga shtator 2016 deri në mars 2018, shuma 228.000 lekë.

- Pagesë për mësimin e gjuhës angleze të Qendra e Gjuhëve të Huaja Univers, Tiranë për Desara Boshnjaku, Denis Boshnjaku, pa mundur të merret vërtetim pagesash për periudhën kur ata kanë qenë në shkollë 9-vjeçare.
- Pagesë shkolle Universiteti “Neë York” Tiranë, për djalin Denis Boshnjaku, viti i parë pagese aplikimi për regjistrimin me mandat pagesë pranë BKT, datë 27.04.2022, pagesë shkollimi me mandat pagesë në BKT, datë 06.09.2022. Kontratë me Universitetin e Neë York datë 02.09.2022. Shuma 1.458 Euro.
- Pagesë aplikimi për regjistrim konkurrimi Universiteti Epoka, Tiranë, shuma 250 euro.
- Pagesë për djalin tim D. Boshnjaku testim të gjuhës angleze IELTS, British Council, shtator 2021, shuma 195 euro.
- Për vajzën Desara Boshnjaku, nuk janë bërë shpenzime për shkollimin e saj në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Juridik, viti i katërt, pasi është studente ekselente dhe merr bursë nga shteti 10.000 lekë në muaj.
- Vajza Desara Boshnjaku ka ndjekur studimet në shkollën e mesme shtetërore “Petro Nini Luarasi”, Tiranë 2016 - 2019. Shkollën 9-vjeçare e ka ndjekur te “Emin Duraku” Tiranë 2007 - 2016.
- Djali Denis Boshnjaku, ka ndjekur studimet në shkollën e mesme publike “Petro Nini Luarasi” Tiranë 2019 - 2022. Shkollën 9 vjeçare e ka ndjekur të shkolla publike “Emin Duraku”, Tiranë 2010-2019.
- Pagesë për vajzën Desara Boshnjaku testim të gjuhës franceze DELF Aleanca Franceze Tiranë. Mars 2022, shuma 125 euro.

#### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Vërtetim datë 27.02.2023, nga BKT, ku vërtetohet pagesa e kryer nga Denis Boshnjaku në favor të University of Neë York Tirana, shumën 1.458 euro. Bashkëlidhur fatura e transfertës së shumës 1.458 euro, në datë 06.09.2022.
- Kontrata e studentit Denis Boshnjaku, me Universitetin Neë York Tirana, datë 02.09.2022, për vitin akademik 2022 - 2023.
- Scholarship Policy 2022 - 2023 (Politikat e bursës 2022 - 2023). Bashkëlidhur plani i pagesave datë 12.10.2022, për studentin Denis Boshnjaku. Shuma totale e pagesës për vitin akademik 2022 - 2023 është 1.608 euro, nga e cila tarifa e regjistrimit 150 euro.
- Njerrje llogarie nga Credins Bank, në emër të Desara Boshnjaku. Konfirmohet kreditimi i bursës nga Fakulteti i Drejtësisë, për periudhën dhjetor 2020 - janar 2023.

 **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\* prot, datë 08.05.2023, konfirmon pagesë regjistrimi për Turgut Ozal, në shumën 24.790 lekë, nga llogaria e Saimir Boshnjakut në datë 06.12.2021.

**- Me e-mailin e datës 07.07.2023**, subjekti ka dorëzuar:

- Vërtetim nr. \*\*\*, datë 15.04.2018, nga Aleanca Franceze, Tiranë, ku konfirmohet se Denis Boshnjaku dhe Desara Boshnja ku kanë ndjekur kurse frengjishteje, prej shtatorit 2016 deri në mars 2018. Pagesa e kryer prej tyre për 4 nivelet e gjuhës është në vlerën 228.000 lekë.
- Konfirmim shlyerje tarife doktorature, nr. \*\*\* prot, datë 03.07.2023, nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë. Konfirmohet së pagesa e kryer nga Miranda Boshnjaku për doktoraturë, është në shumën totale 213.000 lekë.

- **Me inventarin nr. extra prot., datë 02.08.2023**, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

- Fature pagesë datë 07.12.2021, për Turgut Ozal, nga Denis Boshnjaku, në shumën 200 euro (24.230 lekë, Kursi i këmbimit i euro = 121.15 lekë). Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar sa i përket shpenzimeve për shkollimin e personave të lidhur.
- ✓ Shpenzimet e deklaruara për shkollimin e fëmijëve, janë në total rreth 2.028 euro + 228.000 lekë si dhe për bashkëshorten në shumën rreth 213.000 lekë, konvertuar rreth 673.000 lekë.

### A/8 DEKLARIMI I BASHKËSHORTES-MIRANDA BOSHNJAKU

#### Pasuri nr.1

- ❖ Shtëpi banimi, me sip. 55.9 m<sup>2</sup> dhe sip. trualli funksional 300 m<sup>2</sup>, ndodhur në fshatin Corraj, Bashkia Himarë, përfituar si trashëgimtare ligjore e vetme e të ndjerës V. Veshi, në bazë të vendimit nr. \*\*\*, datë 17.01.2022, të ASHK. Vlera është e papërcaktuar. Zotëron 100%.

#### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Vërtetim pronësie në emër të Miranda Boshnjaku, për pasurine truall me sip. 300 m<sup>2</sup> nga e cila truall 300 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sip. 55.9 m<sup>2</sup> ZK. \*\*\*\*, me adresë: Fshati Corraj, Njësia administrative Himarë, Bashkia Himare, lëshuar në datë 03.02.2023.
- Vendim nr. \*\*\*, datë 17.01.2022, nga ASHK Sarandë, “Për miratimin e kërkesës përkalimin në pronësi të objektit pa titull pronësie, me truallin funksional”. Ku me kërkesën nr. \*\*\* prot., datë 07.05.2019, ishte kërkuar kalimi në pronësi i objektit të ndërtuar para datës 10.08.1991 dhe të truallit funksional të tij, ose oborrit në përdorim, me subjekt kërkues Varvara Zaho Veshi. Atëhere, në përputhje me Vendimin nr. \*\*\*, datë 30.09.2020, të Këshillit të Ministrave, Drejtoria Vendore e ASHK-së Sarandë ka vendosur miratimin e dokumentit të pronësisë së objektit pa titull pronësie, me truallin funksional të tij, në ZK. \*\*\*\*, në emër të znj. Miranda Boshnjaku, me të dhënat sip. ndërtimi 55.9 m<sup>2</sup>, sipërfaqe trualli funksional 300 m<sup>2</sup>, numri i kateve 1.

- ✚ **ASHK Sarandë**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.07.2023, nuk konfirmon pasuri të regjistruara në emër të subjektit dhe personave të lidhur.

-**Me inventarin nr. extra prot., datë 03.07.2023**, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI. Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se:

- Në këtë pronë janë bërë disa riparime nga nëna e bashkëshortes znj.V. Veshi.

#### **Ka dorëzuar:**

- Vendim për Lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë Ligjore nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 17.07.2020, për trashëgimlënësin V. Veshi, e cila ka ndërruar jetë në datë 01.05.2020. Si trashëgimtare e vetme e shkallës së parë është Miranda Boshnjaku (Veshi), e cila trashëgon pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe detyrimet përkatëse të trashëgimlënësës.
- Vendim nr. \*\*\*\*, datë 06.11.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për lëshim dëshmi trashëgimie për trashëgimlënësin J. Veshi, i cili ka ndërruar jetë në datë 16.05.2005.

Trashëgimtar ligjor të shkalles se parë janë njohur; V. Veshi, bashkëshortja dhe Miranda Boshnjaku (Veshi) e bija.


- Foto të shtëpisë dhe tokës përreth saj të ndodhur në fshat. (2 copë)
- Vërtetim pronësie në emër të Miranda Boshnjaku, për pasurinë truall me sip. 300 m<sup>2</sup> nga e cila truall 300 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sip. 55.9 m<sup>2</sup>, ZK. \*\*\*, me adresë: Fshati Çorraj. Njësia administrative Himarë, Bashkia Himarë, lëshuar në datë 03.02.2023.

-**Me e-mailin e datës 10.10.2023**, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

- Vërtetim nga Kryeplaku i fshatit Çorraj, Bashkia Himarë (ish-Komuna Lukovë), Mihal Duka. Është konfirmuar se Janag Veshi dhe bashkëshortja e tij Varvara Veshi, kanë qenë, deri ditën që kanë ndërruar jetë, banorë të fshatit Corraj, Bashkia Himarë. Kanë qenë anëtarë të familjes bujqësore, kanë jetuar në shtëpinë e ndërtuar nga paraardhësit e tyre dhe kanë përfituar tokë bujqësore në bazë të ligjit 7501 datë 19.07.1991 “Për tokën”, por si gjithë banorët e fshatit këto toka bujqësore nuk i janë nënshtruar procesit të regjistrimit përfundimtar. Aktualisht shtëpia e tyre mirëmbahet nga vajza e tyre Miranda Boshnjaku (Veshi), të cilës i ka kaluar pronësia ligjore. Bazuar në deklarimin e subjektit, dokumentacionin e përgatitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyre të përmbledhur rezulton se:
  - ✓ Pasuria në zotërim 100% nga bashkëshortja e subjektit, është përfituar me Dëshmi Trashëgimie dhe miratuar me Vendim nr. \*\*\*, datë 17.01.2022, nga ASHK Sarandë. Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur.
  - ✓ Tokë truall me sip. 400 m<sup>2</sup>, marrë në qytetin e Sarandës me Vendim të Këshillit Bashkiake Sarandë nr. \*\*, datë 28.08.1999. Kjo pronë është e pahipotekuar për shkak se akoma nuk është plotësuar dokumentacioni nga Bashkia Sarandë. Vlera 193.384 lekë. Zotëron 100%

#### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Proces-verbal i datës 20.05.2002, mbi piketimin e parcelës K-I, sh-nr. \*\*, nga Zyra e Urbanistikës së Bashkisë Sarandë, në emër të Miranda Veshi.
- Vendimi i Bashkisë Sarandë nr. \*\*, datë 28.08.1999, për dhënien për ndërtim të bllokut K-I. parcela \*\*\*\*, me sip. 400 m<sup>2</sup>. Planimetria e sheshit të ndërtimit. Akt Vlerësimi i truallit nga Zyra e Urbanistikës, Bashkia Sarandë, datë 03.06.2002 dhe 27.02.2003, sheshi i ndërtimit ka sip. 400 m<sup>2</sup> dhe vera është caktuar 96.000 lekë.
- 2 mandat pagese nga Miranda Veshi në Bankën e Kursimeve datë 05.06.2002 dhe 12.03.2003, për blerje trualli nga Bashkia në shumën 96.000 lekë secila (total 192.000 lekë).

 **ASHK Drejtoria Vendore Sarandë**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.07.2023, nuk konfirmon pasuri të regjistruara në emër të subjektit dhe personave të lidhur.

- **Me inventarin nr. extra prot., datë 03.07.2023**, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI, Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se mbi këte pasuri/truall nuk ka patur dhe nuk ka ndërtime dhe as zhvillime si dhe ka dorëzuar

- Plan Rilevimi për Punime Kadastrale.

- **Me e-mailin e datës 07.07.2023, subjekti ka dorëzuar:** Vërtetim nga Bashkia Sarandë nr. \*\*\*\* prot., datë 03.07.2023, ku konfirmohet se Miranda Veshi dhe Sajmir Boshnjaku, nuk janë trajtuar me leje ndërtimi nga ana e Bashkisë Sarandë.

- ❖ Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezultojnë se:
  - ✓ Pasuria, është përfituar në vitin 1999 me Vendim të Këshillit Bashkiak Sarandë. Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e ASHK. Pasuria është e pa regjistruar.

## **Pasuria nr. 2**

- ❖ Gjendje në llogarinë me afat në Procredit Bank, 1.749.942 lekë. Zotëron 100%.

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Nxjerrje llogarie nga Procredit Bank, në emër të Miranda Boshnjaku. Konfirmohet depozitë me afat në shumën 1.719.000 lekë, në datë 06.01.2021. Në datë 06.12.2022 gjendja e llogarisë rrjedhëse rezultojnë 39.228 lekë. (Konfirmohet se depozita është hapur në datë 21.04.2011, në

shumën 700.000 lekë (400.000 lekë depozituar cash nga Miranda dhe 300.000 nga të ardhurat e pagës) me pas është hapur depozitë e dytë 600.000 lekë me të ardhurat nga paga + transferte e shumës 212.000 lekë, në datë 17.04.2012 deri në datë 25.04.2013, kur është bërë dhe bashkimi i të dy depozitave + të ardhurat e pagave në shumën 1.600.000 lekë. Më pas është bërë vetëm maturimi i saj).

- ✚ **Procredit Bank**, me shkresën nr. \*\* prot., datë 04.05.2023, konfirmon depozitë në emër të Miranda Boshnjaku, me balancë në datë 09.03.2023, shumën 1.719.000 lekë. Llogari rrjedhëse me balance 44.202 lekë.

- **Me inventarin nr. extra prot., datë 03.07.2023**, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI, Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se:

- Depozita është hapur në vitin 2011. Shuma prej 400,000 lekë e depozituar cash në datën 21.04.2011 është nga kursimet e nënës dhe babait të bashkëshortes së tij, të cilat janë krijuar nga të ardhurat e fermës bujqësore në fshatin Corraj. Siç e ka përmendur edhe me lart, bashkëshortja e tij është fëmije i vetëm dhe ka administruar llogaritë e përbashkëta bankare që ka patur me nënën e saj. Ndërsa shuma 212,000 lekë është transferuar nga llogaria me IBAN \*\*\*\*\* në bankën ProCredit, tek një tjetër llogari e bashkëshortes, po në bankën ProCredit. Burimi i kësaj shume është nga kursimet familjare (thjesht është kaluar shuma nga llogari kursimi në llogari depozite). Ka deklaruar se në deklaratat e viteve PV 2011 dhe PLF 2012, bashkëshortja e tij nuk ka deklaruar depozitat në Procredit me mendimin se këto janë depozita të lidhura me nënën e saj (llogari të përbashkëta me nënën e saj). Në deklaratën e vitit 2013 vlera e depozitës në ProCredit deklarohet 1,300,000 lekë. Në fakt në llogarinë e përbashkët të depozitës kanë qenë 1,600,000 lekë, por bashkëshortja ka menduar që shuma prej 300,000 lekë të lihej për tërheqje të mundshme nga nëna e saj.

### **Ka dorëzuar:**

- Formular transferte midis llogarive të të njëjtit klient, nga Procredit Bank, datë 17.04.2012, ku konfirmohet transferimi i shumës 212.000 lekë për në llogarinë e depozitës nga Miranda Boshnjaku.

**Konstatohet:** Llogaria është krijuar gjatë periudhës 2011- mars 2023.

- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Procredit Bank.

### **Pasuria nr. 3**

- ❖ Gjendje në llogarinë rrjedhëse të pagës në Tirana Bank, datë 31.12.2022, në shumën 1.149.973 lekë. Zotëron 100%. Bashkëlidhur deklaratës: Nxjerrje llogarie nga Tirana Bank ne emër të Miranda Boshnjaku. Konfirmohen gjendje e llogarisë në datë 30.12.2022 në shumën 1.142.973 lekë.

✚ **Tirana Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot datë 08.05.2023, konfirmon llogari page në emër të Miranda Boshnjaku me balance në datë 09.03.2023 shumën 1.374.364 lekë. (Konfirmohen se janë vetëm të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet)

- ✓ Konstatohet: Llogaria është krijuar gjatë periudhës 2011 - mars 2023. Ndryshimi midis gjendjes se deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme dhe konkretisht, deklarimi i përket datës 31.12.2022, ndërsa kërkesa dhe konfirmimi i bankës i përket datës 09.03.2023.

✚ **Banka Kombëtare Tregtare**, me Vërtetim nr. 50, datë 22.02.2023 kam konfirmuar se klienti V. Veshi, me nr. personal \*\*\*\*\*, rezulton me balance në 920.771,90 lekë dhe ne vlerën 470.040,25 lekë. Në bazë të trashëgimisë ligjore nr. \*\*\* Rep, nr. \*\*\* Kol, datë 17.07.2020, konstatohet se Miranda Boshnjaku është trashëgimtare e vetme ligjore. Shuma total 1.390.812,15 lekë.

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Konfirmim i gjendjes së llogarisë nr. \*\*\* prot., datë 22.02.2023, nga BKT. Llogari në emër të V. Veshi. Gjendja e depozitave në datë 22.02.2023, në shumën 920.771 lekë dhe 470.040 lekë.
- Vendim i Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. \*\*\*, datë 06.11.2006, për Leshimin e Dëshmisë së Trashëgimise per trashëgimlënësin J. Veshi. Si trashëgimtare ligjore të rradhës së parë dhe të vetme janë njohur V. Veshi, bashkëshortja dhe Miranda Boshnjaku (Veshi), e bija.

✚ **Banka Kombeëtare Tregtare**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 08.05.2023, nuk konfirmon llogari në emër të subjektit dhe personave të lidhur.

- **Me inventarin nr. extra prot., datë 03.07.2023**, subjekti ka dorëzuar ne ILDKPKI:

- Vendim për Lëshimin e Dëshmise së Trashëgimise Ligjore nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 17.07.2020, për trashëgimlënësen V. Veshi, e cila ka ndërruar jetë në datë 01.05.2020. Si trashëgimtare e vetme e shkallës së parë është Miranda Boshnjaku (Veshi), e cila trashëgon pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe detyrimet përkatëse të trashëgimlënëses.

- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar.



## A/9 DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Të ardhura nga puna në Policinë e Shtetit, për periudhën 01.11.1995 deri në 03.05.2018, sipas vërtetimit datë 13.04.2018, të Akademisë së Sigurisë, vërtetimit të Raiffeisen Bank datë 17.04.2018, vërtetimeve sipas viteve të Tirana Bank, datë 31.12.2022. Shuma 18.489.270 lekë.
- Të ardhura nga puna e kryer (shpërblime, dieta shërbimi, kompensim për veshje, honorare nga puna si pedagoge e jashtme dhe orët jashte orarit, për periudhën 2005 - 30.04.2018, dokumentuar në llogarinë rrjedhëse bankare, në shumën 1.048.166 lekë.
- Të ardhura nga puna si pedagoge e jashtme pranë Universitetit Albanian University për periudhën 2007-2014, sipas levizjeve të llogarisë pranë ProCredit Bank, datë 31.12.2022, shuma 1.749.942 lekë.
- Të ardhura nga puna si pedagoge e jashtme pranë Universitetit Justiniani I, 2008 - 2010, në ish-Banka Amerikane dhe sipas lëvizjeve të llogarisë në Union Bank, datë 10.04.2018 (llogari e mbyllur), shuma 204.320 lekë.
- Të ardhura nga UNDP për vizite studimore në Vjenë, qershor 2015, shuma 906 USD.
- Të ardhura nga taksa e solidaritetit 1997 - 2000, të llogaritura me përafërsi sipas dokumenteve që disponohen nga Policia e Shtetit, shuma 440.000 lekë.
- Të ardhura nga shitja e një apartamenti banimi, me sip. 72 m<sup>2</sup>, me adrese “ish-Fusha e Aviacionit Civil”, godina \*\*, kati \*\*, ap. \*\*, e cila ka qenë në bashkëpronësi me bashkëshortin tim Saimir Foto Boshnjaku, 1.900.000 lekë.
- Të ardhura nga shitja e një garazhi makine, me sip. 16 m<sup>2</sup>, me adresë “Ish-Fusha e Aviacionit Civil” God \*\*, garazhi nr. \*\*, nr. Kontrate Rep. \*\*\*\*., Kol. \*\*\*, datë 08.07.2002, e cila ka qenë në bashkëpronësi me bashkëshortin tim Saimir Foto Boshnjaku, 100.000 lekë.

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Vërtetim nr. \*\* prot, datë 13.04.2018, nga Akademia e Sigurisë. Konfirmohen të ardhurat nga paga e Miranda Boshnjaku (Veshi) për periudhën 01.11.1995 - 31.12.2005, në shumën totale neto 2.863.029 lekë.
  - Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, datë 30.03.2018, në emër të Miranda Boshnjaku. Konfirmohen të ardhurat nga paga për periudhën shkurt 2005 - nëntor 2010.
  - Nxjerrje llogarie nga Tirana Bank, në emër të Miranda Boshnjaku, për periudhën janar 2011-dhjetor 2022. Konfirmohen të ardhurat nga paga, orë suplementare, veshje dhe dieta për periudhën dhjetor 2010 - nëntor 2022.
  - Nxjerrje llogarie nga ProCredit Bank në emër të Miranda Boshnjaku. Konfirmohen të ardhurat nga paga për periudhën nëntor 2007- gusht 2013, në shumën rreth 1.433.363 lekë.
  - Nxjerrje llogarie nga Union Bank, në emër të Miranda Boshnjaku, datë 10.04.2018. Konfirmohen të ardhurat nga paga për periudhën tetor 2009 - maj 2010, në shumën neto 138.600 lekë.
  - Nxjerrje llogarie nga Intesa SanPaolo Bank, datë 05.04.2018, në emër të Miranda Boshnjaku. Konfirmohen të ardhurat nga UNDP në vitin 2015, në shumën 906 USD.
- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\* prot, datë 08.05.2023, konfirmon të ardhurat nga paga për Miranda Boshnjaku, për periudhën prill 2005 - dhjetor 2010, në shume totale 3.872.385 lekë. (Nga janar 2006 - dhjetor 2010, në shumën 3.482.329 lekë)



+ **Tirana Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 08.05.2023, konfirmon të ardhurat nga paga e Miranda Boshnjaku, për periudhën janar 2011 - shkurt 2023, në shumën totale 13.270.197 lekë.

+ **Intesa SanPaolo Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 03.08.2017, konfirmon:

Llogari rrjedhëse në monedhën lekë, në emër të Miranda Boshnjaku, për periudhën 01.01.2008 - 27.05.2015. Konfirmohen të ardhurat nga paga nga Universiteti Justiniani i Parë, për periudhën tetor 2008 - janar 2009, në shumën \$ 4.600 lekë.

Llogari rrjedhëse në monedhën USD, në emër të Miranda Boshnjaku, për periudhën 25.05.2015 - 18.11.2016.

Konfirmohen të ardhurat nga UNDP, në vitin 2015, në shumën 906 USD.

+ **Procredit Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 04.05.2023, konfirmon të ardhurat nga paga për Miranda Boshnjaku, për periudhën nëntor 2007- tetor 2013, në shumën totale rreth 1.571.063 lekë.

+ **Union Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 23.05.2023, konfirmon të ardhurat nga paga për Miranda Boshnjaku, për periudhën tetor 2009 - maj 2010, në shumën totale rreth 138.600 lekë.

+ **Instituti i Sigurimeve Shoqërore**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 10.05.2023, konfirmon se për Miranda Boshnjaku, janë derdhur kontributet për periudhën dhjetor 2012 - mars 2023.

+ **ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror**, me shkresën nr. \*\*\*, datë 16.05.2023, konfirmon se nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave për periudhën 1994 - 2012, të punonjësve të siguruar në subjektet juridike apo fizike, nuk mund të konfirmojnë periudhën e kontributeve apo paga mbi të cilën janë siguruar në qofte se nuk jepen emërtimi i qendrës së punës, Nipti i subjektit, fotokopje e librezës së punës për Miranda Boshnjaku.

- **Me inventarin nr. extra prot., datë 03.07.2023**, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI, sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se:

➤ “të ardhurat nga taksa e solidaritetit, paguheshin cash nga Akademia e Policisë. Janë përpjekur të marrin informacion, por nuk gjendej dokumentacioni në arshive. Gjithashtu i kanë dërguar një kërkesë zyrtare Akademisë së Policisë dhe po presin përgjigje.

#### **Ka dorëzuar:**

Kërkesë nr. \*\*\* prot., datë 30.06.2023, drejtuar Akademisë së Sigurisë, për të ardhurat e Miranda Boshnjaku (Veshi), si pedagoge nga nëntor 1995 - tetor 2008, si dhe të ardhurat nga taksa e solidaritetit.

- **Me e-mailin e datës 07.07.2023**, subjekti ka dorëzuar:

- Kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 03.07.2023, nga Akademia e Sigurisë, ku konfirmohet se për periudhën e takës së solidaritetit janar 1999 - dhjetor 2002, nuk kanë kopje të VKM që ka dalë për këte qëllim dhe list-pagesat e taksës së solidaritetit nuk janë ruajtur të gjitha. Për vitin 1999 - 2000 mendojnë se janë e njëjta shumë.
- Të ardhurat për periudhën mars 2001- dhjetor 2002, në shumën totale 101.550 lekë.
- Vërtetim nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, ku konfirmohet se Miranda Boshnjaku, është angazhuar si personel akademik me kohë të pjesshme, në semestrin e dytë të vitit akademik 2012 - 2013 dhe në semestrin e dytë të vitit akademik 2018-2019.

- Vërtetim nr. \*\*\* prot, datë 03.07.2023, nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë. Konfirmohen të ardhurat e përfituara nga Miranda Boshnjaku, për mbingarkese në punë për periudhën 2012 - 2013, në shumën 32.400 lekë dhe për periudhën 2018-2019, në shumën 29.957 lekë.

#### A/10 DETYRIMET FINANCIARE

##### Detyrimi nr. 1

- ❖ Kredi bankare në NBG, marrë me bashkëshortin Samir Foto Boshnjaku, e disbursuar në 02.10.2007, me afat 20-vjeçar në shumën 35.000 Euro, me këst mujor 265 euro. Të dhënat marrë në datë 31.12.2022. Në këtë kredi deri tani është paguar asnjë këst nga të ardhurat e deklarueses. Kjo kredi është përdorur për blerje apartamenti për vëllain e bashkëshortit T. Boshnjaku, me adresë Yzberisht, ZK. \*\*\*\*, nr. pasurie \*\*\*\*\*, Kontratë nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 11.07.2017, me vlerë 38.000 euro. Hipoteke T. Boshnjaku nr. \*\*\*\*, datë 14.07.2017. Detyrimi i mbetur pa shlyer 12.954,14 euro.
- ✓ **Trajtuar me sipër.**

#### A/11 DEKLARIMI I PERSONIT TË LIDHUR, DEKLARIMI I TË ARDHURAVE I VAJZËS DESARA BOSHNJAKU

- ❖ Banka Credins nr. llogarie \*\*\*\*\*. Gjendja e llogarisë datë 31.12.2022, në shumën 303.912,8 lekë. Zotëron 100%. **Bashkëlidhur deklaratës:**
- Nxjerrje llogarie nga Credins Bank në emër të Desara Boshnjaku. Konfirmohet kreditimi i bursës nga Fakulteti i Drejtësisë për periudhën dhjetor 2020 - janar 2023. Gjendja e llogarisë në datë 31.12.2022, në shumën 303.912 lekë dhe në datë 17.02.2023 në shumën 313.912 lekë.
- ✚ **Credins Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 23.5.2023, konfirmon llogari page në emër të Desara Boshnjaku, me balancë në datë 09.03.2023, shumën 322.612 lekë.
  - ✓ Konfirmohen të ardhurat nga Fakulteti i Drejtësisë, për periudhën dhjetor 2019 deri në mars 2023, në shumën totale 325.768 lekë.
  - ✓ Konstatohet: Llogaria është krijuar gjatë periudhës 2019 - mars 2023.
  - ✓ Konfirmohet nga Credins Bank llogaria e deklaruar në emër të vajzës Desara Boshnjaku.
- ❖ **Banka France BNP PARIBAS** në qytetin Poitiers me IBAN \*\*\*\*\*, mbyllur në datë 31.12.2021. Gjendja 0.
  - Me inventarin nr. extra prot., datë 03.07.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:
  - Dokumentacion në gjuhën frënge për hapjen dhe mbylljen e llogarisë bankare në BNP Paribas Bank, në emër të Desara Boshnjaku.
  - Me inventarin nr. extra prot., datë 02.08.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:
  - Dokumentacion i përkthyer në gjuhën shqipe, për mbylljen e kontrates së mbajtësit në BNP Paribas në emër të Denisa Boshnjaku. Konfirmohet mbyllja e llogarisë në datë 23.12.2021. Njësuar me originalin me Vërtetimin nr. \*\*\* Rep., datë 02.08.2023.

- Bordero për tërheqjen e Abonimit në emër të Desara Boshnjaku. Konfirmohet heqja dorë nga oferta “Deklarim në mënyre direkte” që kishte lidhur me BNP Paribas, në Poitiers datë 22.09.2021. Vërtetuar me origjinalin me Vërtetimin nr. \*\*\* Rep., datë 02.08.2023.
- Vërtetim banimi, për Desara Boshnjaku datë 24.12.2021, ku konfirmohet se ka banuar në qytetin Cite Marie Curie, godina \*\*, banesa \*\*\*, Rue jean Richard Bloch, \*\*\* Potiers, për periudhën 18.11.2021 - 27.12.2021. Pagesa mujore 236 euro. Vërtetuar me origjinalin nr. \*\*\* Rep, datë 02.08.2023.
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar. Llogaria mbyllur në dhjetor 2021.

#### A/12 DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Të ardhura nga bursa e Bashkisë Tiranë, Desara Boshnjaku si studente ekselence në Fakultetin Juridik, Tiranë, 10.000 leke në muaj, duke filluar nga viti 2019 e në vazhdim Banka Credins. Gjendja e llogarise në datë 31.12.2022, në shumën 303.912,8 lekë.
- Të ardhura për ndjekje të studimeve në Universitetin Poiter, Francë, Desara Boshnjaku, ndjekja e studimeve 4 mujore, shuma 3.675 Euro. Bursë e akorduar nëpërmjet programit ERASMUS për studentet e fakultetit Juridik. Nga projekti janë mbuluar shpenzimet për biletat, si dhe për akomodimin dhe detyrimet e universitetit në total 3.675 euro. Bursa ka qene në shumën 850 euro në muaj, bileta 275 euro për periudhën 25.08.2021 - 28.12.2021.

#### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Nxjerrje llogarie nga Credins Bank, në emër të Desara Boshnjaku. Konfirmohet kreditimi i bursës nga Fakulteti i Drejtësisë, për periudhën dhjetor 2020 - janar 2023 në shumën totale rreth 315.770 lekë.
- Attestation de Bourses (Certifikatë e Bursës) për programin Erasmus (në gjuhën franceze), për Desara Boshnjaku, për vitin akademik 2021 - 2022. Bursa mujore 850 euro + kontribut për kosto transporti 275 Euro. Periudha e studimeve në Universite de Poitiers do jetë 01.09.2021 - 22.12.2021, për 112 ditë dhe mbështetja financiare do jetë në shumën 3.173 Euro + 275 euro kontribut për transport.
- ✚ **Credins Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 23.05.2023, konfirmon llogari page në emër të Desara Boshnjaku, me balance në datë 09.03.2023, shumën 322.612 lekë.
- ✓ Konfirmohen të ardhurat nga Fakulteti i Drejtësisë, për periudhën dhjetor 2019 deri në mars 2023, në shumën totale 325.768 lekë.
  - Të ardhura nga bursa e vajzës Desara, në Shqipëri, për periudhën 2019 - 2023., rezultojnë rreth 326.000 lekë.
  - Të ardhura e vajzës nga bursa në Francë, nëpërmjet programit Erasmus, për vitin akademik 2021-2022, në shumën totale 3.448 Euro, konvertuar rreth 395.000 lekë.

#### A/13 DJALI DENIS BOSHNJAKU, KA PLOTESUAR AUTORIZIMIN, KU KA DEKLARUAR SE NUK ZOTËRON PASURI VEÇMAS TË REGJISTRUARA NË EMRIN E TIJ.

- ✚ **Banka e Shqipërisë, BKT, Banka e Bashkuare Shqipërisë, Fibank, OTP, Raiffeisen Leasing, Porche Leasing sh.p.k, Albain Leasing sh.a, Landeslease sh.a, Raiffeisen Invest sh.a, Credins Invest, AK-Invest sh.a, EasyPay sh.p.k, Fondi Besa, Institucioni Financiar NOA sh.a, Iutecredit Albania, Kredo.Al, Albanian Satellite Communications, Abissnet**

**sh.a**, konfirmon se subjekti Samir Boshnjaku dhe personat e lidhur me të, **nuk** janë kliente të tyre, çka konfirmohet me deklarinimin.

✚ **ASHK, Zyrat/Drejtoritë Vendore, Tirana Rurale 1, Tirana Rurale 2, Tirana Jug, Kamëz Vorë, Zonat & Stimuluara, Librazhd, Krujë, Devoll, Berat, Fier, Korçë, Gjirokastrë, Pogradec, Mallakaster, Gramsh, Kuçovë, Pukë, Malësi & Madhe, Kukës, Kavajë,**

**Lushnje, Elbasan, Kolonje, Has, Bulqizë, Skrapar, Tropojë, Mat Tepelenë, Mirditë, Përmet, Kurbin, Lezhë, Peqin, Sarandë, Dibër, Vlorë, Shkodër nuk** konfirmojnë pasuri të paluajtshme të regjistruara në emër të subjektit dhe personave të lidhur.

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 08.05.2023, konfirmon të ardhurat nga paga për Miranda Boshnjaku, për periudhën prill 2005 - dhjetor 2010. Konfirmohet depozitë e hapur në datë 02.10.2008, në shumën 1.554.000 lekë (shuma 1.354.001 Mb dublikimi + 200.000 lekë transferuar nga llogaria e pagës). Mbyllur depozita në datë 17.11.2010, ku është tërhequr shuma 2.300.000 lekë dhe me pas mbyllur llogaria e depozitës në datë 11.1.2011, ku është tërhequr shuma e mbetur në llogari prej 13.189 lekë.

- Me inventarin nr. extra prot., datë 03.07.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se:

➤ Depozita prej 1.554.000 lekë, në 02.10.2008 është krijuar nga kursime të familjes dhe tërheqja e shumës prej 257.466 lekë nga teprica e llogarisë së babait në Raiffeisen Bank pas vdekjes së tij, me anë të dëshmisë së trashëgimisë, çelur me Vendim Gjykatë nr. \*\*\* Akti, nr. Vendimi nr. \*\*, datë 06.11.2006. Shuma prej 2.300.000 lekë, tërhequr nga Raiffeisen Bank, ka pasur si destinacion pagesën për blerjen e apartamentit në Durrës, në datë 17.11.2010, në zbatim të kontratës së sipërmarrjes, me datë 12.11.2010. Për mosdeklarimin e depozitës në Raiffeisen Bank ka dhënë shpjegime pranë ILDKPKI në vitin 2009, pasi është konstatuar në atë vit. Mosdeklarimi ka ndodhur si lapsus në kuptimin e mënyres se si duhet të plotësonin një deklaratë të tillë, pasi ishte hera e parë që plotësonin këtë deklaratë.

Kontrata e sipërmarrjes për blerjen e apartamentit në Durrës është nënshkruar me datë 12.11.2010, ndërsa tërheqja nga depozita (depozita e përbashkët e bashkëshortes me nënën e saj) në Raiffeisen Bank është bërë në datë 17.11.2010, pra 5 ditë më vonë nga nënshkrimi i kontratës. Shuma e tërhequr është paguar me cash për blerjen e apartamentit në Durrës, sipas kontratës së mësipërme. Siç e përmendëm me lart, prindërit e bashkëshortes kanë patur të ardhura nga ferma bujqësore, që me së shumti janë depozituar në një llogari të përbashkët të bashkëshortes se subjektit me nënën e saj, në Raiffeisen Bank, me nr. \*\*\*\*\*. Nga kjo llogari, bashkëshortja e tij, Miranda Boshnjaku, ka tërhequr shumën 2.300.000 lekë, në datën 17.11.2010. Pra, depozita e përbashkët në Raiffeisen Bank, e bashkëshortes me nënën e saj është prishur dhe ka kaluar në llogari likuiduese, nga ku është tërhequr dhe i është paguar firmës. Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar. (Apartamenti në Durrës i blerë në vitin 2010, trajtuar me siper).

✚ **Intesa Sanpaolo Bank**, me shkresën nr. \*\*\*\* prot, datë 15.05.2023, konfirmon 2 transaksione në emër të Saimir Boshnjaku, ku është tërhequr shuma 268,53 USD në datë 26.10.2016 dhe shuma 227,44 USD në datë 21.06.2019.

- Me inventarin nr.extra prot., datë 03.07.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI, Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se:

- Këto pagesa janë dieta të dhëna nga IOM për aktivitetet e zhvilluara jashtë Shqipërisë, në kuader të vizitave zyrtare dhe këtë fakt e verteton me një kopje të vërtetimit të lëshuar nga IOM, në datë 26 qershor 2023 ku konfirmohen vizitat e ti.
- Vërtetim (në gjuhën angleze) nga IOM, datë 26.06.2023, ku konfirmohen pagesat për Saimir Boshnjaku, në shumën 268,53 usd, në vitin 2016 dhe 227,44 usd, në vitin 2019.
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar.

✚ **Abi Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 08.05.2023, konfirmon kreditim të shumës 10.000 euro, në datë 12.07.2006 dhe tërheqjen e saj në të njëjtën datë, nga llogaria e subjektit.

-Me inventarin nr. extra prot., datë 03.07.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI, sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se:

- këtë shumë e ka depozituar cash në datën 12.07.2006, pasi po aplikonte për një vizë turistike dhe në listën e dokumentacionit të aplikimit kërkohej një vërtetim që kishe mjete të mjaftueshme financiare. Këtë depozitim e bëri kryesisht nga gjendja e cash-it dhe kursimeve familjare (remitancat periodike që sillnin familjaret). Brenda të njëjtës ditë këtë sasi mjetesh monetare e ka tërhequr nga Banka. Subjekti ka dhënë sqarime në lidhje me burimin e shumës se kredituar në Abi Bank në vitin 2006.

✚ **Tirana Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 08.05.2023, konfirmon të ardhurat nga paga e Miranda Boshnjaku, për periudhën janar 2011 - shkurt 2023. Gjithashtu nga statementi bankar konfirmohen:

1. depozite euro datë 05.09.2011 deri në 06.06.2012, vlera 300.000 lekë (nga të ardhurat e pagës),.
2. depozitë 200.000 lekë hapur në datë 15.03.2012 deri në datë 21.06.2012. (të ardhura nga pagat) tërheqje nga llogaria në datë 08.06.2015, shuma 300.000 lekë;
3. depozitë në shumën 500.000 lekë, në datë 27.06.2016 (nga të ardhurat e pagës) deri në datë 04.01.2018, tërhequr nga llogaria në datë 12.01.2018, tërheqje 200.000 lekë, në datë 13.1.2017
4. pagesë tarife shkollimi për Univesitetin e Tiranës, në datë 06.03.2017, në shumën 138.667 lekë,
5. Transfertë në llogarinë e V. Veshi, në datë 04.01.2018, shuma 400.000 lekë, tërheqje e shumës 500.000 lekë, në datë 08.07.2019;
6. Tërheqje e shumës 300.000 lekë, në datë 01.06.2020.

- **Me inventarin nr. extra prot., datë 03.07.2023** subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

- sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se shuma prej 300,000 lekë është lenë nga bashkëshortja në llogarinë e përbashkët me nënën e saj, që të përdorej nga kjo e fundit për shpenzime të ndryshme. Siç e kemi sqaruar edhe me lart, llogaritë e përbashkëta me nënën janë krijuar me së shumti nga të ardhurat nga ferma e prindërve të bashkëshortes, e cila ka qenë trashëgimtare e vetme e prindërve të saj. Destinacioni i shumës së tërhequr 200.000 lekë, pas mbylljes së depozitës ka qenë për nevoja të familjes, për ne dhe për prindërit e bashkëshortes. Në vitin 2012, bashkëshortja ka paguar një këst të studimeve doktorale, ndërsa në periudhën 2018 deri

në 2020, vlerat e tërhequra nga llogaritë e saj kanë shërbyer për ndjekjen e mjekimeve të nënës së saj, për sëmundje të rëndë (përfshirë kimioterapi), nga e cila ndërroi dhe jetë më pas. Specifikisht, shumat prej 400,000 lekë dhe 500,000 lekë kanë shërbyer me synim kurimin jashtë shtetit në rast nevojë të nënës së bashkëshortes. Pagesa e datës 06.03.2017, e bërë në llogari të Universitetit të Tiranës është bërë për likuidimin e dy kësteve të fundit të studimeve doktorale të bashkëshortes.

- + **AK-Invest sh.a**, me shkresën nr. \*\*\*\* prot., datë 15.5.2023, konfirmon se subjekti Saimir Boshnjaku dhe personat e lidhur, nuk kanë llogari, nuk janë klientë kredimarrës dhe nuk kanë kryer transaksione nëpërmjet rrjetit AK-Invest sh.a.
- + **Qendra Kombëtare e Biznesit**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 04.05.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur, nuk figurojnë të jenë pajisur me NUIS (NIPT), si persona fizikë apo të zotërojnë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë regjistrimit tregtar.
- + **Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve**, me shkresën nr. \*\*\*\*., datë 11.05.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur, nuk figurojnë të regjistruar në organet tatimore për ushtrim të ndonjë aktiviteti privat.
- + **Drejtoria e Përgjithshme Detare**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2023, konfirmon se në emër të subjektit dhe personave të lidhur, nuk figurojnë të regjistruara mjete lundruese.
- + **Instituti i Sigurimeve Shoqërore**, me shkresën nr. \*\*\*\* prot., datë 10.5.2023, konfirmon se M. Filaj, përfiton pension pleqërie me masë aktuale 13.734 lekë, nga muaji maj 2016.
- + **ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror**, me shkresën nr.\*\*\*\*., date 16.05.2023, konfirmon se nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave, për periudhën 1994 - 2012, të punonjësve të siguruar në subjektet juridike apo fizike, nuk mund të konfirmojnë periudhën e kontributeve apo paga mbi të cilën janë siguruar, në qoftë se nuk jepen emërtimi i qendrës së punës, Nipti i subjektit, fotokopje e librezës së punës.

✓ **Në përfundim të hetimit të kryer:**

Trupa e vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura nga institucionet e ndryshme dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 i ndryshuar, në vlerësimin përfundimtar, bazuar në parimin e kontradiktorialitetit u mbështet edhe në shpjegimet që dha subjekti pas dërgimit të relacionit si dhe ato në seancën dëgjimore dhe në përfundim arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit: Saimir Foto Boshnjaku:

- **Ka bërë deklaram të saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**
- **Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- **Nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- **Nuk është kryer deklaram i rremë;**
- **Subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.**



## B. KONTROLLI I FIGURËS

41. Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.”

42. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre element:

1. të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
2. raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
3. verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, gërmra (ë), e ligjit 12/2018, i ndryshuar.

43. Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit Saimir Boshnjaku, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë të deklarimeve si dhe të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.

44. Për kontrollin e figurës Trupa e vlerësimit administroi:

- a. Deklaratën e “Kontrollit të Figurës”
- b. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
- c. Korrespondencën me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë.

✚ Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore si organ ndihmës, në përputje me nenin 42 të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, për vlerësimin e kontrollit të figurës ka dorëzuar nëpërmjet shkresës Nr.\*\*\* datë 18.07.2023 raportin e kontrollit të figurës<sup>2</sup> ku ka konstatuar se:

❖ **Subjekti i vlerësimit z. Saimir Foto Boshnjaku, me detyrë Drejtor i Departamentit të Kufirit dhe Migracionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.**

❖ **Në deklaratën e Kontrollit të Figurës subjekti ka deklaruar se:**

- Nuk ka pasur emër apo mbiemër tjetër më parë.
- Nuk është njohur nga të tjerët me ndonjë nofkë, emër apo mbiemër tjetër nga ai që ka patur apo ka regjistruar në gjendjen civile.
- Nuk ka pasur apo ka shtetësi tjetër.

<sup>2</sup> Raporti mbi kontrollin e figurës nr. \*\*\*\*\* datë 20.07.2023



- Nuk ka qenë asnjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një vepre penale
- Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligj zbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk ka qenë caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo.
- Nuk është lëshuar asnjëherë ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk është marrë asnjëherë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- Subjekti ka deklaruar që nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët, bashkëjetuesi/t si dhe personat e përfshirë në certifikatën familjare) është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së Subjektit.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar
- Subjekti nuk është në dijeni që një nga anëtarët e familjes së tij të kenë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
- Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të veçantë apo të ketë gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryej aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit
- Nuk ka vuajtur nga çrregullime mendore kronike
- Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish- Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit nr. 45/2015 “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish -shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

45. Në mbështetje të neneve 35-42 të ligjit nr 12/2018 i ndryshuar trupa e vlerësimit zhvilloj hetimin mbi kontrollin e figurës duke u bazuar në kthim-përgjigjet e institucioneve ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë, raportin e Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit dhe deklaratimet e subjektit të vlerësimit **nga ku u konstatua nga :**

1. **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile** me shkresën “I kufizuar” nr. \*\*\*\* prot., datë 12.06.2023 për subjektin e vlerësimit z. Saimir Foto Boshnjaku bën me dije se:
  - a. Nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve
  - b. Nuk ka ndryshuar shtetësi (lenie ose marrje shtetësie)

2. **Drejtoria e Përgjithshem e Burgjeve** me shkresën “I kufizuar” nr. \*\*\*\* prot ., datë 19.05.2023 dhe shkresën “i kufizuar” nr \*\*\*\* prot., datë 28.12.2023 për subjektin e vlerësimit dhe personat e lidhur me të bën me dije se:
  - a. Nuk rezultojnë të dënuar
  
3. **Institucion ligjbatues**, me shkresën “I kufizuar” nr.\*\*\*\*prot., datë 30.05.2023 dhe shkresë “e paklasifikuar” nr.\*\*\*\* datë 30.05.2023 për subjektin e vlerësimit z. Saimir Boshnjaku si dhe për personat e lidhur sipas certifikatës familjare **nuk kanë**:
  - a. Të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimin e ngritur në kuptimin penal dhe të cënimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;
  - b. Të dhëna për kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar (*sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.95/2016 “ për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”*) ku mund të përfshihen biseda, foto, vëzhgime takimesh apo biseda telefonike etj;
  - c. Të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (*të dënuar ose proceduar penalisht, brenda apo jashtë territorit të republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr 10192 datë 03.12.2009 “për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë i ndryshuar.*);
  - d. Të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e ndonjë vepre penale;
  - e. Të dhëna në lidhje nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e ndonjë vepre penale.
  - f. Të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonje urdhër-arresti ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale;
  - g. Të dhëna në lidhje me ndonje masë debimi nga një shtet i huaj;
  - h. Të dhëna për gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s.
  - i. Të dhëna që nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
  - j. Nuk ka procedime disiplinore apo masa disiplinore në ngarkim të subjektit të vlerësimit Saimir Boshnjaku.
  
4. **Institucion ligjbatues**, me shkresën “Konfidencial” nr.\*\*\*\* prot., datë 31.05.2023., për subjektin e vlerësimit z. Saimir Boshnjaku bën me dije se:
  - a. Nuk disponon të dhëna.
  
5. **Institucion ligjbatues**, me shkresë “Sekret” nr. \*\*\* prot., datë 13.06.2023 dhe shkresën nr. \*\*\*\* prot., datë 19.06.2023, për subjektin e vlerësimit z. Saimir Boshnjaku dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare bën me dije se:
  - a. Nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitet të paligjshëm;
  - b. Nuk ka precedent penal të referuar;
  - c. Për subjektin e vlerësimit nuk administrohen ankesa, të dhëna ose informacione.
  
6. **Institucion ligjbatues**, me shkresën “I kufizuar”, nr \*\*\*\*. prot, datë 10.07.2023 për subjektin e vlerësimit z. Saimir Boshnjaku bën me dije se:

- a. Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi;
  - b. Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal;
  - c. Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo presonit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 të Kodit të Procedurës Penale;
  - d. Nuk ka pasur regjistrim të njoftimit të veprës penale;
  - e. Nuk ka pasur raste të urdhërit ndërkombëtar të ndalimit.
7. **Institucion ligjzbatues**, me shkresën “I kufizuar” nr. \*\*\*\* prot., 07.06.2023 dhe me shkresën nr. \*\*\*\* prot datë 29.12.2023 bën me dije se, për subjektin e vlerësimit z. Saimir Boshnjaku dhe personat e lidhur me të:
- a. Nuk rezulton të jenë regjistruar procedimi penal.
8. **Institucion ligjzbatues**, me shkresën “Sekret” nr. \*\*\*\* prot, datë 25.05.2023 bën me dije se për subjektin e vlerësimit Saimir Boshnjaku dhe personat e lidhur me të.
- a. Rezultojnë raportime të cilat nga verifikimi janë konstatuar se janë veprime dhe transaksione rutinë.
9. **Autoriteti Kombëtar për Sigurimin e Informacionit të Klasifikuar**, me shkresën “i kufizuar” nr. \*\*\*\* prot., datë 25.05.2023 për subjektin e vlerësimit z. Saimir Boshnjaku bën me dije se:
- a. Është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), niveli i klasifikimit “Tepër Sekret”, me datë lëshimi 10.10.2022, të vlefshme deri në datën 02.10.2026
  - b. Për subjektin e vlerësimit nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP-së.
  - c. Nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.
10. **Avokati i Popullit** me shkresën “e paklasifikuar” me nr. \*\*\*\* prot., datë 30.05.2023 për subjektin e vlerësimit z. Saimir Boshnjaku bën me dije se:
- a. Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
  - b. Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.
11. **Institucion ligjzbatues**, me shkresën “ i kufizuar nr. \*\*\* prot., datë 08.06.2023 për subjektin e vlerësimit z. Saimir Foto Boshnjaku, bën me dije se:
- a. Nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 Korrik 1991.
12. **Institucionet ligjzbatuese** me shkresën “Sekret” nr.\*\*\*\* prot datë 25.05.2023 për subjektin e vlerësimit dhe personat e lidhru më të bën më dije se:
- a. Nuk ka të dhëna/informacione për përfshirje apo dyshim për përfshirje në krimin e organizuar.
  - b. Nuk ka të dhëna për kontakte të përpërshtatshme.
  - c. Nuk ka të dhëna për cënimin e sigurisë kombëtare.

Për subjektin e vlerësimit z. Saimir Foto Boshnjaku nuk është disponuar asnjë ankese nëpërmjet portalit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore për denoncime nga publiku për subjektet e vlerësimit kalimtar dhe periodik.

#### **47. Testi për përdorim lëndësh narkotike:**

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara testimi për përdorim lëndësh narkotike, nr. \*\*\*\* prot., datë 17.01.2024 “*Akt ekspertimi*” konkludohet se subjekti i vlerësimit **z. Saimir Foto Boshnjaku**

➤ Aktualisht nuk rezulton përdorues i lëndëve narkotike.

#### **✓ Në përfundim të hetimit të kryer për kontrollin e figurës:**

Trupa e vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pas një hetimi të thelluar të kontrollit të figurës për subjektin e vlerësimit Saimir Boshnjaku, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, analizimit dhe verifikimit të të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese, vlerësimit të testit për përdorim lëndësh narkotike, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar, arriti në konkluzionin se:

Subjekti i vlerësimit z. Saimir Foto Boshnjaku:

- *Ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;*
- *Nuk ka informacion në deklarimin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.*

### **C . VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**48.** Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit.

**49.** Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- a. të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;

- b. raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore në Policinë e Shtetit, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit 12/2018, i ndryshuar.

**50.** Subjekti i vlerësimit **z. Saimir Boshnjaku** në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e “Drejtorit të Departamentit të Kufirit dhe Migracionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

- ❖ Periudha e vlerësimit në zbatim të nenit 44 pika 2 të ligjit 12/2018 i ndryshuar është periudha 5 vjeçare (2018-2023). Porcesi i vlerësimit të aftësive profesionale do të shrihet brënda këtij harku kohor.

## **C/1 RAPORTI I VLERËSIMIT PROFESIONAL POLICIA E SHETITIT**

**51.** Struktura e burimeve njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si organ ndihmës për vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr.12/2018 i ndryshuar ka dorëzuar nëpërmjet shkresës 23/11 datë 05.07.2023 raportin e vlerësimit profesional është shprehur me **Konkluzion përfundimtar** si më poshtë vijon:

- ❖ **Punonjësi i Policisë z. Saimir Foto Boshnjaku është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës, ka respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme duke rezultuar i kualifikuar për të ushtruar funksionin që mban.**

## **C/2 HETIMI I TRUPËS SË VLERËSIMIT PRANË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE:**

✚ Trupa e vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me ligjin e vlerësimit si dhe ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, ka zhvilluar një hetim administrativ të plotë dhe të bazuar në fakte dhe prova duke u bazuar në:

- Të dhënat e administruara në dosjen personale të subjektit nr. \*\*\*\*;
- Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44 pika 1 të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.
- Të dhënat e siguruara nga Drejtoria e Standardeve Profesionale mbi performancën e subjektit.

✚ Punonjësi i Policisë, Drejtues i Parë Saimir Foto Boshnjaku është emëruar në detyrën e Drejtorit të Departamentit të Kufirit dhe Migracionit me urdhërin nr. 126 datë 08.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Në zbatim të ligjit 12/2018 i ndryshuar, funksioni që mban z. Saimir Boshnjaku e bën atë subjekt të ligjit sipas nenit 6.

- ❖ **Hetimi i zhvilluar nga trupa e vlerësimit, mbi nivelin e arsimit në përputhje me nenin 43-45 të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.**

**Vlerësimi i nivelit të arsimit.**

52. Sipas të dhënave të administruara nga dosja personale e subjekti, rezulton se ka përfunduar arsimin e lartë

Niveli i arsimit	Institucioni ku janë ndjekur studimet	Fillimi	Përfundimi	Vendi	Titulli/Diploma
4 vjeçar	Akademia ushtarake e Forcave Tokësore	1988	1992	Tiranë	Diplomë
3 vjeçare	Akademia e Policisë	2002	2005	Tiranë	Diplomë
Master profesional	Albania University	2009	2011	Tiranë	Diplomë
Bachelor në Drejtësi	Fakulteti i drejtësisë Universiteti i Tiranës	1997	2021	Tiranë	Diplomë

- Trupa e vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore administroj nga dosja e subjektit të vlerësimit:
  - diplomën me nr. regjistri \*\*\*\*\* datë 15.07.1992
  - diplomë Postmaster në Studime mbi Sigurinë data e lëshimit 01.06.2011
  - diplomë Bachelor në Drejtësi me nr. 20021 datë lëshimi 10.06.2022
- Në kuptim të ligjit nr 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” të ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar punonjësi/subjekti përmbush kriterin e nivelit, arsimor për funksionin që mban pranë Policisë së Shtetit, në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale.

**Certifikatat e trajnimeve, kualifikimet dhe medaljet:**

53. Gjatë periudhës 5 vjeçare të vlerësimit në zbatim të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, subjekti i vlerësimit:

- Trajnim i zhvilluar nga Akademia e “Agjencisë së Zbatimit të Ligjit Ndërkombëtar ILAE Budapest, Hungari Sezoni 37.
- Kurs Kualifikimi i Avancuar i gjuhës Angleze Agjencisë së Zbatimit të Ligjit Ndërkombëtar ILAE Budapest, Hungari Sezoni 37.

53.1 Trupa e vlerësimit vë në dukje faktin se dokumentacioni, bashkëlidhur raportit të vlerësimit përmban edhe certifikata pjesmarrjes në trajnime të subjektit të vlerësimit, për periudhën kohore e cila nuk është e përfshirë në objektin e vlerësimit të aftësive profesionale

## **Pjesëmarrja në konferenca shkencore**

54. Subjekti i vlerësimit gjatë periudhës 5-vjecare objekt vlerësimi sipas nenit 44 pika 2 të ligjit 12/2018 i ndryshuar marrë pjesë në Konferencën e 25 të Ndërkombëtare të Policisë Kufitare nëntopr 2022 organizuar nga Agjencia Europiane e Rojes Kufitare dhe Bregdetare FRONTEX, Varshave Poloni.

54.1 Trupa e vlerësimit vë në dukje faktin se dokumentacioni bashkëlidhur, raportit të vlerësimit përmban edhe certifikata pjesëmarrjes në ëoorkshope të subjektit të vlerësimit, për periudhën kohore e cila nuk është e përfshirë në objektin e vlerësimit të aftësive profesioanle.

## **Vlerësimet e punës:**

55. Për periudhën e vlerësimit 5 vitet e fundit (2018-2022) në dosjen e subjekti të vlerësimit dhe në raportin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit subjekti i vlerësimit ka vlerësimet e punës si më poshtë vijon:

- Për vitin 2018 me rezultat 27 pikë (shumë mirë)
- Për vitin 2022 me rezultat vlerësim i përgjithshëm 97 pikë nga 100 (shumë mirë)

*(Në vlerësimin e mësipërm vlen të theksohet se për periudhën 2018 - 2021 vlerësimi maksimal i punonjësve sipas formularit të vlerësimit ishte 28 pikë, ndërsa në vitin 2022 vlerësimi maksimal është 100 pikë)*

**Subjekti i vlerësimit nga vlerësimet e punës rezulton i vlerësuar për 2 vitet objekt vlerësimi më vlerësim maksimal.**

## **Masat disiplinore**

56. Nga verifikimi në dosjen personale si dhe në sistemin RMIS, rezulton se gjatë periudhës 5-vjeçare, (2018-2022) të përcaktuar në pikën 2, të nenit 44, të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, subjekti i vlerësimit nuk ka marrë asnjë masë disiplinore.

## **Ecuria në karrierë**

57. Subjekti i vlerësimit Saimir Boshnjaku, ka një karrierë në Policinë e Shtetit prej 30 vite e 10 muaj, nga verifikimi i dosjes personale rezulton se gjatë periudhës 5-vjecare objekt vlerësimit ka:

- **Marrë gradën “Drejtues i Lartë”**

Emërtimi i gradës	Arsyeja e ndryshimit	Nr urdhëri	Data	
			Nga	Deri
Kryekomisar	Ulje në gradë për ndryshim të strukturës organizative	Nr. *** datë 26.12.2013	26.12.2013	18.10.2021



Drejtues	Dhënie grade me vendim gjyqësor	Nr. *** datë 18.10.2021	19.10.2021	18.07.2022
Drejtues i Lartë	Emëruar në detyrë Drejtor Departamenti	Nr. *** datë 08.07.2022	19.07.2022	Aktualisht

58. Trupa e vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore referuar nenit 44 pika 2, të ligjit nr 12/2018 i ndryshuar, ka marr në shqyrtim fitimin e gradës “Drejtues” dhe “Drejtues i parë”

58.1 Grada policore nga “Drejtues”, në “Drejtues i Lartë” nga subjekti i vlerësimit e ka përfituar, me Urdhër të Ministrit të Brendshëm nr. \*\*\*, datë 18.07.2022 “Për emërimin në detyrë dhe dhënien e gradës policore Drejtues i Lartë” për shkak të emërimit të tij në pozicionin e Drejtorit të Departamentit.

- **Pozicioni “Drejtor i Departamentit të Kufirit dhe Migracionit.**

Data e fillimit	Data e përfundimit	Institucioni	Funksioni
19.07.2022	Aktualisht	Departamenti i Kufirit dhe Migracionit	Drejtor Departamenti
19.10.2021	18.07.2022	Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit, Drejtoria Vendore Tiranë	Drejtor
19.11.2014	18.10.2021	Departamenti i Kufirit dhe Migracionit	Specialist

- ✚ Trupa e Vlerësimit referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. \*\*\* datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese dhe kategorizimin për gradët në Policinë e Shtetit” konstaton se pozicioni “Drejtor i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit” i korrespondon grada “Drejtues i Parë”.
- ✚ Fitimi i kësaj grade përkon më dhënien e gradës më urdhër të Ministrit të Brendshëm për shkak të pozicionit të punës. Urdhëri mban nr. \*\*\* datë 08.07.2022 “Emërimi në detyrë dhe dhënia e gradës policore “Drejtues i Parë”

✓ **Në përfundim të hetimit të kryer:**

Trupa e vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi kreu një hetim të thelluar për vlerësimin e aftësive profesionale, nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit, vlerësimin e përmbushjes së detyrave funksionale dhe respektimin e rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, arrin në konkluzionin se:

Subjekti i vlerësimit z. Saimir Foto Bshnjaku;

- **Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;**
- **Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban;**
- **Ka vlerësime pozitive pune.**

## **Konkluzione përfundimtare:**

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin e relatores së çështjes, shpjegimet me shkrim të dhëna nga subjekti i vlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe pasi u njoh me qëndrimin e subjektit të vlerësimit në seancën dëgjimore publike të datës 17.07.2024, ftoj subjektin në seancën e dhënies së vendimit të datës 25.07.2024, dhe arrin në kokluzionin se subjekti i vlerësimit, z.Saimir Foto Boshnjaku, në përputhje me nenin 60, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;*
- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;*
- *Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.*

## **PËR KËTO ARSYE:**

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mbodh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar;

## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit z. Saimir Foto Boshnjaku, me funksion Drejtori Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

*Ky vendim u shpall sot datë 25.07.2024, në Tiranë.*

**KRYESUES**

**ENTON RADOVANI**

**RELATORE**

**KLEADA MERSINLLARI**

**ANËTARE**

**EDONA DUSHAJ**